



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova -
Ministry of Foreign Affairs*

Prishtinë, 19 dhjetor 2018

RAPORTI I PUNËS I MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME

(2017-2018)



Objekti i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës



Ministria e Punëve të Jashtme



Sh. T. Z. Behgjet Pacolli

*Zëvendëskryeministër i Parë dhe Ministër i Punëve të Jashtme i
Republikës së Kosovës*



*Të nderuar udhëheqës të institucioneve të Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë të Kuvendit,
Të nderuar ambasadorë dhe diplomatë,
Të nderuar bashkëpunëtorë dhe kolegë,*

Sot, dhjetë vjet pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, shteti ynë vazhdon të përballlet me vështirësi në rrafshin ndërkombëtar, në proceset integruese, në anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, por edhe me sfida të ndryshme të brendshme të cilat pashmangshëm reflektojnë edhe në zhvillimet ndërkombëtare.

Nuk ka qenë e lehtë për mua ta marr detyrën e Ministrit të Punëve të Jashtme në një kohë kur Kosova po përballej me një fazë të ndjeshme të dialogut me Serbinë, rrjedhimisht me një fushatë të egër diplomatike të Serbisë ndaj shtetësisë së Kosovës.

Qysh në ditët e para, pas marrjes së detyrës, i kam paraqitur Qeverisë dhe Kryeministrit një plan konkret për politikën e jashtme dhe diplomacinë. Në fokusin tim të programit katërvjeçar është reforma dhe riorganizimi në Shërbimin e Jashtëm, lobimi intensiv si dhe kundërpërgjigjja ndaj diplomacisë serbe në raport me shtetin e Kosovës.

Gjatë vitit të parë të mandati tim, si Zëvendëskryeministër i Parë dhe Ministër i Punëve të Jashtme, i jam përmbajtur në tërësi programit të Qeverisë, duke u përqendruar kryesisht në një lobim intensiv, pa anashkaluar edhe reformën dhe riorganizimin e brendshëm të Shërbimit të Jashtëm dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Gjatë kësaj periudhe të mandatit, së bashku me drejtoritë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ambasadorët dhe anëtarët e tjerë të Shërbimit të Jashtëm, kemi arritur të bëjmë shumë punë për përmbushjen e planprogramit qeverisës për politikën e jashtme.

Jam munduar maksimalisht dhe kam ndërmarrë veprime dhe vendime konkrete të cilat e kanë përmirësuar dhe do ta përmirësojnë gjendjen në Shërbimin e Jashtëm. Natyrisht, nuk ka qenë e lehtë.

Jam i vetëdijshëm se gjatë kësaj periudhe njëvjeçare nuk ka përfunduar çdo gjë ashtu siç kemi dëshiruar. Në çdo punë dhe angazhim ka edhe vend për përmirësim.

Po ashtu, ju siguroj se jam angazhuar me gjithë potencialin dhe qenien time në mënyrë që politika e jashtme e Kosovës të ketë sukses, duke marrë parasysh ndryshimet gjeopolitike që kanë ndodhur dhe ndodhin në politikën globale, ku pozita e një shteti të ri siç është Kosova është jashtëzakonisht e ndjeshme.



Do të vazhdoj të punoj dhe të angazohem maksimalisht për fuqizimin e diplomacisë, për reformimin e Shërbimit të Jashtëm dhe për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës.

Faleminderit të gjithë atyre që besojnë në programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe punën time.

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Behgjet Pacolli'.

*Miqësisht,
Behgjet Pacolli
Zëvendëskryeministër i Parë
Ministër i Punëve të Jashtme*



PËRMBAJTJA

ZËVENDËSKRYEMINISTRI I PARË DHE MINSITRI I PUNËVE TË JASHTME

AKTIVITETET9



HYRJE

Politika e jashtme dhe diplomacia e Kosovës është funksionalizuar pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, më 17 shkurt 2008. Me themelimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, në mars të vitit 2008, u krijua edhe Shërbimi i Jashtëm i Republikës së Kosovës.

Për këto vite, që nga themelimi, politika e jashtme dhe Shërbimi i Jashtëm i Republikës së Kosovës përjetoi sfida të ndryshme, duke filluar nga konsolidimi dhe ndërtimi i shtetit, e deri te sfidat që kanë të bëjnë me fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, të cilat vazhdojnë edhe sot e kësaj dite.

Përgjatë këtyre viteve politika e jashtme e Republikës së Kosovës shënoi suksese, por kishte edhe ngecje. Këto të fundit jo gjithmonë janë varur drejtpërsëdrejti nga shteti ynë, por në një masë të madhe edhe nga rrethanat dhe faktorët objektivë që lidhen me realitetin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës.

Që nga themelimi Ministria e Punëve të Jashtme është udhëhequr nga pesë ministra. Ministër aktual i Punëve të Jashtme jam unë, i gjashti i kësaj Ministrie, zgjedhur pjesë e kabinetit qeveritar (Zëvendëskryeministër i Parë dhe Ministër i Punëve të Jashtme), në seancën e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajtur më 9 shtator 2017. Puna ime në Ministrinë e Punëve të Jashtme ka filluar më 11 shtator 2017.

Ky raport ka për qëllim pasqyrimin e punës dhe të arriturave njëvjeçare të qeverisjes së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Shërbimit të Jashtëm dhe përfshinë periudhën 11 shtator 2017 – 19 dhjetor 2018.

Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare, të cilën e pasqyron ky raport, diplomacia e Kosovës ka përjetuar shumë vështirësi, kryesisht të bazuara në përpjekjet intensive të fushatës agresive të Serbisë, ndaj shtetësisë së Kosovës, që kishin dhe kanë për qëllim dobësimin e pozitës së shtetit tonë në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe subjektivitetit ndërkombëtar.

Raporti i punës në përmbajtjen e tij përfshinë aktivitetet kryesore të angazhimeve dhe punës së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Shërbimit të Jashtëm. Në përmbajtjen e raportit janë lënë jashtë një numër i madh i aktiviteteve për shkak se përfshirja e tyre do ta ngarkonte në masë të madhe këtë raport.

Struktura e raportit është e ndarë në atë mënyrë që t'i paraqesë veprimet kryesore të aktorëve të Shërbimit të Jashtëm për përmbushjen e synimeve dhe të programit qeveritar për diplomacinë.



Në fillim të raportit janë përfshirë në mënyrë kronologjike të gjitha aktivitetet, vizitat jashtë shtetit, po edhe takimet e mia brenda Republikës së Kosovës të cilat takime kanë prodhuar rezultate konkrete të suksesit. Një pjesë e raportit u është kushtuar edhe aktiviteteve, takimeve jashtë dhe brenda shtetit si dhe rezultateve të punës së zëvendësministrave, të cilat aktivitete, po ashtu, janë pasqyruar në mënyrë kronologjike.

Një pjesë tjetër e raportit pasqyron politikat dhe veprimet e mia dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhur me Shërbimin e Jashtëm dhe masat e ndërmarra përkitazi me to. Pjesa e parafundit e raportit u kushtohet aktiviteteve dhe të arriturave kryesore të punës së Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtorisë së Përgjithshme, drejtorive dhe divizioneve në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Akademisë Diplomatike. Kjo pjesë e raportit është e bazuar në të dhënat zyrtare dhe raportet e pranuar nga drejtoritë dhe departamentet e Ministrisë së Punëve të Jashtme.



AKTIVITETET

Gjatë angazhimit dhe punës time një (1) vjeçare si Zëvendëskryeministër i Parë dhe Ministër i Punëve të Jashtme, kam zhvilluar aktivitetet të shumta, dhe atë si vijon:

- **Tetëdhjetë e tre (83)** vizita jashtë shtetit, në vende të ndryshme në mbarë botën. Prej tyre vizita të pa publikuara janë vizitat në këto shtete: Greqi; Rumani; Moldavi dhe Sllovaki.
- **Mbi pesëdhjetë (50)** vende të ndryshme të vizituara, në mbarë botën. Në disa vende, kam realizuar vizita më shumë se një (1) herë.
- **Tridhjetë e dy (32)** takime i kam realizuar me President të shteteve të ndryshme.
- **Njëqind e njëzet e dy (122)** takime i kam realizuar me homologë të mi nga mbarë bota.
- **Dymbëdhjetë (12)** homolog të mi kanë vizituar Prishtinën.
- **Tridhjetë e dy (32)** konferenca dhe aktivitete të tjera multilaterale, në të cilat kam marrë pjesë. Në kuadër tyre kam zhvilluar qindra takime me presidentë të shteteve, homolog të mi si dhe personalitete të tjera dhe përfaqësues të shteteve të ndryshme nga mbarë bota.
- **Mbi Njëqind e njëzet e pesë (125)** takime bilaterale të zhvilluara, gjatë vizitave në shtetet e ndryshme.
- **Dy (2)** herë kam marrë pjesë në sesionin e rregullt të Asamblesë së Përgjithësime të OKB-së (UNGA).
- **Dy (2)** herë kam marrë pjesë në Konferencën e Frankofonisë.
- **Dy (2)** herë kam marrë pjesë në Konferencën e vendeve Islamike (OIC).



PRANIMDORËZIMI I DETYRËS NGA U. D. I MINISTRIT TË PUNËVE TË JASHTME, EMANUEL DEMAJ

PRISHTINË, 11 SHTATOR 2017

Nëse ka diçka që nuk e dimë e mësojmë, nëse ka diçka të vështirë e sfidojmë, sinqeriteti besimi dhe vlerat tek njerëzit janë shumë me rëndësi. Shpresoj shumë se secili që punon bashkë me mu, ai do të jetë në gjendje që në fund të ditës të llogarit se ku e ka shpenzuar kohën. Ne do të kultivojmë kualitet. Nuk do t'ju zhgënej as ju si paraardhës as bashkëpunëtorët.



Prishtinë, 11 shtator 2017 - Pranimi i detyrës zyrtare në objektin e MPJ-së.



TAKIMET ME KORIN DIPLOMATIK TË AKREDITUAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

PRISHTINË 12 - 14 SHTATOR 2017

Në ditët e para pas pranimit të detyrës zyrtare kam pritur në takime të ndara të kortezisë ambasadorët e shteteve të huaja të akredituara në Kosovë. Në takimet me ta kam shprehur përkushtimin dhe angazhimin e fuqishëm të Qeverisë së re për rritjen e dinamikës në politikën e jashtme nëpërmjet udhëheqjes së një diplomacie proaktive.



Prishtinë, 12 shtator 2017 - Takim i kortezisë me Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Kosovës, Greg Delawie.



TAKIM ME AMBASADOREN E FINLANDËS NË KOSOVË, ANNE HUHTAMAKI

PRISHTINË, 12 SHTATOR 2017

Në takim është folur edhe për marrëdhëniet bilaterale ndërmjet dy shteteve, ku është theksuar vullneti i dyanshëm për ngritjen e marrëdhënieve në shumë fusha e veçanërisht atë ekonomike. Ambasadorja Huhtamäki, ka mbështetur në përvojën dhe raportet që ka krijuar Ministri Pacolli, pret që të ketë përmirësim të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Ajo po ashtu ka rikonfirmuar mbështetjen e Finlandës për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Pacolli ka paraqitur objektivat qeverisëse në politikën e jashtme, duke shprehur përkushtimin e Qeverisë për plotësimin e kriterëve të kërkuara për liberalizimin sa më të shpejtë të vizave për qytetarët e Kosovës.



Prishtinë, 12 shtator 2017 - Takim me Ambasadoren e Finlandës në Kosovë, Anne Huhtamäki.



TAKIM ME SHEFEN E ZYRËS SË BE-SË NË KOSOVË, NATALIYA APOSTOLOVA

PRISHTINË, 12 SHTATOR 2017

Në takim me Shefen e Zyres së BE-së në Kosovë, ambasadoren Nataliya Apostolova, me të cilën ka biseduar rreth procesit të integrimit Evropian të Kosovës si dhe rreth intensifikimit të bashkëpunimit me vendet e rajonit. Ambasadorja Apostolova përgëzoi për detyrën e re duke ritheksuar përkushtimin e BE-së në mbështetjen e Kosovës për përmbushjen e Agjendës për Reforma Evropiane. Ambasadores i ritheksova përkushtimin e plotë në avancimin e qëllimeve të përbashkëta, duke përfshirë këtu edhe thellimin e bashkëpunimit rajonal për promovimin e sigurisë, stabilitetit, dhe prosperitetit në rajonin e Ballkanit.



Prishtinë, 12 shtator 2017 - Takim me Shefen e Zyrës së BE-së në Kosovë, Përfaqësuese e Posaçme e BE-së, Nataliya Apostolova.



TAKIM ME AMBASADOREN E TURQISË NË KOSOVË, KIVILCIM KILIÇ

PRISHTINË, 13 SHTATOR 2017

Turqia i ka dhënë mbështetje të palëkundur vendit tonë në procesin e shtet-ndërtimit. Kam kërkuar nga Ambasadorja që kjo mbështetje të vazhdojë edhe më tutje, sidomos në rritjen e përpjekjeve diplomatike të këtij vendi për sigurimin e njohjeve të reja tek vendet ku ajo mund të ketë ndikim dhe sigurim të mbështetjes së njëjtë edhe për anëtarësimin në Organizata Ndërkombëtare. Zgjerimi i bashkëpunimit ekonomik në fushat e interesit dy-palësh ka qenë një temë tjetër, e cila është diskutuar gjatë takimit.



Prishtinë, 13 shtator 2017 -Takim me Ambasadoren e Turqisë në Kosovë, Kivilcim Kiliç.



TAKIM ME AMBASADOREN E KROACISË NË KOSOVË, MARIJA KAPITANOVIĆ

PRISHTINË, 13 SHTATOR 2017

Ambasadorja kroate ka ri-konfirmuar vazhdimin e përkrahjes së fuqishme të shtetit të saj sa i përket forcimit të subjektivitetit ndërkombëtarë të Kosovës; avancimit të proceseve të integritimit Euro-Atlantike, si dhe anëtarësimit në Organizata rajonale, evropiane dhe Ndërkombëtare. Fillimisht falënderova Ambasadoren Kapitanović për mbështetjen konsistente të shtetit dhe popullit kroat ndaj proceseve nëpër të cilat ka kaluar dhe po kalon vendi ynë dhe më pas e njoftova me prioritetet e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës duke filluar nga përsheptimi i procesit të liberalizimit të vizave për të gjithë qytetarët; shtimin e përpjekjeve dhe angazhimeve diplomatike për rritjen e numrit të njohjeve për shtetësinë e Kosovës si dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare dhe fokusimi më i madh në Diplomacinë Ekonomike.



Prishtinë, 13 shtator 2017 - Takim me Ambasadoren e Kroacisë në Kosovë, Marija Kapitanović.



TAKIM ME TË NGARKUARIN E PËRKOHSHËM ME PUNË TË GJERMANISË, JAN-AXEL VOSS

PRISHTINË, 13 SHTATOR 2017

Nga bashkëbisedimi me diplomatin gjerman, mora zotime se Gjermania, si një shtet aleat dhe partner strategjik i Republikës së Kosovës do të vazhdojë dhe shtojë përpjekjet e saj për mbështetjen e palëkundur gjermane ndaj vendit tonë përkitazi me forcimin legjitimitetit ndërkombëtarë; avancimin e proceseve të integritetit Euro-Atlantik, si dhe anëtarësimit në Organizata rajonale, evropiane dhe Ndërkombëtare. Në margjina të këtij takimi një vëmendje e posaçme i është kushtuar edhe rritjes së mëtejme dhe hapjes së mundësive të reja të bashkëpunimit ekonomik në mes dy vendeve, me fokus të veçantë nëpërmjet formatit të Investimeve të Huaja Direkte.



Prishtinë, 13 shtator 2017 - Takim me të Ngarkuarin e Përkohshëm me Punë të Gjermanisë, Jan-Axel Voss.



TAKIM ME AMBASADORIN BRITANIK NË KOSOVË, *RUAIRI O'CONNELL*

PRISHTINË, 13 SHTATOR 2017

Duke vlerësuar lartë marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar theksova vullnetin e Qeverisë së Kosovës për fuqizimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve të Kosovës me këtë vend. Diskutuam edhe për forcimin e shtetësisë dhe subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, si dhe për prioritetet në politikën e jashtme të Kosovës. Veçova angazhimet e mëdha që i presin institucionet në përmbushjen e agjendës evropiane, ndërsa ka shprehur mirënjohjen e popullit dhe Qeverisë për përkrahjen e vazhdueshme të këtyre shteteve për zhvillimin dhe përparimin e Republikës së Kosovës.



Prishtinë, 13 shtator 2017 - Takim me Ambasadorin britanik në Kosovë, Ruairi O'Connell.



DISKUTIM PËR BASHKËPUNIMIN FRANCË-KOSOVË

PRISHTINË, 13 SHTATOR 2017

Me ambasadorin e Francës në Kosovë vlerësuam lart raportet ne mes të Kosovës dhe Francës, duke shprehur vullnetin e përbashkët për vazhdimin e thellimit të këtij bashkëpunimi. Diskutuam për projektet e përbashkëta, të cilat do t'i kontribuonin zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies së qytetarëve të Kosovës. Ambasadori shprehu përkrahjen e fuqishme të Francës për Kosovën, duke garantuar kështu vazhdueshmëri të mbështetjes së shtetësisë së saj.



Prishtinë, 13 shtator 2017 - Takim me Ambasadorin e Francës në Kosovë, Didier Chabert.



TAKIM ME AMBASADORIN E ITALISË NË KOSOVË, PIERO CRISTOFORO SARDI

PRISHTINË, 13 SHTATOR 2017

Me ambasadorin Italian në Kosovë diskutova për forcimin e shtetësisë dhe subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, si dhe për prioritetet në politikën e jashtme të Kosovës. Italia ka dëshmuar në vazhdimësi mbështetjen e Republikës së Kosovës, Sovranitetit të shtetit tonë.



Prishtinë, 13 shtator 2017 - Takim me Ambasadorin e Italisë në Kosovë, Piero Cristoforo Sardi.



TAKIM ME AMBASADORIN E SHQIPËRISË NË KOSOVË, QEMAL MINXHOZI

PRISHTINË, 13 SHTATOR 2017

Kosova dhe Shqipëria do të vazhdojnë të jenë për krah njëra tjetrës. Në takim me ambasadorin Minxhozi, u dakorduar se do të jemi një sa i përketë diplomacisë dhe politikave të jashtme të shteteve tona.



Prishtinë, 13 shtator 2017 - Takim me Ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi.



TAKIM ME SHEFEN E ZYRËS NDËRLIDHËSE TË GREQISË NË PRISHTINË, KONSTANTINA ATHANASSIADOU

PRISHTINË, 13 SHTATOR 2017

Është konfirmuar angazhimi dhe mbështetja e dy vendeve për ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme bilaterale në aspektin politik dhe ekonomik. Greqia është partner i rëndësishëm i Kosovës si dhe fqinj rajonal i saj. Vlerësojmë mbështetjen që Greqia ka dhënë dhe po jep në ndërtimin e perspektives euroatlantike të Kosovës. Dy vendet trajtojnë reciprokisht relacionet me respekt dhe përkushtim të madh. Në takim u diskutua edhe për projektet e reja bilaterale ndërmjet dy vendeve, sidomos në organizimin e konferencave të përbashkëta ekonomike.



Prishtinë, 13 shtator 2017 - Takim me Shefen e Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë në Prishtinë, Ambasadoren Konstantina Athanassiadou.



TAKIM ME AMBASADORIN E SLLOVENISË NË KOSOVË, BOJAN BERTONCELJ

PRISHTINË, 14 SHTATOR 2017

Gjatë këtij takimi, janë ri-konfirmuar marrëdhëniet e shkëlqyeshme në mes dy vendeve dhe dy popujve, me zotime dhe përkushtime të reja për forcimin e mëtejshëm të këtyre marrëdhënieve në fusha të interesit të përbashkët. Veç ri-theksimit të mbështetjes së fuqishme sllovene ndaj anëtarësimit të plotë të Republikës së Kosovës në Komunitetin Ndërkombëtarë, avancimit të agjendës euro-atlantike; një vëmendje e posaçme i është kushtuar zgjerimit dhe thellimit të bashkëpunimit ekonomik në mes dy vendeve respektive nëpërmjet organizimit të Forumeve Ekonomike në të dyja vendet. Nevoja për përshtetimin e procesit të liberalizimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës ka qenë një temë tjetër, e cila është diskutuar gjithashtu.



Prishtinë, 14 shtator 2017 - Takim me Ambasadorin e Sllovenisë në Kosovë, Bojan Bertancelj.



TAKIM ME DREJTORESHËN E BASHKIMIT EVROPIAN PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË, ANGELINA EICHHORST

Prishtinë, 14 shtator 2017

Përsheptimi i procesit të liberalizimit të vizave për shtetasit e Republikës së Kosovës është i një rëndësie të veçantë, nëpërmjet të cilit do të krijoheshin mundësi të reja për të gjithë qytetarët e vendit, sidomos për të rinjtë. Në vijim këtij takimi me Zyrtares e Lartë të BE-së, shpreha zotimin dhe përkushtimin e Institucioneve të vendit për përmbushjen sa më të shpejtë të kriterëve të mbetura në lidhje liberalizimin e vizave. Diskutuam mbi zhvillimet e gjiththmbarshme politike si në nivelin e brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm dhe në veçanti në lidhje me raportet e Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian. Përkitazi me këtë është vlerësuar si jashtëzakonisht e rëndësishme avansimi i mëtejme i marrëdhënieve në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.



Prishtinë, 14 shtator 2017 - Në ditët e para të pranimit të detyrës kam takuar edhe Drejtoreshën e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, Angelina Eichhorst, me delegacionin e saj.



VIZITA E PARË ZYRTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

14 SHTATOR 2017

Tri ditë pasi kam pranuar detyrën zyrtare, vizitën e parë jashtë vendit e kam zhvilluar në Republikën e Shqipërisë. Gjatë kësaj vizite jam pritur nga krerët e shtetit shqiptar, ndërkohë që jemi marrë vesh për koordinimin e përpjekjeve të përbashkëta në rrafshin diplomatik ndërkombëtar dhe jemi pajtuar për vazhdimin e traditës së hapjes së misioneve të përbashkëta diplomatike dhe konsullore me Republikën e Shqipërisë si ai në Kopenhagë dhe Hamburg. Në kuadër të këtyre takimeve kam propozuar thellimin e bashkëpunimit ekonomik nëpërmjet krijimit të pikave të përbashkëta doganore, sikurse ajo në Durrës si dhe për lehtësimin e lëvizjes së lirë të shtetasve nga të dyja anët. Gjithashtu, jemi pajtuar për mbajtjen e takimit të përbashkët të dy qeverive më 27 nëntor 2017, me rastin e hapjes së “Vitet Gjithëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut”.



Tiranë, 14 shtator 2017 - Në takim me Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, Edi Rama.



Tiranë, 14 shtator 2017 - Takim me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.



Tiranë, 14 shtator 2017 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Shqipërisë, Ditmir Bushati.



Tiranë, 14 shtator 2017 - Takimi me ish-Kryeministrin e Shqipërisë, Sali Berisha.



TAKIM ME AMBASADORIN KANADEZ, DANIEL MAKSIMYUK

15 SHTATOR 2017

Kanadaja gjithmonë e ka treguar veten duke u renditur krah Kosovës që nga njohja e Pavarësisë. Në një takim Ambasadorin e Kanadasë për Kosovë, rezident në Kroaci, Daniel Maksymiuk, bashkëbiseduam për zhvillimet ekonomike në vend, përfshirë prioritetet e Qeverisë në planin ekonomik. Fokusi kryesor i takimit ishin potenciali mineral që ofron Kosova pasi që Kanadaja njihet si lider botëror në këtë industri. Me këtë rast Ambasadori Maksymiuk, më njoftoi për disa kompani Kanadeze të interesuara në këtë fushë që pritet të vizitojnë Kosovën së shpejti.



Prishtinë, 15 shtator 2017 - Takim me Ambasadorin kanadez, Daniel Maksimyuk.



PJESËMARRJA DHE LOBIMI PËR NJOHJE NË ASAMBLËN E PËRGJITHSHME TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË NJU JORK

20 – 23 SHTATOR 2017

Puna vazhdon në margjina të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara duke takuar dhjetëra liderë shtetesh nga shtetet njohëse dhe jonjohëse. Nga shtetet mike është kërkuar që ato të vazhdojnë ta mbështesin konsolidimin e mëtejshëm të shtetit të Kosovës në marrëdhënie me jashtë, ta përkrahin vendin tonë dhe të ndikojnë edhe te vendet e tyre mike për sigurimin e anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare, ndërsa nga takimet me udhëheqësit e shteteve jonjohëse ishin vënë kontakte, ndërtuar miqësi dhe zgjeruar partneritete të reja.





KOSOVA FORMALIZON BASHKËPUNIMIN ME JORDANINË NË INTELIGJENCË, SIGURI DHE ARSIM

NEW YORK, 19 SHTATOR 2017

Aktivitetin tim diplomatik bashkë me presidentin e Kosovës, e fillova në Nju Jork me një takim me Mbretin Abdullah të Jordanisë. Dakordim i plotë për bashkëpunim ndërmjet dy shteteve. Brenda pak javësh delegacionet e Kosovës do të udhëtojnë në Jordani për të formalizuar bashkëpunimin me Jordaninë në fushën e inteligjencës, sigurisë dhe arsimit.



Nju Jork, 19 shtator 2017 - Së bashku me Presidentin e Republikës, Hashim Thaçi, gjatë takimit me Mbretin Abdullah të Jordanisë. Jemi pajtuar për ta formalizuar bashkëpunimin me Jordaninë në fushën e inteligjencës, sigurisë dhe arsimit.



TAKIM ME HOMOLOGUN TIM NGA OMANI

NJU JORK, 19 SHTATOR 2017

Mirënjohës ndaj Ministrit të Jashtëm Jusuf bin Alawi bin Abdullah për mbështetjen e vazhdueshme të Omanit dhënë Kosovës. Ne u pajtuam të zgjerojmë marrëdhëniet tona dypalëshe.



Nju Jork, 19 shtator 2017 - Takim me ministrin e Jashtëm të Omanit, Jusuf bin Alawi bin Abdullah, në margjina të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.



GJATË TAKIMIT ME MINISTRIN E JASHTËM TË SAINT VINCENT DHE GRENADINES

NJU JORK, 19 SHTATOR 2017

Shteti ynë është njohur nga 114 shtete sovrane dhe është anëtar në më shumë se 60 organizata. Nga CARICOM tashmë 10 shtete e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe kanë vendosur marrëdhënie diplomatike me ne. Prandaj, Kosova është e interesuar të vendos marrëdhënie diplomatike me Saint Vincent dhe Grenadines për të formalizuar një miqësi mes shteteve tona”, ka thënë presidenti Thaçi gjatë takimit me Zëvendëskryeministrin dhe Ministrin e Jashtëm të Saint Vincent dhe Grenadines, Sir Louis Straker



Nju Jork, 19 shtator 2017 - Së bashku me Presidentin Hashim Thaçi gjatë takimit me Ministrin e Jashtëm të Saint Vincent dhe Grenadines.



TAKIM ME PRESIDENTIN E TURQISË, RECEP TAYYIP ERDOĞAN

NJU JORK, 19 SHTATOR 2017

Në margjina të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, së bashku me Presidentin Thaçi, takuam edhe Presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan. Takim miqësor dhe frytdhënës. Ri-konfirmuam marrëdhëniet shumë të mira në mes dy vendeve, duke shprehur zotimin dhe përkushtimin e dy-anshëm për zgjerimin dhe thellimin e mëtejme të këtij bashkëpunimi. Kosova i është falënderuese Turqisë për mbështetjen e palëkundur në lidhje me procesin e shtet-ndërtimit në Kosovë dhe anëtarësimin e saj në të gjitha Organizatat Ndërkombëtare.



Nju Jork, 19 shtator 2017 - Bashkë me presidentin Hashim Thaçi takuam edhe presidentin e Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan.



Nju Jork, 20 shtator 2017 - Takim me Presidenten e Mauritiusit, Ameenah Gurib Fakim.



TAKIM ME HOMOLOGUN TIM NGA TURQIA, MEVLÛT ÇAVUŞOĞLU

NJU JORK, 19 SHTATOR 2017

Pas takimit me Presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan, kisha rastin që ta takojë në një takim shumë të ngrohtë dhe miqësor homologun tim, Ministrin e Jashtëm të Turqisë, Mevlüt Çavuşoğlu. Me homologun nga Turqia ri-konfirmova mbështetjen e fuqishme nga ky vend. Miku im, Mevlüt shumë shpejt do ta vizitojë Kosovën, ku ndër të tjera do të koordinojmë agjendën mbi vazhdimin e lobimit për vendin tonë në raport me vendet jo-njohëse.



Nju Jork, 20 shtator 2017 - Takim me Ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Turqisë, Mevlut Çavosoglu.



BASHKËBISEDIM ME MINISTRIN ITALIAN TË PUNËVE TË JASHTME, ANGELINO ALFANO

NJU JORK, 20 SHTATOR 2017

Në New York takova edhe ministrin italian të Punëve të Jashtme, Angelino Alfano. Kosova mirëpret përkrahjen e vazhdueshme të Itlisë për anëtarësimin e shtetit tonë në organizata të rëndësishme ndërkombëtare.



Nju Jork, 20 shtator 2017- Bashkëbisedim me ministrin italian të Punëve të Jashtme, Angelino Alfano.



TAKIM ME PRESIDENTIN E OIC OCI, AHMAD AL-OTHAIMEEN.

NJU JORK, 20 SHTATOR 2017

Së bashku me Presidetin Thaçi takuam Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës për Bashkëpunim Islamik, Shkëlqësinë e Tij, Dr. Yousef bin Ahmad Al-Othaimen. E falenderuam për mbështetjen e vazhdueshme dhe të fuqishme që kjo Organizatë dhe shtete anëtare të saj i kanë dhënë dhe po i japin Republikës së Kosovës, në lidhje me konsolidimin e shtetësisë dhe integrimin e plotë të vendit tonë në bashkësinë ndërkombëtare. Shprehëm zotimet dhe përkushtimet tona për rritjen e përpjekjeve dhe angazhimeve të përbashkëta diplomatike për rritjen e numrit të njohjeve.



Nju Jork, 20 shtator 2017 - Takim me presidentin e OIC OCI, Ahmad Al-Othaimen.



TAKIM ME KRYEMINISTRIN E KROACISË, ANDREJ PLENKOVIÇ NJU JORK, 20 SHTATOR 2017

Kroacia përbën një model për shtetet e rajonit në jetësimin e reformave që janë kriter kryesor i përsheptimit të rrugës së shteteve të Ballkanit në Bashkimin Evropian. Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor kanë pritshmëri të larta nga presidenca kroate, ndaj ne e falënderojmë Kroacinë si mbështetëse të fortë të integritit evropian të të gjithë rajonit.



Nju Jork, 20 shtator 2017 - Takim me kryeministrin e Kroacisë, Andrej Plenković.



TAKIM ME KRYEMINISTRIN SOLOMON, ISLAND SOGAVARE

NJU JORK, 20 SHTATOR 2017

U shpreha mirënjohës ndaj Ishujve Solomon për njohjen e Kosovës si shtet i pavarur dhe për mbështetjen e vazdeshme që po e japin për anëtarësimin e vendit në organizata ndërkombëtar. Ftova kryeministrin Sogavare për thellimin e bashkëpunimit dypalësh në të gjitha fushat.



Nju Jork, 20 shtator 2017 - Takim me Kryeministrin solomon, Island Sogavare.



TAKIM ME HOMOLOGUN MALAZEZ SRDJAN DARMANOVIÇ

NJU JORK, 20 SHTATOR 2017

Kemi biseduar për gjendjen aktuale që i kemi vlerësuar raportet si të shkëlqyera dhe kemi shqyrtuar mundësinë që na ofron ky bashkëpunim për të avancuar bashkëpunimet tona. Nuk kemi çështje të hapura me Malin e Zi. Ky shtet ka krijuar një ambient më të sigurt edhe për Kosovën duke e bërë rajonin rajon qind për qind të NATO-s dhe sa i përket Kosovës jemi të rrethuar me shtete anëtare të NATO-s.



Nju Jork, 20 shtator 2017 - Takim me homologun malazez Srdjan Darmanoviç.



TAKIM ME PËRFAQËSUESIN PERMANENT TË MBRETËRISË SË BASHKUAR NË OKB

NJU JORK, 21 SHTATOR 2017

Mbretëria e Bashkuar, me kontributin e madh që ka dhënë gjatë kësaj periudhe, ka qenë një ndër promotorët dhe mbështetësit kryesor të progresit që është arritur në Kosovë deri më tani. Kërkova përkrahjen e mëtejme të Mbretërisë së Bashkuar dhe të Këshillit Britanik, sidomos në arsimimin e kuadrove të reja si dhe në fushën e trashëgimisë kulturore, si fushë e prioritetit strategjik të Qeverisë së Republikës së Kosovës.



Nju Jork, 21 shtator 2017 - Takim me Përfaqësuesin Permanent të Mbretërisë së Bashkuar në OKB.



TAKIM ME MINISTRIN E PUNËVE TË JASHTME TË LESOTOS, LESEGO MAGOTHI

NJU JORK, 21 SHTATOR 2017

Mbretëria e Lesoto, në Afrikën jugore, ka luajtur rol shumë të rëndësishëm tek vendet tjera sa i përket lobimit për shtetësin e Kosovës. Homologu im nga ky vend premtoi se raportet mes dy vendeve do të thellohen.



Nju Jork, 21 shtator 2017 - Takim me Ministrin e Punëve të Jashtme të Lesotos, Lesego Magothi.



Nju Jork, 21 shtator 2017 - Bashkëbisedim me kryeministrin e Mauritois, Pravind Jugnauth.



Nju Jork, 21 shtator 2017 - Takim me Ambasadorin Permanent, Chritoph Heusgen.



TAKIM ME KRYEMINISTREN E BANGLADESHIT, SHEIKH HASINA

NJU JORK, 21 SHTATOR 2017

Mbështetja e Bangladeshit në Organizatën e Bashkëpunimit Islamik (OBI) për njohjen e mëtejshme të Kosovës është e rëndësishme dhe ne ju jemi mirënjohës për mbështetjen që ju keni dhënë rezolutës që përkrah pavarësinë e Kosovës.



Nju Jork, 21 shtator 2017 - Takim me Kryeministren e Bangladeshit, Shkëlqesinë e Saj, Sheikh Hasina.



BASHKËBISEDIM ME MINISTREN E JASHTME TË KENYAS, AMINA MOHAMMED

NJU JORK, 21 SHTATOR 2017

Në vllugun dhe dinamikën e takimeve pata kënaqësinë e veçantë ta takoj edhe homologen time nga Kenia, Amina Mohamed. Dua të besoj se Kenia do të njoh së shpejti Kosovën.



Nju Jork, 21 shtator 2017 - Bashkëbisedim me Ministren e Jashtme të Kenyas, Amina Mohammed.



TAKIM ME HOMOLOGUN E EMIRATEVE TË BASHKUARA, SHEIKH ABDULLAH BIN ZAYED BIN SULTAN AL NAYA

NJU JORK, 21 SHTATOR 2017

Falenderova homologun nga Emiratet e Bashkuara për mbështetjen sistematike dhe të palëkundur të vendit të tij ndaj Kosovës dhe popullit të saj nëpër të gjitha proceset. Vullneti ekziston për thellimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit dy-palësh në mes dy vendeve, duke theksuar në veçanti investimet e mundshme nga Emiratet e Bashkuara Arabe në fushën e turizmit, bujqësisë, teknologjisë informative dhe shërbimeve.



Nju Jork, 21 shtator 2017 - Takim me homologun e Emirateve të Bashkuara, Lartmadhërinë e Tij, Sheikh Abdullah bin Zayed bin Sultan Al Naya.



TAKIM ME HOMOLOGUN TIM NGA BRUNEI DARUSSALAM, PEHIN DATO LIM JOCK SENG

NJU JORK, 21 SHTATOR 2017

I shpreh mirënjohjen time të thellë për miqësinë, respektin dhe hapjen për thellimin e bashkëpunimit në mes dy vendeve tona. Për shtet mike largësia gjeografike ka pak rëndësi. Pozicioni strategjik i këtij vendi ofron shumë. Shprehëm interesimin për organizimin të një Forumi Ekonomik në Brunei. Do të ketë edhe nënshkrim të Marrëveshjes për Mbrojtjen e Investimeve të Përbashkëta.



Nju Jork, 21 shtator 2017 - Takim me homologun tim nga Brunei Darussalam, Pehin Dato Lim Jock Seng.



TAKIM ME PRESIDENTIN E LIBISË, FAYEZAL SARRAJ

NJU JORK, 22 SHTATOR 2017

Vlerësuam bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve dhe kërkova përkrahjen e Libisë për njohjen e pavarësisë së Kosovës në kontinentin afrikan si dhe për anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, me theks të veçantë anëtarësimin e Republikës së Kosovës në UNESCO.



Nju Jork, 22 shtator 2017 - Takim me presidentin e Libisë, Fajezal Sarraj.



Nju Jork, 22 shtator 2017 - Takim i përbashkët me Ministrin e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, me diasporën shqiptare.



Nju Jork, 22 shtator 2017 - Takim me Shefin e OIF-Francophoes, Micheaelle Jean, nga Kanadaja.



Nju Jork, 22 shtator 2017 - Gjatë takimit të vendeve të Kartës së Adriatikut.



Nju Jork, 22 shtator 2017 - "Fotografi familjare" e Charter A5.



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË SINGAPORIT, VIVIAN BALA

NJU JORK, 22 SHTATOR 2017

E përgëzova ministrin Balakrishnan për zgjedhjen e Presidentes së re të Singaporit, Halimah Yacob. Singapori është një model se si multi-kulturalizmi është një forcë e një shoqërie. Kosova është e interesuar të zgjerojë bashkëpunimin dypalësh me Singaporin, veçanërisht në fushat e ekonomisë dhe tregtisë.



Nju Jork, 22 shtator 2017 -Takim me Ministrin e Jashtëm të Singaporit, Vivian Bala.



TAKIM ME PRESIDENTIN E SAO TOME AND PRINCIPE

NJU JORK, 22 SHTATOR 2017

Në kuadër të javës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, në Nju Jork, takova edhe Presidentin e Sao Tome dhe Principe, Evaristo do Espírito Santo Carvalho. Shpreha mirënjohjen ndaj Sao Tome dhe Principe për mbështetjen e dhënë ndaj Kosovës. Kosova është e interesuar për rritjen e bashkëpunimit të gjithmbarshëm me Sao Tome dhe Principe dhe kërkoi mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.



Nju Jork, 22 shtator 2017 - Takim me presidentin e Sao Tome and Principe.



TAKIM ME ELIZABETH MILLARD, NDIHMËSEKRETARE E SHTETIT NË SHBA

NEW YORK, 22 SHTATOR, 2017

Si gjithëherë, privilegj dhe nder të takohemi me aleatët tanë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Zhvilluam një takim frytdhënës dhe përmbajtësor me Ushtruesen e Detyrës së Ndhmës-Sekretares së Shtetit për Çështje Evropiane, Elisabeth Millard, e cila shoqërohej edhe nga Zëvendës-Ndhmës Sekretari, Hoyt Yee. Përjetësisht mirënjohës Shteteve të Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e fuqishme dhe konsistente. Kosova, vërtet është e bekuar që ka një aleat strategjik si ShBA.



Nju Jork, 22 shtator 2017 - Takim me Elisabeth Millard, Ndhmëssekretare e shtetit në ShBA.



BASHKËBISEDIM ME MINISTRIN E PUNËVE TË JASHTME TË SUDANIT, IBRAHIM GANDUR

NJU JORK, 22 SHTATOR 2017

Sapo e takova edhe homologun tim nga Sudani, Shkëlqësinë, Ibrahim Ghandour. U njoftova se Sudani është duke e konsideruar njohjen. Në pritje të lajmeve të mira edhe nga ky shtet. Shtirijen gjeografike dhe rrjedhën e njohjeve nuk mund ta ndal askush.



Nju Jork, 22 shtator 2017 - Bashkëbisedim me Ministrin e Punëve të Jashtme të Sudanit, Ibrahim Gandur.



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË GREQISË, NIKOS KOTZIAS

Nju Jork, 22 shtator 2017

Përkundër mungesës së njohjes, e vlerësojmë pozitivisht nivelin aktual të dialogut politik ndërmjet dy shteteve. Ne e kemi shprehur gatishmërinë tonë për të ruajtur e thelluar shkallën e arritur të bashkëpunimit politik duke vazhduar praktikën e takimeve dhe vizitave të niveleve të larta politike, të cilat kontribuojnë në ecurinë pozitive të marrëdhënieve tona fqinjësore dhe që nxisin bashkëpunimin dhe dialogun mes dy vendeve.




Nju Jork, 22 shtator 2017 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Greqisë, Nikos Kotzias.



TAKIM ME PRESIDENTIN E BULLGARISË, RUMEN RADEV

NJU JORK, 22 SHTATOR 2017

Kam falënderuar Presidentin Radev për ndihmën e Bullgarisë në shtetndërtimin e Kosovës, forcimin e demokracisë, si dhe për rrugëtimin euroatlantik të saj. Kosova mbetet e përkushtuar ndaj synimit të saj kryesor të politikës së saj të jashtme, anëtarësimit të plotë në BE dhe në NATO. E ftova presidentin Radev që të organizojmë në të ardhmen e afërt një forum të përbashkët ekonomik, i cili do të ndihmonte rritjen e vëllimit tregtar mes dy shteteve.



Nju Jork, 22 shtator 2017 - Takim me Presidentin e Bullgarisë, Rumen Radev.



BASHKËBISEDIM ME ROSEMARY DI CARLO, AMBASADORE E SHBA-SË NË OKB.

NEW YORK, 22 SHTATOR, 2017


Në rrugë e sipër për takime, takova edhe miken e madhe të Kosovës dhe shqiptarëve, Ambasadoren, Rosemary DiCarlo, e cila tani është duke e ushtruar edhe një funksion shumë të rëndësishëm, si Presidente e Këshillit Kombëtar mbi Politikën e Jashtme Amerikane. I shpreha mirënjohjen time të thellë dhe respektin e madh për gjithçka që ajo ka bërë për Kosovën.



Nju Jork, 22 shtator 2017 - Bashkëbisedim me Rosemary Di Carlo, Ambasadore e ShBA-së në OKB.



Nju Jork, 22 shtator 2017 - Takim me Ministrin e Punëve të Jashtme të Marshall Island, John Silk.



Nju Jork, 23 shtator 2017 - Takim me Marcel Amon-Tanoh, Ministër i Jashtëm i Bregut të Fildisht.



Nju Jork, 23 shtator 2017 - Takim me homologun tim nga Armenia, Eduard Nalbandyan, shtet ky që ende nuk e ka njohur Republikën e Kosovës.



TAKIM ME MIROSLAV LAJÇAK, KRYESUES I ASAMBLESË SË KOMBEVE TË BASHKUARA

NJU JORK, 23 SHTATOR 2017

Ishte takim i shkëlqyeshëm i shkëmbimit të ideve me ministrin e Punëve të Jashtme të Sllovakisë, i cili njëherësh është edhe kryesues i OSBE-së. Ne vazhdojmë angazhimin pragmatik me Sllovakinë për të promovuar perspektivën Euro-Atlantike të Kosovës dhe rajonit



Nju Jork, 23 shtator 2017 - Takim me Miroslav Lajčak, kryesues i Asamblesë së Kombeve të Bashkuara.



GJATË TAKIMIT TIM ME HOMOLOGUN MALAZEZ, SRDJAN DARMANOVIÇ

PODGORICË, 26 SHTATOR 2017

Mali i Zi është shteti i dytë, që unë po vizitoj në cilësinë e Ministrit të Jashtëm. Në këtë gatishmëri, në këto përpjekje tonat, ne shprehim në mënyrën më besnike ndjenjat e miqësisë të popullit tonë kundrejt popullit të Malit të Zi. Kosova i është mirënjohëse Malit të Zi për mbështetjen gjatë historisë së largët dhe të afërt, veçanërisht gjatë periudhës së luftës së fundit. Midis dy popujve tanë ka lidhje tradicionale miqësie dhe bashkëpunimi, në nivel familjesh, individësh, komunash, institucionesh dhe partish politike. Minoriteti malazez është një urë e fuqishme miqësie. Si diskutuam me Srdjanin, ne jemi të gatshëm të nënshkruajmë një marrëveshje të Partneritetit Strategjik midis dy vendeve.



Podgoricë, 26 shtator 2017 - Gjatë takimit tim me homologun malazez Srdjan Darmanoviç.



GJATË TAKIMIT ME KRYETARIN E KUVENDIT TË MALIT TË ZI, IVAN BRAJOVIĆ

PODGORICË, 26 SHTATOR 2017

Kërkoj përsheptimin e punës për të rritur nivelin e bashkëpunimit midis dy vendeve në të gjitha nivelet, veçanërisht në ekonomi, në rritjen e shkëmbimeve ekonomike dhe njerëzore, ku komunikacioni konsiderohet se ka rëndësi thelbësore. Ne duhet të punojmë kah integrimi i linjave hekurudhore, krijimi i subjekteve të përbashkëta në fushën e transportit ajror, etj. Ne jemi vende të vogla, që të kemi sukses në këto lloj transportesh, në botën globale që na rrethon.




Podgoricë, 26 shtator 2017 - Gjatë takimit me Kryetarin e Kuvendit të Malit të Zi, Ivan Brajović.



GJATË TAKIMIT ME PRESIDENTIN E MALIT TË ZI, FILIP VUJANOVIÇ

PODGORICË, 26 SHTATOR 2017

Asgjë nuk është e pamundur në marrëdhëniet midis dy fqinjëve, që e respektojnë dhe e vlerësojnë njeri tjetrin. Ne duam të shfrytëzojmë eksperiencën e Malit të Zi për integrimin euroatlantik. Ne duam të shtyjme përpara zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike, të rrisim vëllimin e shkëmbimeve tregtare. Ne jemi të gatshëm të shohim mundësitë e shtimit dhe ndërtimit të rrugëve të komunikimit midis dy vendeve.



Podgoricë, 26 shtator 2017 - Gjatë takimit me Presidentin e Malit të Zi, Filip Vujanović.



GJATË TAKIMIT ME DREJTUESIT E PARTIVE POLITIKE SHQIPTARE NË MALIN E ZI

PODGORICË, 26 SHTATOR 2017

Në takim u fol për zhvillimet politike në Mal të Zi, me theks të veçantë për subjektet politike shqiptare, të cilat luajnë rol konstruktiv në skenën politike, si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror. Më tej u theksua nevoja e koordinimit më të mirë të faktorit politik shqiptar, për të qenë i pranishëm dhe i reprezentueshëm në asambljetë komunale ku ka më shumë popullatë shqiptare. Garantova delegacionin nga Ulqini për bashkëpunim të vazhdueshëm midis subjekteve politike të shqiptarëve të Malit të Zi dhe institucioneve të Kosovës, në favor të krijimit të politikave që forcojnë Malin e Zi si shtet demokratik dhe anëtar i NATO.



Podgoricë, 26 shtator 2017 - Gjatë takimit me drejtuesit e partive politike shqiptare: Nazif Cungu nga partia Forca, Gjergj Camaj nga Alternativa Shqiptare, Fatmir Xheka nga Partia Demokratike, Mehmet Bardhi nga Lidhja Demokratike në Malin e Zi dhe Hatixhe Gjoni nga Unioni Demokratik i Shqiptarëve.



VIZITA E PARË NË INSTITUCIONET E BASHKIMIT EVROPIAN DHE SELINË E NATO-S

28 SHTATOR 2017

Institucionet e Bashkimit Evropian dhe selia e NATO-s në Bruksel ishin dy destinacionet e radhës brenda muajit të parë. Në kuadër të kësaj vizite kam takuar përfaqësues të Parlamentit Evropian, Komisionarin për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatave për Zgjerim, Johannes Hahn, Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, znj. Federica Mogherini, dhe Zëvendëssekretaren e Përgjithshme të NATO-s, znj. Rose Bottemoeller. Gjatë këtyre takimeve kam pranuar lëvdata për tejkalimin e krizës politike që po përballej vendi pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit, kam pranuar mbështetje të plotë për proceset euroatlantike të Kosovës dhe përpjekjet për zgjidhjen e çështjes së marrëveshjes së shënimit të vijës kufitare me Malin e Zi.



Bruksel, 28 shtator 2017 - Takim me Përfaqësuesen e Lartë të BE-së, Federica Mogherini.



TAKIM BILATERAL ME KOMISIONARIN PËR POLITIKËN EVROPIANE TË FQINJËSISË DHE NEGOCIATAVE PËR ZGJERIM, JOHANNES HAHN

BRUKSEL, 28 SHTATOR 2017

Procesi i integritit evropian dhe euro-atlantik mbetet qëllimi kryesor i politikës së jashtme të Republikës së Kosovës, duke konsideruar se vlerat evropiane janë edhe vlera të Kosovës dhe se rrugëtimi i Kosovës nuk është i plotë pa u bashkuar në familjen evropiane. Në takim me z.Hahn, shpreha zotimin se Kosova për të gjitha proceset e ndërlidhura me agjendën evropiane, duke përfshirë këtu edhe dinamizmin e zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim si dhe liberalizimin e vizave.



Bruksel, 28 shtator 2017 - *Takim bilateral me Komisionarin për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatave për Zgjerim, Johannes Hahn.*



TAKIM ME ZËVENDËSSEKRETAREN E PËRGJITHSHME E NATO-S, ROSE BOTTEMOELLER

BRUKSEL, 28 SHTATOR 2017

Zhvillova një takim jashtëzakonisht të mirë dhe shumë miqësor me Zëvendës-Sekretaren e Përgjithshme të NATO-s, znj Rose Gottemoeller, në selinë qendrore të NATO-s në Bruksel. Ndjenjë e veçantë dhe emocione shumë, që të qëndrojë në ambientet e kësaj organizate, që luajti rol vendimtar në ndalimin e spastrimit etnik dhe gjenocidit në Kosovë, ndërtimin e paqes dhe vazhdimin e mëtejme të sigurisë rajonale. NATO-ja do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën dhe do të kemi një bashkëpunim të shkëlqyeshëm për të kontribuar së bashku në ndërtimin e paqes dhe ruajtjen e sigurisë ndërkombëtare. U pajtuam që në kordinim të ngushtë me aleatet strategjik te procedojme me formimin e ushtrisë së Kosovës.



Bruksel, 28 shtator 2017 - Takim në selinë qendrore të NATO-s me Zëvendëssekretaren e Përgjithshme e NATO-s, Rose Bottemoeller.



Bruksel, 28 shtator 2017 - Takim me Antonio Panzeri, raportues në hije për Kosovën në Parlamentin Evropian.



TAKIM ME GRUPIN E LIBERALËVE NË PARLAMENTIN EVROPIAN, ALDE

BRUKSEL, 28 SHTATOR 2017

Jemi krenarë që një pjesë e madhe e qeverisë së Kosovës janë liberal. Kërkova ndihmën e bashkëbiseduesve kundrejt vendeve të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën, duke marrë premtimin për angazhimin e tyre në këtë drejtim. Diplomacia ekonomike është e rëndësishme krahas asaj tradicionale, sepse prodhon rezultate të prekshme prej qytetarëve.



Bruksel, 28 shtator 2017 - Takim me Grupin e Liberalëve në Parlamentin Evropian, ALDE.



GJATË TAKIMIT ME TANYA FAJON, RAPORTUESE E PARLAMENTIT EVROPIAN PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR KOSOVËN

BRUKSEL, 28 SHTATOR 2017

Si do ecet përpara me liberalizimin e vizave, ishte tema kryesore në këtë takim. Votimi i demarkacionit, dialogu me Serbinë, zhvillimi ekonomik, ishin tema të tjera. Zonja Fajon shprehu vullnetin për ta mbështetur Kosovën në këtë fazë të zhvillimit, duke mbetur kështu një mike e madhe e Kosovës.



Bruksel, 28 shtator 2017 - *Gjatë takimit me Tanya Fajon, raportuese e Parlamentit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën.*



Bruksel, 28 shtator 2017 - *Takim me Tonino Picula, kryesues i delegacionit për Kosovë në Parlamentin Evropian.*



NGA TAKIMI NË KONFERENCEN E SHKOLLËS DIPLOMATIKE

PRIZREN, 2 TETOR 2017

Gjatë hapjes së konferencës së katërt të Shkollës Diplomatike për diplomatë të rinj me temën “Të drejtat e njeriut dhe demokracia”, të organizuar nga Akademia Diplomatike e Kosovës, me mbështetjen e Fondacionit gjerman “Friedrich Ebert Stiftung”.



Prizren, 2 tetor 2017 – Nga takimi në konferencen e Shkollës Diplomatike



TAKIMI ME AMBASADORIN E AUSTRISË NË KOSOVË, GERNOT PFANDLER

PRISHTINË, 3 TETOR 2017

Ishte kënaqësi ta pres në takim kurtuazie Ambasadorin austriak në Prishtinë, Gernot Pfandler. Ri-konfirmuam marrëdhëniet e shkëlqyera në mes dy vendeve. Austria do të vazhdojë mbështetjen e fuqishme për konsolidimin e shtetit të Kosovës. U pajtuam që të kemi edhe një Plan Veprimi dy-palësh në mes dy vendeve. Ambasadori Pfandler më dërgoi personalisht edhe letrën e urimit nga homologu im, Ministri i Jashtëm i Austrisë, Sebastian Kurz.




Prishtinë, 3 tetor 2017 - Nga takimi i zhvilluar me Ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Gernot Pfandler.



GJATË TAKIMIT ME AMBASADORIN E HUNGARISË NË KOSOVË, LÁSZLÓ MÁRKUSZ

PRISHTINË, 3 TETOR 2017

Shpreha gatishmërinë që Hungaria të jetë edhe më e pranishme në tregun kosovar, me synimin që të krijohen mundësi edhe për palën kosovare dhe veç kësaj të shikohen mundësitë e krijimit të partneriteteve të reja në mes dy vendeve në funksion të arritjes së këtij qëllimi. Po ashtu, vlerësova mbështetjen e Hungarisë me kredinë e butë që i ka dhënë Kosovës dhe e cila synohet të investohet në projekte mjedisore.



Prishtinë, 3 tetor 2017 - Gjatë takimit me Ambasadorin e Hungarisë në Kosovë, László Márkusz.



TAKIM ME ZV/KRYEMINISTRIN E MAQEDONISË, BUJAR OSMANI

PRISHTINË, 3 TETOR 2017

Republika e Kosovës dhe ajo e Maqedonisë do të mbajnë mbledhje të përbashkët mes dy qeverive, do të ndërmarrin veprime konkrete për lehtësimin e kalimit të kufirit, do të synojnë projekte të përbashkëta në kuadër të procesit të Berlinit dhe do të shikojnë mundësinë e krijimit të pikave të përbashkëta doganore. Këto ishin disa nga temat e takimit, të cilat u diskutuan në takim. Shkëmbimi i përvojave në kuadër të procesit të integritimeve euro-atlantike ishte një çështje tjetër, për të cilën të dyja palët kanë theksuar si të rëndësishme.




Prishtinë, 3 tetor 2017 - Takim me Zv/kryeministrin e Maqedonisë, Bujar Osmani.



GJATË PRITJES NË TAKIM TË AMBASADORIT TË NORVEGJISË NË KOSOVË, PER STRAND SJAASTAD

PRISHTINË, 4 TETOR 2017

Falënderova Ambasadorin për mbështetjen e palëkundur dhe konsistent të shtetit dhe popullit norvegjez nëpër të gjitha proceset të cilat ka kaluar Kosova dhe populli i saj. Shprehem zotimet tona për rritjen e përpjekjeve për thellimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit dy-palësh, me fokus të veçantë në Diplomacinë Publike, Energji, Investime si dhe vazhdimin e ofrimit të përkrahjes për trajnimin e shërbyesve civil për procesin e integritimit evropian.



Prishtinë, 4 tetor 2017 - Gjatë pritjes në takim të Ambasadorit të Norvegjisë në Kosovë, Per Strand Sjaastad.



TAKIM ME DREJTORIN GJENERAL PËR POLITIKAT E FQINJËSISË EVROPIANE DHE ZGJERIM

PRISHTINË, 4 TETOR 2017

Në kuadër të këtij takimi është diskutuar në lidhje me liberalizimin e vizave, avancimin e agjendës evropiane për Kosovën, respektivisht reformat e kërkuara në nivel nacional, si dhe bashkëpunimin rajonal në kuadër të Hapësirës Rajonale Ekonomike. Delegacionin njoftova se qytetarët e Republikës së Kosovës, që duan lëvizjen e lirë nuk kanë lidhje me demarkacionin, dhe shpreha përkushtimin se do të bëhet gjithçka që do të jetë e mundur, që liberalizimi i vizave të mundësohet.




Prishtinë, 4 tetor 2017 - Takim me Drejtorin Gjeneral për Politikat e Fqinjësisë Evropiane dhe Zgjerim.



TAKIM ME MARCO MANTOVANELLI, MENAXHER PËR KOSOVË NË BANKËN BOTËRORE

PRISHTINË, 4 TETOR 2017

Me politika që mbështesin bizneset e vogla dhe të mesme, prodhimin vendor, me lidhjen e arsimit me ekonominë lëvizim drejt zhvillimit, theksova edhe nevojën për tërheqjen e investitorëve nga jashtë, ku rol aktiv dhe pozitiv mund të luajnë si mërgata ashtu edhe institucionet tjera financiare ndërkombëtare që e pranojnë dhe ndihmojnë Republikën e Kosovës. Në këtë takim diskutuam edhe disa projekte që kanë të bëjnë me furnizim të ujit të pijshëm, ujitjen e tokës bujqësore, ruajtjen e lumenjve, deponitë e hapura, zhvillimin rural dhe për punësimin e të rinjve.



Prishtinë, 4 tetor 2017 - Takim me Marco Mantovanelli, menaxher për Kosovë në Bankën Botërore.



TAKIM ME SHEFIN E OSBE-SË NË KOSOVË, JAN BRAATHU

PRISHTINË, 5 TETOR 2017

Në margjina të këtij takimi, informova Ambasadorin Braathu mbi zhvillimet e gjithmbarshme politike në vendin tonë, të arriturat e deritanishme, si dhe për objektivat dhe synimet e Qeverisë së Republikës për vitin e ri kalendarik. Në ndërkohë, Ambasadori Braathu ka njoftuar në lidhje me planet dhe aktivitetet e këtij Misioni në Kosovë për vitin e ardhëm, si dhe për prioritetet e shtetit Italian, e cila do të jetë kryesuese e OSBE-së gjatë vitit 2018.



Prishtinë, 5 tetor 2017 - Takim me shefin e OSBE-së në Kosovë, Jan Braathu.



TAKIM ME AMBASADORIN E KUVAJTIT, FAYEZ MISHARI AL-JASSIM

PRISHTINË, 5 TETOR 2017

Me qëllimin e intensifikimit të bashkëpunimit bilateral në të gjitha fushat, por, me fokusim të veçantë në çështjet e koordinimit politik dhe atë të thellimit të bashkëpunimit ekonomik, Kosova pritet të akreditojë brenda pjesës së parë të vitit të ardhshëm edhe Ambasadorin e saj në shtetin e Kuvajtit.



Prishtinë, 5 tetor 2017 - Takim me Ambasadorin e Kuvajtit, Fayez Mishari Al-Jassim.



TAKIM ME AMBASADORIN CHRISTIAN HELDT

PRISHTINË, 9 TETOR 2017

Gjermania është një partner strategjik i Kosovës, jo vetëm në rrafshin bilateral, por edhe në rrugëtimin tonë drejt Bashkimit Evropian. Kërkova nga Ambasadori vazhdimin e mbështetjes së Berlinit në procesin e anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian, duke theksuar rëndësinë e miratimit të demarkacionit me Malin e Zi, e cila i hap rrugë liberalizimit të vizave për Kosovën. Kosova do të mbetet partner i besueshëm dhe do të vazhdojë t' u qëndrojë para obligimeve ndërkombëtare që ka marrë.



Prishtinë, 9 tetor 2017 - Takim me Ambasadorin Christian Heldt, diskutim i përgjithshëm bilateral për raportet e Kosovës me Gjermaninë dhe perspektivën evropiane të vendit.



GJATË TAKIMIT ME AMBASADORIN REZIDENT TË MBRETËRISË SË BELGJIKËS NË KOSOVË, FRANÇOIS BONTEMPS

PRISHTINË, 10 TETOR 2017

Republika e Kosovës dhe Mbretëria e Belgjikës duhet t'i shtojnë energji të reja përpjekjeve nga të dyja vendet respektive për rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe nxitjes së investimeve. Mbretëria e Belgjikës ka qenë dhe vazhdon të mbetet një shtet partner dhe mik i Republikës së Kosovës, i cili i ka ofruar mbështetje të fuqishme ndaj të gjitha proceseve të shtet-ndërtimit në Kosovë dhe fuqizimit të shtetësisë së Kosovës në komunitetin ndërkombëtarë.



Prishtinë, 10 tetor 2017 - *Gjatë takimit me Ambasadorin rezident të Mbretërisë së Belgjikës në Kosovë, François Bontemps.*



NIKOQIR I HOMOLOGUT TIM NGA FINLANDA

PRISHTINË, 11 TETOR 2017

Shumë takim i përzemërt me homologun tim finlandez Timo Soini, që ruan kujtimet më të mira nga vizita në Prishtinë për dhjetë vjetorin e pavarësisë. I kërkova mbështetje për liberalizimin e vizave dhe e informova për procesin e dialogut me Serbinë. Ftova ndërmarrësit finlandezë, një vend me eksperiencë në sportet dimërore, të investojnë në Kosovë, duke përfituar lehtësi të mëdha. Miku im Soini më garantoi për mbështetjen e vendit të tij në të gjithë organizatat ndërkombëtare ku Kosova bën pjesë, apo do të aplikojë në të ardhmen.



Prishtinë, 11 tetor 2017 - Takim me Ministrin e Punëve të Jashtme të Finlandës, Timo Soini.



TAKIM ME HOMOLOGUN HUNGAREZ PETER SZIJJARTO

BUDAPEST, 11 TETOR 2017

Ne duam menjëherë liberalizimin e vizave, sepse ne nuk duam, që të rinjtë tanë, që njerëzit e biznesit, të ndihen të izoluar, të diskriminuar në nivel europian". Këtë mesazh i dërgova homologut tim hungarez, Peter Szijarto, gjatë një takimi shumë miqësor dypalësh, që zhvillova sot në Budapest para se të fillojë takimi ministerialit të Procesit të Vishegradit. I kërkova, që edhe procedura e dhënies së vizave të lehtësohej që tani edhe në nivel dypalësh. Miku im, Ministri Szijarto, e quajti shumë të drejtë këtë shqetësim dhe më tregoi edhe një rast të ndërhyrjes së tij personale për të shkurtuar afatet e takimeve për viza në Ambasadën hungareze në Prishtinë. U pajtuam së bashkërisht se kemi marrëdhënie të shkëlqyera politike dhe duhet të ngremë edhe marrëdhëniet ekonomike në këtë nivel.



Budapest, 11 tetor 2017 - Takim me homologun hungarez Peter Szijarto.



MINISTERIALI I GRUPIT TË VISHEGRADIT NË BUDAPEST

BUDAPEST, 11 TETOR 2017

Me ftesë të vendeve anëtare të Grupit të Vishegradit, kam marrë pjesë dhe i jam adresuar me një fjalim edhe Ministerialit të Grupit të Vishegradit, që ishte mbajtur në Hungari dhe ku kishin marrë pjesë shefat e diplomacisë së Hungarisë, Polonisë, Çekisë, Sllovakisë, plus 6 vendet e Ballkanit Perëndimor dhe ata të Rumanisë, Kroacisë, Estonisë dhe Bullgarisë, si vend President i radhës së Bashkimit Evropian në atë periudhë kohore.



Budapest, 11 tetor 2017 - Pjesëmarrja dhe adresimi im në Ministerialin e Grupit të Vishegradit.



BASHKËBISEDIM ME HOMOLOGUN TIM HUNGAREZ PETER SZIJIARTO

BUDAPEST, 11 TETOR 2017

“Ne e përkrahim perspektivën europiane të Kosovës... liberalizimin e vizave...”, kështu tha sot, miku im, Ministri i Jashtëm hungarez, Peter Szijarto, para mediave të pranishme, në emër të Presidencës së Grupit të Vishegradit, një grupim vendesh të Europës Qendrore, pjesë e Bashkimit European (Polonia, Hungaria, Çekia, Sllovakia). Deklarata u dha ndërsa Ministrat e Jashtëm të vendeve të këtij grupi, plus homologët e tyre të Ballkanit dhe Rumanisë dhe Estonisë, dolën para mediave nga gjithë Europa. Para mediave Europiane, që mbulonin këtë ngjarje të rëndësishme bëra thirrje me gjithë zemër për audiencat e tyre vendore që Kosovës t’i jepet liberalizimi i vizave. “Jepini rinisë së Kosovës, liberalizimin e vizave, që Kosova të mos mbetet vrimë e zezë e Europës”, ishte mesazhi im kryesor.



Budapest, 11 tetor 2017 - Bashkëbisedim me homologun tim hungarez Peter Szijarto.



GJATË TAKIMIT ME AMBASADOREN E HOLANDËS, GERRIE WILLEMS

PRISHTINË, 12 TETOR 2017

Me Ambasadoren holandeze diskutuan për perspektivën europiane, procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, si dhe bashkëpunimin mes dy vendeve. Diplomaten holandeze e njoftova rreth progresit në Kosovë, në veçanti për përmbushjen e kritereve që Kosova ka bërë për liberalizimin e vizave.



Prishtinë, 12 tetor 2017 - Gjatë takimit me Ambasadoren e Holandës, Gerrie Willems.



TAKIM ME AMBASADOREN E LUKSEMBURGUT, ANNE DOSTER

PRISHTINË, 12 TETOR 2017

Shteti i Luksemburgut ka bërë investime të vazhdueshme në Kosovë, në fusha të ndryshme dhe me të ngarkuarën me punë në Ambasadën e Luksemburgut në Kosovë, Anne Doster, biseduam edhe për investime tjera të mundshme, si dhe për mundësitë e projekteve dhe bashkëpunimeve në të ardhmen, në mënyrë specifike ato në shëndetësi dhe arsim.



Prishtinë, 12 tetor 2017 - Takim me Ambasadoren e Luksemburgut, Anne Doster.



TAKIM ME ISH-MINISTRIN E PUNËVE TË JASHTME TË KANADASË, LLOYD AXWORTHY

PRISHTINË, 16 TETOR 2017

Lloyd Norman Axworthy, ishte ministër gjatë kohës së periudhës së krizave në Kosovë. E vlerësova lartë përkrahjen e Kanadasë në konsolidimin e shtetit të Kosovës. Kanada si shtet mik, ka pasur një rol aktiv në momentet më të rënda për Kosovën, por ka qenë prezentë, po ashtu, me trupat e saj në Kosovën e pasluftës.



Prishtinë, 16 tetor 2017 - Takim kortezie me ish-Ministrin e Punëve të Jashtme të Kanadasë, Lloyd Axworthy, vlerësim për kontributin e tij human gjatë luftës në Kosovë.



VIZITA ZYRTARE E ZV/KRYEMINISTRES DHE MINISTRES SË PUNËVE TË JASHTME TË BULLGARISË, EKATERINA ZAHARIEVA

PRISHTINË, 19 TETOR 2017

Kisha kënaqësinë, që sot, fillimisht të shtrojë një drekë pune dhe më pas të zhvillojë një takim dy-palësh me homologen dhe miken time nga Bullgaria, Zëvendës-Kryeministren dhe ministren e Punëve të Jashtme të znj. Ekaterina Zaharieva. Vlerësuam lartë raportet e shkëlqyeshme në mes dy vendeve dhe shprehëm zotime të dyanshme për thellimin e marrëdhënieve në mes dy vendeve, në veçanti në bashkëpunimin ekonomik dhe rritjen e shkëmbimit tregtarë. U sigurova për vazhdimin e mbështetjes së palëkundur bullgare për anëtarësimin e Kosovës në Organizata Ndërkombëtare dhe për mbështetjen në proceset euro-atlantike të Kosovës. Bullgaria do të pranojë kryesimin e radhës të Presidencës së BE-së nga Janari i vitit të ardhshëm dhe mbështetja e saj do të jetë tejet e rëndësishme.



Prishtinë, 19 tetor 2017 - Në takim me homologen time nga Republika e Bullgarisë, Zëvendëskryeministren dhe Ministren e Punëve të Jashtme, Ekaterina Zaharieva.



GJATË TAKIMIT ME MINISTREN E PUNËVE TË JASHTME TË BULLGARISË

PRISHTINË, 19 TETOR 2017

Duhet të organizohemi, që bashkëpunimi ekonomik të jetë edhe më i mirë dhe të ketë më shumë shkëmbime të mallrave. Kosova, ka çka të mësojë nga përvoja e Bullgarisë, si në përvojën e shtet-ndërtimit, ashtu edhe në atë të integritit në BE. Homologja nga Republika e Bullgarisë, Zaharieva, e ka vlerësuar lartë miqësinë që është ndërtuar ndërmjet dy vendeve dhe dy popujve, duke shprehur përkushtimin e shtetit të saj dhe mbështetjen e perspektivës evropiane për Kosovën dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.



Prishtinë, 19 tetor 2017 - Gjatë takimit me Ministren e Punëve të Jashtme të Bullgarisë.



TAKIMI I RADHËS ME BASHKËPUNËTORËT NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME

PRISHTINË, 19 TETOR 2017



Prishtinë, 19 tetor 2017 - Gjatë takimit me stafin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.



VIZITA NË SHKUP, REPUBLIKA E MAQEDONISË

SHKUP, 25 TETOR 2017

Kosova, natyrshëm, i ka parë dhe i sheh me prioritet marrëdhëniet me Maqedoninë dhe vlerëson se ato janë në nivel mjaft të mirë. Konstatojmë se edhe Maqedonia natyrshëm i konsideron si mjaft të mira marrëdhëniet me ne dhe se dy palët kemi shprehur vullnet pozitiv për thellimin e bashkëpunimit midis dy vendeve tona. Ne kemi arritur të nënshkruajmë 21 Marrëveshje në mes dy vendeve. Kemi në proces 4 nisma të reja dhe disa Memorandume.



Shkup, 25 tetor 2017 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Maqedonisë, Nikolla Dimitrov.



Shkup, 25 tetor 2017 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Maqedonisë, Nikolla Dimitrov.



TAKIM ME KRYETARIN E PARLAMENTIT TË MAQEDONISË, TALAT XHAFERI

SHKUP, 25 TETOR 2017

Republika e Maqedonisë dhe Republika e Kosovës, me shembullin e tyre për bashkëpunim kontribuojnë në drejtim të ngritjes së marrëdhënieve të mira fqinjësore në rajon në nivelin më të lartë të mundshëm dhe se vizitat e këtilla janë vërtetim pikërisht i atyre angazhimeve.



Shkup, 25 tetor 2017 - Takim me Kryetarin e Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, gjatë vizitës së parë zyrtare.



GJATË TAKIMIT ME KRYEMINISTRIN E MAQEDONISË, ZORAN ZAEV

SHKUP, 25 TETOR 2017

Kosova i mbështet integrimet në NATO të Maqedonisë që do të kontribuojnë ndaj përforcimit të sigurisë dhe do të ndikojnë në perspektivat për tërë rajonin. Qeveria e Kosovës është përcaktuar të ndërtojë marrëdhënie të mira me Maqedoninë, si dhe me të gjithë fqinjët dhe me këtë në mënyrë aktive të kontribuojë ndaj ardhmërisë së tërë rajonit të Ballkanit Perëndimor, në Bashkimin Evropian dhe në NATO.



Shkup, 25 tetor 2017 - Gjatë takimit me Kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev.



Shkup, 25 tetor 2017 - Konferenca për shtyp gjatë vizitës sime në Shkup.



Shkup, 25 tetor 2017 - Gjatë takimit bilateral në mes të delegacioneve të dy shteteve, Kosovë - Maqedoni.



TAKIM I FRYTSHËM ME ZËVENDËS NDIHMËS SEKRETARIN E SHTETIT HOYT YEE

Prishtinë, 25 TETOR 2017

Takim i frytshëm me zëvendës ndihmës sekretarin e shtetit Hoyt Yee. Mbështetje e vazhdueshme në rrugëtimin e shtetit tonë drejt zhvillimit dhe integritit. Gjatë takimit ishte rikonfirmuar mbështetja e palëkundur amerikane ndaj Kosovës si në vazhdimin e konsolidimit të brendshëm, ashtu edhe në atë të integritit të mëtutjeshëm ndërkombëtar.




Prishtinë, 25 tetor 2017 - Gjatë takimit me Zëvendësndihmëssekretarin e shtetit amerikan, Hoyt Yee.



TAKIM ME MINISTRIN E PUNËVE TË JASHTME TË TURQISË, MEVLÛT ÇAVUŞOĞLU

ANKARA, 26 TETOR 2017

Ishte kënaqësi, të takoj me homologun tim mik nga Turqia, Mevlüt Çavuşoğlu. E falënderova për përkrahjen e vazhdueshme, që vendi i tij i ka dhënë Kosovës në procesin e konsolidimit/shtet-ndërtimit dhe vazhdon ta përkrahë Kosovën si në aspektin politik, ekonomik atë të sigurisë, arsimor e shëndetësor, duke mos anashkuar edhe fushat tjera. Të dyja shtetet respektive ndajnë vizionin e përbashkët për të ardhmen Euro-Atlantike të Ballkanit dhe Turqia ka qenë dhe mbetet mbështetës i vendit tonë në platformat ndërkombëtare e rajonale. Angazhimi konstruktiv i Turqisë në rajon është një shtyllë stabiliteti. Në veçanti, kërkoja mbështetjen e Turqisë për anëtarësimin në INTERPOL.



Ankara, 26 tetor 2017 - Takim me Ministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, Mevlüt Çavuşoğlu.



Ankara, 26 tetor 2017 - Gjatë konferencës për shtyp me homologun turk Mevlüt Çavuşoğlu.



TAKIM ME KRYETARIN E ASAMBLESË SË MADHE KOMBËTARE TË TURQISË, ISMAIL KAHRAMAN

ANKARA, 26 TETOR 2017

Në këtë takim kam thekuar thellimin e lidhjeve dhe marrëdhënieve mes dy vendeve. Ai tha se Kosova si një shtet i ri ka nevojë për mbështetjen e shteteve të mëdha dhe të fuqishme mike për të siguruar vendin e duhur në arenën ndërkombëtare. Ai në vijim ka shprehur falënderime për mbështetjen e deritanishme të Turqisë për Kosovën. Kosova do të vazhdojë të qëndrojë një mik i besueshëm i juaji.



Ankara, 26 tetor 2017 - Takim me Kryetarin e Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë, Ismail Kahirman.



Ankara, 26 tetor 2017 - Gjatë vizitës sime në Ankara vendosa lule në Mauzoleun e Kemal Atatürkut.




Ankara, 26 tetor 2017 - Gjatë vizitës sime në Ankara vendosa lule në Mauzoleun e Kemal Ataturkut.



TAKIM ME KRYEMINISTRIN E TURQISË, BINALI YILDRIM

ANKARA, 27 TETOR 2017

E përmbylla vizitën time në Turqi me takimin mbresëlënës dhe të ngrohtë me Kryeministrin e Turqisë, Binali Yildirim. E falënderova dhe i shpreha mirënjohjen e thellë në emrin tim dhe të Institucioneve të Kosovës për mbështetjen konsistente, që Turqia i ka dhënë dhe do t'i jep edhe më fuqishëm Kosovës procesit të lobimit për zgjerimin e njohjeve të reja për Kosovën, anëtarësimit në organizata ndërkombëtare dhe për vendosmërinë e thellimit të mëtejme të bashkëpunimit ekonomik dhe rritjes së investimeve në Kosovë. Në emër të Presidentit Thaçi dhe Kryeministrit Haradinaj përcolla ftesën që Kryeministri Yildirim dhe Presidenti Erdoğan ta vizitojnë vendin tonë, në një kohë të përshtatshme. Do të vazhdojmë me vizita vendeve të tjera dhe me dinamikën e re të diplomacisë së Kosovës.



Ankara, 27 tetor 2017 -Takim me Kryeministrin e Turqisë, Binali Yildirim.



Ankara, 27 tetor 2017 - Në ditën e dytë të vizitës zyrtare në Turqi hapa Forumin e Biznesit Kosovë-Turqi së bashku me Ministrin e Zhoillimit të Turqisë, Lütfi Elvan, në praninë e shumë kompanive turke dhe të Kosovës.



Ankara, 27 tetor 2017 - Me pjesëmarrësit e Forumit Ekonomik që u zhvillua gjatë vizitës sime në Turqi.



Ankara, 27 tetor 2017 - Takim me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik të Turqisë, Lutfi Elvan.



GJATË TAKIMIT ME RAFFAELLE PAGNOZZI

PRISHTINË, 28 TETOR 2018

Një shtet pa sport është si një trup pa gjymtyrë, prandaj ne duhet ta mbështesim sportin dhe aktivitetet sportive në të gjitha mënyrat. Njerëzit që përfaqësojnë sportin janë ambasadorët më të mirë tonë. Prandaj, vizita e Pagnozzi është shumë e rëndësishme dhe do të doja ta shoh edhe ai se ne e duam sportin dhe merremi seriozisht me të.



Prishtinë, 28 tetor 2018 - Gjatë takimit me Raffaele Pagnozzi, Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit Olimpik të Evropës, gjatë pritjes që i kam bërë në shtëpi, së bashku me udhëheqësinë e KOK-ut (Komitetin Olimpik të Kosovës).



VIZITA ZYRTARE NË MALTA

VALLETTA, 1 NËNTOR 2017

Malta dhe Kosova do të mbajnë një Forum Ekonomik në Kosovë. Ministri i Jashtëm i Maltës, Carmelo Abela, e pranoi me kënaqësi ftesën time, gjatë takimit, që kishim në Ministrinë e Jashtme në Valletta, që ai ta vizitojë Kosovën, bashkë me një grup biznesmenesh nga ky shtet. Besojmë, që do të krijohen kontaktet të reja me bizneset vendore, që do të hapin mundësi të reja për rritjen e shkëmbimit tregtarë, investimeve dhe krijimit të vendeve të reja të punës.




Valletta, 1 nëntor 2017 - Në takim me Ministrin e Jashtëm dhe Promovimit të Tregtisë së Maltës, Carmelo Abela. Në këtë takim u pajtuam për organizimin e Forumit Ekonomik në mes dy vendeve në Prishtinë.



NË TAKIM ME PRESIDENTEN E MALTËS, COLEIRO PRECA

VALLETTA, 1 NËNTOR 2017

Kërkoj nga Presidentja e Maltës që mbështetja e cila ekziston të vazhdoj edhe më tutje, në veçanti sa i përket anëtarësimit të vendit tonë në Këshillin e Evropës, Interpol, UNESCO dhe organizata të tjera dhe mbështetjen për forcimin e legjitimitetit ndërkombëtarë të Kosovës nëpërmjet zgjerimit të njohjeve të reja. Duke folur për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, presidentja Marie-Louise Coleiro Preca, më konfirmoi se vendi i saj në vazhdimësi e ka mbështetur Kosovën dhe do të vazhdojë që ta mbështesë edhe më tutje.



Valletta, 1 nëntor 2017 - Në takim me Presidenten e Maltës, Coleiro Preca, me të cilën u pajtuam për Memorandum Bashkëpunimi në mes dy vendeve.



FOLËSI KRYESOR NË KONFERENCËN GLOBALE PËR TOLERANCË DHE PAQE

VALLETTA, 1 NËNTOR 2017

Në inaugurimin e Konferencës Globale për Tolerancë dhe Paqe, e cila i kishte mbajtur punimet, në Valletta të Maltës. Në këtë Konferencë isha folësi kryesor, së bashku me Kryeministrin e Maltës, Joseph Muscat, si dhe homologun tim nga Malta, Ministrin e Jashtëm Carmelo Abela.



Valletta, 2 nëntor 2017 - Në inaugurimin e Konferencës Globale për Tolerancë dhe Paqe.



VIZITA ZYRTARE NË FRANCË

PARIS, 8 NËNTOR 2017

Ejani në Kosovë, në vendin e një rini të mrekullueshme, por që ka nevojë për shpresë, në vendin, që tradicionalisht, në arsimin e vet, në kulturën e vet ka qenë i orientuar nga Franca. Fjalët e Presidentit Macron për integrimin e Ballkanit Perëndimor kanë qenë shpresëdhënëse për ne, këto fjalë i'a thash, Ministres për Çështje Evropiane në Ministrinë për Evropë dhe Punë të Jashtme, Nathalie Loiseau, në takim që kishim në Quai d'Orsay.



Paris, 8 nëntor 2017 - Në takim me Ministren për Çështje Evropiane në Ministrinë për Evropë dhe Punë të Jashtme të Francës, Nathalie Loiseau, në Quaid Orsay.



Paris, 8 nëntor 2017 - Takim me Grupin e Miqësisë Francë - Kosovë në Asamblenë Nacionale franceze në përbërje të Presidentit të grupit, Bruno Questel dhe anëtarëve, Joachim Son Forget, Isabelle Rauch dhe Laurence Trastour Isnart. Pajtim reciprok mbi rritjen e bashkëpunimit ekonomik, arsimor dhe kulturor.



Paris, 8 nëntor 2017 - Në takim me shkrimtarin e shquar bashkëkohor shqiptar, i nominuar disa herë për çmimin "Nobel" për letërsi, Ismail Kadare.



TAKIM NË LUSAKA TË ZAMBISË ME MINISTRIN E PUNËVE TË JASHTME, HERRY KALABA

ZAMBI, 10 NËNTOR 2017

Është koha që marrëdhëniet me vendet afrikane të marrin një kahje intensive. Të punojmë më tepër dhe të hapim perspektivë edhe më të favorshme për Kosovën. Kontinenti i Afrikës është një kontinent në ardhje, që po bëhet çdo ditë më i rëndësishëm se kurrë. Kosova duhet të intensifikojë bashkëpunimin e vet më shtete afrikane. Kemi një ambasadë në kontinentin e Afrikës. Jemi në proces të hapjes së dy ambasadave tjera nëse fondet na lejojnë. Me hapjen e këtyre dy ambasadave shpresojmë të jemi më afër partnerëve tanë.



Zambi, 10 nëntor 2017 - Takim në Lusaka të Zambisë me Ministrin e Punëve të Jashtme, Herry Kalaba.



KONFERENCA E NATO-S

PRISHTINË, 14 NËNTOR 2017

Gjatë adresimit tim në konferencën e parë rajonale mbi NATO-n dhe Ballkanin Perëndimor, ku Ministria e Punëve të Jashtme ishte organizatore. Konferenca kishte bashkuar udhëheqësit më të lartë të vendit, zyrtarë të lartë të NATO-s dhe shumë ekspertë të sigurisë nga Kosova, rajoni dhe bota.



Prishtinë, 14 nëntor 2017 - Gjatë adresimit tim në konferencën e parë rajonale mbi NATO-n dhe Ballkanin Perëndimor.



Prishtinë, 14 nëntor 2017 - Në konferencën e NATO-s.



GJATË TAKIMIT ME ELMAR BROK, DEPUTET I PARLAMENTIT EVROPIAN

STRASBURG, 16 NËNTOR 2017

Në Strasburg takova Elmar Brok, deputet i Parlamentit Evropian, ish-kryetar i Komitetit për politikë të jashtme. Atë e njoftova për situatën në Kosovë dhe nevojën që sa më shpejtë të ndodhë liberalizimi i vizave për qytetarët.



Strasburg, 16 nëntor 2017 - Gjatë takimit me Elmar Brok, deputet i Parlamentit Evropian, ish-Kryetar i Komitetit për Politikë të Jashtme.



NË AMBIENTET E AMBASADËS SË KOSOVËS NË BRUKSEL

BRUKSEL, 16 NËNTOR 2017

Në mjediset e shtëpisë sonë, Ambasadës së Kosovës në Bruksel, sonte takova bashkatdhetarët tanë që jetojnë në Belgjikë. Diaspora jonë është lidhja e Kosovës me Evropën dhe puna e tyre për vendlindjen është e madhe dhe e pakursyer. Mbështetja për diasporën tonë do ta ndihmojë zhvillimin e vendit dhe do ta forcojë rrugën tonë drejt integritimeve. Në përgatitje për takimin me Këshillin e Stabilizim Asociimin këtu në Bruksel e pashmangshme të mos takojë edhe njerëzit tanë që e duan dhe jetojnë me atdheun e tyre.



Bruksel, 16 nëntor 2017 - Në ambientet e Ambasadës së Kosovës në Bruksel, me bashkatdhetarë, që jetojnë dhe veprojnë në Belgjikë.



NË AMBIENTET E AMBASADËS SË KOSOVËS NË BRUKSEL

BRUKSEL, 16 NËNTOR 2017

Së bashku me Kryeministrin Ramush Haradinaj dhe me ministra të Qeverisë së Kosovës morëm pjesë në takim të dytë të Këshillit të Stabilizim-Asociimit midis Bashkimit Evropian dhe Kosovës, takim në të cilin, ndër të tjera, u vlerësua se Marrëveshja e Stabilizim Asociimit është në thelb të marrëdhënieve midis BE-së dhe Kosovës, se siguron kornizën kontraktuale nëpërmjet së cilës BE-ja dhe Kosova do ta shtojnë bashkëpunimin.



Bruksel, 16 nëntor 2017 – Në ambientet e Ambasadës së Kosovës në Bruksel.



Bruksel, 16 nëntor 2017 - Së bashku me Kryeministrin Haradinaj gjatë raportimit për MSA-në.



GJATË TAKIMIT ME KONGRESMENIN AMERIKAN, ELIOT ENGEL

PRISHTINË, 21 NËNTOR 2017

Mëngjesin e sotëm, pata nderin ta kaloj së bashku me mikun e madh të Kosovës, kongresmenin Eliot Engel. Kontributi i Engel për vendin tonë është i njohur nga secili qytetar i Kosovës. Kongresmeni Engel edhe sot nga pozicioni i udhëheqësit të komitetit për politikë të jashtme në kongresin e SHBA, ndihmon fuqizimin dhe zhvillimin e vendit tone.



Prishtinë, 21 nëntor 2017 - Gjatë takimit me Kongresmenin amerikan, Eliot Engel.



TAKIM ME SHEFEN E ZYRËS NDËRLIDHËSE TË GREQISË NË KOSOVË, KONSTANTINA ATHANASSIADOU

PRISHTINË, 21 NËNTOR 2017

Vlerësojmë mbështetjen që Greqia ka dhënë dhe po jep në ndërtimin e perspektives euroatlantike të Kosovës. I rikonfirmova se dy vendet trajtojnë reciprokisht relacionet me respekt dhe përkushtim të madh. Në takim u diskutua edhe për projektet e reja bilaterale ndërmjet dy vendeve, sidomos në organizimin e konferencave të përbashkëta ekonomike.



Prishtinë, 21 nëntor 2017 - Takim me Shefen e Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë në Kosovë, Konstantina Athanassiadou.



TAKIM ME SHEFIN E MISIONIT TË AMBASADËS SË ARABISË SAUDITE, FAYEZ ALMEYAT

PRISHTINË, 21 NËNTOR 2017

Vlerësim për qeverinë e re, gatishmëri për mbështetje të gjithanshme dhe të palëkundur ndaj Kosovës, pranova nga i Ngarkuari me Punë i Arabisë Saudite në Tiranë, që mbulon shtetin tonë, Fayez Almeyat. Vlerësova si shumë të rëndësishme ndihmën saudite në gjithë fushat, duke filluar me njohjen e hershme, që përcaktoi një fluks tjetër njohjesh të Kosovës prej vendeve të tjera arabe dhe islamike. Arabia Saudite do të shtojë numrin e studentëve kosovarë në degë të tjera si mjekësia, inxhinieria, etj, veç degëve teologjike. Kërkova, që të firmosen marrëveshje të reja bashkëpunimi, të vendoset reciprociteti në lëvizjen e lirë të qytetarëve të të dyja vendeve dhe angazhimin e shtuar të Arabisë Saudite si vend mik për shtimin e njohjeve tek vendet që ajo ka ndikim.



Prishtinë, 21 nëntor 2017 - Takim me Shefin e misionit të Ambasadës së Arabisë Saudite, Fayez Almeyat.



Takimi me Shefin e Zyrës sllovae në Prishtinë, Lubomir Batar

Prishtinë, 21 nëntor 2017

Ngritja e nivelit të përfaqësimit diplomatik në mes Kosovës dhe Sllovakisë dhe rritja e bashkëpunimit ekonomik dhe Odave Ekonomike nga të dyja vendet respektive ishin disa nga çështjet që diskutova me shefin e Zyrës së Sllovakisë në Kosovë, Lubomir Batar. Me Batar kemi ndarë të njëjtin mendim se marrëdhëniet midis dy vendeve janë shumë të mira, duke vlerësuar se megjithëkëtë ende ka hapësirë për intensifikimin e bashkëpunimit intensiv ekonomik dhe shfrytëzimin e mundësive të reja që ofrojnë tregjet në këto dy vende.




Prishtinë, 21 nëntor 2017 - Takimi me Shefin e Zyrës sllovae në Prishtinë, Lubomir Batar.



TAKIM ME AMBASADORIN JOREZIDENT TË JAPONISË NË KOSOVË, KIYOSHI KOINUMA

Prishtinë, 21 nëntor 2017

Ambasadorin Koinuma e njoftova me ecurinë e themelimit të Parkut të Biznesit Japonez, i cili do t'i ofrojë bizneseve japoneze kushte të favorshme për investime në Kosovë. Në kuadrin e thellimit të bashkëpunimit ekonomik, Ambasadori Koinuma më njoftoi për iniciativën e Kryeministrit japonez, z. Shinzo Abe, për mbështetjen e zhvillimit ekonomik të Ballkanit Perëndimor, dhe në këtë kuadër Ambasada japoneze në Vjenë do të organizojë forumin ekonomik për promovimin e investimeve në Kosovë në fillim të muajit tetor. U diskutua edhe tema e dialogut me Serbinë, për të cilën Japonia është e interesuar që të mbarojë sa më parë, dhe njëherit përkrahë fuqishëm anëtarësimin e Republikës së Kosovës në mekanizmat ndërkombëtar.



Prishtinë, 21 nëntor 2017 - Takim me Ambasadorin jorezident të Japonisë në Kosovë, Kiyoshi Koinuma.



GJATË KONFERENCËS NË OIC-OCI, NË STAMBOLL

STAMBOLL, 22 NËNTOR 2017

Me ftesë të Qeverisë së Republikës së Turqisë (edhe pse Kosova nuk ishte anëtare e kësaj organizate), kam marrë pjesë edhe në sesionin e 33-të të COMCEC-ut, Organit Ekonomik dhe Bashkëpunimit Tregtar të shteteve të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik, që i kishte zhvilluar punimet në Stamboll të Turqisë.



Stamboll, 22 nëntor 2017 - Gjatë konferencës në OIC-OCI.



Stamboll, 22 nëntor 2017 – Fotografi e përbashkët gjatë konferencës në OIC-OCI



Stamboll, 22 nëntor 2017 - Në margjina të punimeve të sesionit të 33-të të COMCEC-ut, Organizatës Ekonomik dhe Bashkëpunimit Tregtar të shteteve të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik, kam pasur një shtrëngim duarsh dhe takim të shkurtër edhe me Presidentin e Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan.



PJESMARRËS NË MINISTERIALIN E 34-T TË KONFERENCËS SË FRANKOFONISË

PARIS, 26 NËNTOR 2017

Kam marrë pjesë dhe përfaqësuar vendin në Ministerialin e 34-t të Konferencës së Frankofonisë, e cila i kishte zhvilluar punimet në kryeqytetin francez, Paris. Me këtë rast, kam zhvilluar takime të ndara me Ministrin për Marrëdhënie me Jashtë dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar të Burundit, Togos, Cape Verde, Tunizisë, ministra të ngarkuar dhe të deleguar nga Republika Demokratike e Kongos, Republika Qendrore Afrikane, Guinea Bissau, të Dërguarin e Posaçëm të Presidentit nga Republika e Guinesë, përfaqësues të lartë nga Qeveria e Seychelles, Ministrin e Shtetit në Ministrinë për Evropë dhe Marrëdhënie me Jashtë të Francës dhe përfaqësues të tjerë nga shtete të ndryshme pjesëmarrëse. Në të gjitha takimet bilaterale që kam zhvilluar kam ripërsëritur kërkesën për njohje ndaj vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën dhe kam rikonfirmuar marrëdhëniet e mira dhe miqësore me përfaqësues të shteteve që e kanë njohur vendin tonë.



Paris, 26 nëntor 2017 – Pjesmarrës në Ministerialin e 34-t të Konferencës së Frankofonisë.



PRANIMI I NOTËS VERBALE TË NJOHJES SË PAVARSISË NGA MADAGASKARI

PARIS, 26 NËNTOR 2017

Gjatë pjesëmarrjes në Konferencën e Frankofonsisë në Paris kam pranuar zyrtarisht Notën Verbale të njohjes së Republikës së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran nga Republika e Madagaskarit, pas një takimi që kam zhvilluar me homologun tim nga ky shtet.



Paris, 26 nëntor 2017 - Gjatë pranimi të Notës Verbale të njohjes së Republikës së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran nga Republika e Madagaskarit.



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË AFRIKËS QENDRORE, CHANCEL SEKODE

PARIS, 26 NËNTOR 2017

Republika e Afrikës Qendrore, vendi që ka njohur Kosovën në vitet e para pas shpalljes së pavarësisë, është vend jashtëzakonisht i rëndësishëm. Ne, do të thellojmë marrëdhëniet diplomatike me këtë shtet të rëndësishëm afrikan. Këtë ia komunikova edhe ministrit të deleguar për Frankofoni, Chancel Sekode Ndeugbayi, të cilit i kërkova mbështetjen për anëtarësimin e Kosovës në Interpol, si mundësi reale e luftës kundër fenomeneve negative dhe krimit të organizuar ndërkombëtar.



Paris, 26 nëntor 2017 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Afrikës Qendrore, Chancel Sekode.



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË BURUNDIT, ALAYN NYAMIDWE

PARIS, 26 NËNTOR 2017

Në ditën e dytë të vizitës zyrtare në Armeni dhe pjesëmarrjes në Konferencën e Frankofonisë në kryeqytetin armen Jerevan, kam zhvilluar takime të ndara me disa homologë, me të cilët ka diskutuar mbi shqyrtimin e intensifikimit të bashkëpunimit dypalësh dhe ka kërkuar mbështetje për anëtarësimin e vendit në Organizatat Ndërkombëtare, me theks të veçantë në INTERPOL. Kënaqësi ishte edhe takimi me ministrin e Jashtëm të Burundit, Alayn Nyamidwe.



Paris, 26 nëntor 2017 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Burundit, Alayn Nyamidwe.



Paris, 26 nëntor 2017 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Togos, Robert Dusey.



Paris, 26 nëntor 2017 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Tunizisë, Khemaies Jhinaoui.




Paris, 26 nëntor 2017 - Takim me Ministrin e ngarkuar të Frankofonise, John Kwet Mwan.



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË GUINEA BISSAUS

PARIS, 26 NËNTOR 2017

Takim shumë miqësor me Ministrin e Punëve të Jashtme të Guineas, Mamady Toure, me të cilin patëm një shkëmbim të rëndësishëm të ideve në lidhje me bashkëpunimin mes dy vendeve. E falënderova për përkrahjen e fuqishme, që po na ofron në procesin e anëtarësimit në Interpol dhe organizata tjera ndërkombëtare. U pajtuam të organizojmë vizita me qëllim të shqyrtimit të mundësive të bashkëpunimit dhe i premtova, që Republika e Kosovës tashmë ka krijuar një përvojë, të cilën mund ta ndajë me këtë vend, veçanërisht në fushën e legjislacionit apo praktikave policore.



Paris, 26 nëntor 2017 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Guinea Bissaus.



Paris, 26 nëntor 2017 - Takim me të Deleguarin Special të Presidentit të Guinea Conakry.



Paris, 26 nëntor 2017 - Takim me Këshilltarin e Lartë të Presidentit të Seychelles.



TAKIM ME SEKRETARIN E SHTETIT TË FRANCËS, JEAN BAPTISTE LEMOYNE

PARIS, 26 NËNTOR 2017

Liria, barazia dhe vëllazëria si parime themelore të revolucionit francez kanë qenë dhe mbeten frymëzuese për të gjithë ne edhe këtu në Kosovë. Liria e Kosovës na bëri bashkë në vitin 1999. Shteti i Kosovës na bashkoi sërish në vitin 2008. Tani, Kosova dhe Franca, si dhe Kosova e Perëndimi janë së bashku në promovimin e vlerave më të mira politike dhe ekonomike të demokracisë.



Paris, 26 nëntor 2017 - Takim me Sekretarin e Shtetit të Francës, Jean Baptiste Lemoine.



MBLEDHJA E DY QEVERIVE, SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

KORÇË, 27 NËNTOR 2017

Kam provuar emocione të mëdha që të jem në vigjilje të festës së Flamurit, në takimin tradicional të dy qeverive, të Shqipërisë dhe të Kosovës, që u mbajt, sipas dëshirës sime, në Korçë, në vatrën e Rilindjes Kombëtare. Bashkë jemi më të fortë!



Korçë, 27 nëntor 2017 - Gjatë takimit të punës së dy qeverive në Shqipëri.



TAKIM ME NDIHMËS-SEKRETARIN E SHTETIT PËR EVROPË DHE EURO-AZI, Z. WESS MITCHEL

UASHINGTON, 30 NËNTOR 2017

Zhvillova një takim shumë pozitiv me Ndhmës-Sekretarin e Shtetit për Evropë dhe Euro-Azi, z. Wess Mitchel dhe Zëvendës-Ndhmës Sekretarin e Shtetit, z. Hoyt Yee.

Ri-konfirmuam bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e shkëlqyera në mes dy vendeve dhe dy popujve në të gjitha fushat. Mbështetja amerikane për Kosovën do të vazhdojë të jetë edhe më e fuqishme dhe do të ketë angazhim më të madh të ShBA-ve në Kosovë dhe rajon.

Do të jemi në sintoni të plotë në çdo hap dhe veprim. Kalimi i Marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi dhe fillimi i dialogut Kosovë - Serbi mbeten çështje kryesore. Partneriteti dhe aleanca jonë strategjike është e palëkundur dhe e përjetshme.



Uashington D. C., 30 nëntor 2017 - Pritje në Departamentin Amerikan të Shtetit nga Ndhmëssekretari i Shtetit për Evropë dhe Euro-Azi, Wess Mitchel



GJATË TAKIMIT ME KËSHILLTARIN PËR SIGURI KOMBËTARE TË PRESIDENTIT TRUMP, GJENERALIN H. R. MCMASTER

UASHINGTON, 30 NËNTOR 2017

Në vazhdim të takimeve të nivelit të lartë gjatë vizitës time në SHBA, së bashku me Ministrat e Jashtëm të vendeve fqinje dhe ato nga rajoni takuam Këshilltarin për Siguri Kombëtare të Presidentit Trump, Gjeneralin H.R. McMaster, në Shtëpinë e Bardhë. ShBA do të mbetet e përkushtuar ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe do të rrisë edhe më shumë fokusimin dhe angazhimin e saj.



Uashington D. C., 30 nëntor 2017 - Gjatë takimit me Këshilltarin për Siguri Kombëtare të Presidentit Trump, Gjeneralin H. R. McMaster.



Uashington D. C., 30 nëntor 2017 - Në adresimin tim në Konferencën e Këshillit Atlantik në panelin “Investimi në të ardhmen: a mund ta rregullojnë ndërmarrësit Ballkanin?”



PËRMBYLLJA ME TAKIMIN E PËRBASHKËT ME DY KONGRESMENËT

UASHINGTON D. C., 30 NËNTOR 2017

Përmbyllja me takimin e përbashkët me dy kongresmenët, miq dhe mbështetës të mëdhenj të popullit dhe institucioneve të Kosovës, Peter Roskam dhe David Price. Ne vërtet i kemi borxh këtij vendi për gjithçka që ka bërë, është duke bërë dhe do të bëjë për vendin dhe popullin tonë.




Uashington D. C., 30 nëntor 2017 – Foto e përbashkët me dy kongresmenët, miq dhe mbështetës të mëdhenj të popullit dhe institucioneve të Kosovës



TAKIM ME KËSHILLTAREN SPECIALE E ZËVENDËS- PRESIDENTIT TË SHBA-SË PËR EVROPË DHE RUSI SI DHE Z. BRAD BERKLEY

UASHINGTON, 30 NËNTOR 2017

Veç takimit me Këshilltarin për Siguri Kombëtare të Presidentit amerikan, Gjeneralin McMaster zhvillova takime të ndara edhe me znj Molly Montgomery, Këshilltare Speciale e Zëvendës-Presidentit të ShBA-së për Evropë dhe Rusi si dhe z. Brad Berkley, Drejtor për Çështje Evropiane për vendet e Baltikut, Ballkan, Evropë Qëndore dhe Detin e Zi në Këshillin e Sigurisë Kombëtare, institucion ky kryesor i politikëbërjes në Shtëpinë e Bardhë.



Uashington D. C., 30 nëntor, 2017 – Në takim, gjatë vizitës zyrtare në ShBA.



NË TAKIM, GJATË VIZITËS ZYRTARE NË SHBA

UASHINGTON D. C., 30 NËNTOR, 2017

Kënaqësi që ta takoj në një mëngjes pune diplomatit veteran, negociatorin e shkathët, analistin e shkëlqyer dhe profesorin e respektuar, Daniel Serwer nga Shkolla prestigjioze për Studime të Avansuara Ndërkombëtare (SAIS) në Universitetin Johns Hopkins. Me gjithë se jetojmë në Ballkanin Perëndimor dhe përballemi çdo ditë me realitetin, perspektiva e tij mbi rajonin dhe këshillat praktike janë të jashtëzakonshme.



Uashington D. C., 29 nëntor, 2017 – Në takim, gjatë vizitës zyrtare në ShBA.



KONFERENCA E PËRAFRIMIT TË SFIDAVE DHE MUNDËSIVE DREJT BE-SË

PRISHTINË, 5 DHJETOR 2017

Sot ne Prishtine u mbajt Konferenca e organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me Organizatën Gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar GIZ, Bashkësinë Europiane dhe Ministrinë e integrimi, të titulluar: “Rëndësia e përafrimit të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së BE-së, sfidat dhe mundësitë”. Nëpërmjet përafrimit me Bashkimin Evropian, politikën e tij të jashtme, ne përmbushim interesat e shtetit tonë, interesat e qytetarëve dhe interesat kombëtare. Nëpërmjet këtij përafrimi, ne forcojmë subjektivitetin tonë ndërkombëtarë, bëhemi pjesë e një organizate politike, e cila është njëra prej akterëve më të rëndësishëm botërorë.



Prishtinë, 5 dhjetor 2017 - Në konferencën e organizuar nga MPJ, në bashkëpunim me organizatën gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar GIZ



PËRZGJEDHJA E FOTOGRAFIVE DHE SHKRIMEVE MË TË MIRA PËR VITIN KALENDARIK 2017

PRISHTINË, 7 DHJETOR 2017

Kam bërë përzgjedhjen e fotografive dhe shkrimeve më të mira për vitin kalendarik 2017. Me fotot e përzgjedhura nga ky konkurs ishin organizuar ekspozita me rastin e shënimit të dhjetëvjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës në shumicën e ambasadave të Republikës së Kosovës në botë.



Prishtinë, 7 dhjetor 2017 – Me fituesit e çmimeve të ndara nga MPJ



SFIDAT E KOSOVËS DREJT KRIJIMIT TË MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE DHE NJOHJEVE

PRISHTINË, 8 DHJETOR 2017



Prishtinë, 8 dhjetor 2019 – Gjatë fjalës sime në “Forum 2015”





VIZITA NË SHKUP, KONFERENCA E ADRIATIKUT

SHKUP, 12 DHJETOR 2017

Asnjë vend në rajon nuk mund ta ndalë apo shtyj anëtarësimin e Kosovës në NATO. Procesi i integrimeve evropiane për Kosovën është i pakthyeshëm. Këto i ka thash në takimin e ministrave të jashtëm të vendeve anëtare të Kartës së Adriatikut që është zhvilluar në Shkup. Unë i jam përgjigjur edhe kolegut nga Bosnja dhe Hercegovina – një prej vendeve të ‘kundërshton anëtarësimin’ e Kosovës. “Kjo po ndodhe sepse Serbia dëshiron kështu? Duket se gaboheni dhe nuk duhet të qëndroni prapa Serbisë”, i bëra me dije ministrit të jashtëm të Bosnjës. “Çka do të bëni ju kur Serbia ta shfuqizojë veton për anëtarësim në OBK? A nuk mendoni se kjo nuk është e gabueshme, të ndiqet rruga e Serbisë dhe të ktheheni kundër nesh, qoftë edhe nëse jemi afër? Sugjerova Bosnjën që të tregohet me e mençur.



Shkup, 12 dhjetor 2017 - Në takimin e vendeve të Kartës së Adriatikut (A5), kryesuese e së cilës ishte Republika e Maqedonisë.



Shkup, 12 dhjetor 2017 - Foto e përbashkët me ministrat pjesëmarrës të Kartës së Adriatikut.



TAKIM ME ZËVENDËSNDIHMËSSEKRETARIN E SHTETIT TË SHBA-SË, MATTHEW PALLMER

SHKUP, 12 DHJETOR 2017

Kosova mund të llogarisë si gjithmonë në ShBA, por edhe ShBA duhet të llogarisë tek ne, si partnerë të përkushtuar dhe të besueshëm. Në margjinat të takimit të Kartës së Adriatikut, pata një takim me të Dërguarin të Posaçëm Amerikan për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer. Unë e përgëzoja z.Palmer për emërimin e tij dhe si një mik i vjetër i Kosovës në këtë pozicion të ri, do të vazhdojë të na mbështesë në të gjitha nivelet. Ne e shohim dialogun si një proces të rëndësishëm që ka një mundësi për të mbyllur kapitullin e errët midis Kosovës dhe Serbisë. Normalizimi i marrëdhënieve me njohje të ndërsjellë është qëllimi i vetëm, asgjë me pak, dhe vlerësojmë pozicionin e fuqishëm të Uashingtonit për këtë synim.



Shkup, 12 dhjetor 2017 - Në margjina të takimit të Kartës së Adriatikut, takova Zëvendësndihmëse sekretarin e shtetit të ShBA-së, Matthew Palmer, mbështetës i madh i rajonit tonë.



Shkup, 12 dhjetor 2017 - Në takim të Kartës së Adriatikut në Shkup.



TAKIM ME JAN BRAATHU, SHEF I OSBE-SË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

PRISHTINË, 5 DHJETOR 2017

E kam informuar Braathun për zhvillimet e gjithëmbarshme politike në Kosovë, të arriturat e deritanishme, si dhe për objektivat dhe synimet e Qeverisë së Republikës për vitin 2018. Ndërsa, Braathu, më njoftoi në lidhje me planet dhe aktivitetet e këtij misioni në Kosovë për vitin e ardhshëm, si dhe për prioritetet e shtetit italian, i cili do të jetë kryesues i OSBE-së gjatë vitit 2018.



Prishtinë, 5 dhjetor 2017 - Takim me Jan Braathu, Shef i OSBE-së në Republikën e Kosovës.



Prishtinë, 15 dhjetor 2017 - Takim me Zevendëssekretarin Gjeneral të Politikës së Jashtme të BE-së, Pedro Serrano.



PRITJE PËR KORIN DIPLOMATIK TË AKREDITUAR NË KOSOVË, DUKE VENDOSUR PËR HERË TË PARË KËTË TRADITË

PRISHTINË, 15 DHJETOR 2017

Me rastin e festave të fundvitit kam organizuar pritje për korin diplomatik të akredituar në Kosovë, duke vendosur për herë të parë traditën e pritjes për ambasadorët e akredituar në Kosovë.



Prishtinë, 15 dhjetor 2017 – Fjala ime para të pranishmëve me rastin e festave të fundvitit



Prishtinë, 15 dhjetor 2017 - Presidenti Thaçi, Kryeministri Haradinaj dhe përfaqësues të korit diplomatik të akredituar në Kosovë në pritjen e organizuar për fundvit nga MPJ-ja.



Prishtinë, 15 dhjetor 2017 - Ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delawie, gjatë pritjes së organizuar për festat e fundvitit.



ME HOMOLOGUN TIM, MINISTRIN E JASHTËM SLOVEN, KARL ERJAVEC

LUBJANË, 19 DHJETOR 2017

Takime konstruktive dhe shumë miqësore me Presidentin slloven Borut Pahor, kryetarin e Parlamentit Milan Brglez dhe ministrin e jashtëm Karl Erjavec. Konfirmim i fuqishëm i mbështetjes së integritit të Kosovës.



Lubjanë, 19 dhjetor 2017 - Me homologun tim, Ministrin e JASHTËM slloven, Karl Erjavec, gjatë vizitës sime të parë zyrtare në Slloveni.



GJATË TAKIMIT ME PRESIDENTIN SLOVEN BORUT PAHOR

LUBJANË, 19 DHJETOR 2017

Gjatë takimit me Presidentin sloven Borut Pahor, me të cilin kemi diskutuar për shtimin e mëtejme të bashkëpunimit ekonomik në mes të dy vendeve dhe për organizimin e Forumit Ekonomik në Kosovë.




Lubjanë, 19 dhjetor 2017 - Gjatë takimit me Presidentin sloven Borut Pahor.



TURNETË DIPLOMATIKE NË KONTINENTIN E AFRIKËS

20 - 24 DHJETOR 2017

Paralelisht me vizitat që ishin publike, realizova një sërë vizitash të tjera që nuk ishin bërë publike. Në pjesën e parë të muajit nëntor vizitova Republikën e Zambisë, Ugandës si dhe Republikën e Madagaskarit. Vizitova Republikën e Malit, Afrikën e Jugut, Zimbabvesë, Republikën e Kongos dhe Republikën Federale të Nigerisë. Në të gjitha këto shtete jam takuar me udhëheqësit më të lartë.



Afrikë e Jugut, 21 dhjetor 2017 - Takim me Presidentin e Afrikës së Jugut, Jakob Zuma.




Kongo Brazzeville, 22 dhjetor 2017 - Gjatë takimit me Presidentin e Republikës së Kongos, Sh. T. Denis Sassou Nguesso.



NGA DATA 11 SHTATOR DERI MË 31 DHJETOR 2017

Në 100 ditët e para të mandatit qeverisës kam bërë mbi 100 mijë kilometra rrugë në të gjitha anët e botës. 95 % të lëvizjeve të mia janë bërë me aeroplanin tim privat, pa e shpenzuar buxhetin e Republikës së Kosovës. Në fakt, aeroplani im, përveç në shërbimin tim dhe të stafit tim, ka qenë në shërbim edhe të institucioneve të Republikës së Kosovës, shumë herë edhe të miqve të Kosovës.





TAKIMI ME HOMOLOGEN TIME NGA BULLGARIA

VJENË, 6 JANAR 2018

U theksua mbështetja bullgare për procesin e integritit ndërkombëtar të Kosovës dhe nevoja e forcimit të bashkëpunimit ndër-parlamentar. Po bëjmë diplomaci me vendet e largëta dhe duhet të rrisim bashkëpunimin me ju që jeni fqinjët tanë. Kosova është afër dy Korridoreve 8 dhe 10 dhe ne duhet të përmirësojmë infrastrukturën tonë



Vjenë, 6 janar 2018 - Takim përshëndetës në Vjenë me Ministren e Punëve të Jashtme të Bullgarisë.



TAKIM ME AMBASADORIN MBRETËRISË SË BASHKUAR, RUARI O'CONEL

PRISHTINË, 6 JANAR 2018

Mbretëria e Bashkuar në vazhdimësi ka mbështetur Republikën e Kosovës në të gjitha fushat. Ne do të jemi gjithmonë mirënjohës për këtë mbështetje. Kemi ngritur bashkëpunimin tonë në nivel edhe më të lartë.



Prishtinë, 6 janar 2018 - Takim me Ambasadorin Mbretërisë së Bashkuar, Ruari O'Conel.



TAKIM ME AMBASADORIN FRANCEZ NË KOSOVË, DIDIJER CHABER

PRISHTINË, 6 JANAR 2018

Kosova dhe Franca kanë bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë dhe me punën tuaj si ambasador ju e keni forcuar edhe më tej këtë marrëdhënie tonën ndërshtetërore. Diplomati francez më konfirmoi se bashkëpunimi bilateral ndërmjet dy vendeve do të vazhdojë të thellohet edhe më shumë në të ardhmen. Ne jemi në shërbim të afrimit dhe thellimit të bashkëpunimit ndërmjet vendeve dhe popujve tanë.



Prishtinë, 6 janar 2018 - Takim me Ambasadorin francez në Kosovë, Didijer Chaber.



TAKIM ME AMBASADOREN E KROACISË NË KOSOVË, MARIA KAPITANOVIÇ

PRISHTINË, 6 JANAR 2018

Ambasadores Kroate i shpreha mirënjohjen për mbështetjen e pakursyer që institucionet dhe qytetaret e Republikës së Kroacisë i kanë ofruar qytetareve dhe institucioneve Kosovës, në të gjitha proceset nëpër të cilat ka kaluar vendi. Theksova rëndësinë e thellimit bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve midis dy vendeve, në çdo fushë me interes dypalësh, me theks në atë ekonomike.



Prishtinë, 6 janar 2018 - Takim me Ambasadoren e Kroacisë në Kosovë, Maria Kapitanoviç.



VIZITA ZYRTARE NË EMIRATET E BASHKUARA ARABE

ABU DHABI, 7 JANAR 2018

Vizitova Emiratet e Bashkuara Arabe. U prita nga ministri i Jashtëm dhe i Bashkëpunimit Ndërkombëtar i Emirateve të Bashkuara Arabe, Lartmadhëria e Tij, Sheikh Abdullah bin Zayed Al Nahyan. Në kuadër të këtij takimi, ndër të tjera, u pajtuam për hapjen e Ambasadës së Republikës së Kosovës, e cila ndodhi pak kohë më vonë.

UNITED ARAB EMIRATES
MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS
& INTERNATIONAL COOPERATION
OFFICE OF THE MINISTER



الإمارات العربية المتحدة
وزارة الخارجية
والتعاون الدولي
مكتب الوزير



@OFMUAE
WWW.MOFA.GOV.AE

Abu Dhabi, 7 janar 2018 - Bashkëbisedim me homologun tim Sheikh Abdullah bin Zayed Al Nahyan



NË KONFERENCËN, "THE NEW NEXUS - DIPLOMACY, SECURITY AND DIGITAL NATION STATE"

ABU DHABI, 7 JANAR 2017

Në konferencën e organizuar nga Instituti Ndërkombëtar për Diplomacinë Kulturore (IICD), me temën "The New Nexus - Diplomacy, Security and Digital Nation State", ku unë isha ndër folësit kryesor.



Abu Dhabi, 7 janar 2017 - Në konferencën e organizuar nga Instituti Ndërkombëtar për Diplomacinë Kulturore (IICD), me temën "The New Nexus - Diplomacy, Security and Digital Nation State", ku unë isha ndër folësit kryesor.



Abu Dhabi, 8 janar 2018 - Gjatë prezantimit tim për sfidat e ndërtimit të shtetit dhe ndërlidhjet/vështirësitë në diplomaci, në kuadër të konferencës "The New Nexus - Diplomacy, Security and Digital Nation State" në Abu Dhabi.



Abu Dhabi, 8 janar 2018 - Vizita ime në Emirate ishte prezantuar në shumë media nacionale.



Abu Dhabi, 8 janar 2018 - Takim me Sheikh Nahyan bin Mubarak Al Nahyan, ministër i Sportit, Kulturës dhe Rinisë.



VIZITA NË SHBA, NË SHTETIN ILLINOIS DHE IOWA

DES MOINES/IOWA, 11 - 12 JANAR 2018



Des Moines/Iowa, 11 janar 2018 - Vizitë me Guvernatoren, Kim Ra. Në këtë takim morën pjesë të gjithë faktorët relevantë të shtetit të Iowas.



Des Moines/Iowa, 11 janar 2018 - Pritje nga Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve të Shtetit të Iowas, Linda L. Upmeyer.



TAKIM ME GUVERNATOREN E SHTETIT TË IOWAS, KIM REYNOLDS

DES MOINES/IOWA, 11 JANAR 2018

Takim me Guvernatoren e Shtetit të Iowas, Kim Reynolds. Biseduam për marrëdhëniet bilaterale në mes të dy shteteve tona, për planet e përbashkëta në fushën e ekonomisë, arsimit, bujqësisë si dhe për disa veprime strategjike në interes të Republikës së Kosovës.



Des Moines/Iosa, 11 janar 2018 - Takim me Guvernatoren e Shtetit të Iowas, Kim Reynolds.



GJATË PRITJES NGA GJENERALI I GARDËS KOMBËTARE TË IOWAS, TIMOTHY ORR

DES MOINES/IOWA, 11 JANAR 2018

Në përfundim të vizitës isha në Shtabin kryesor të Gardës kombëtare të Iowës për të shprehur mirënjohjen për mbështetjen për Kosovën



Des Moines/Iowa, 12 janar 2018 - Gjatë pritjes nga Gjenerali i Gardës Kombëtare të Iowas, Timothy Orr, në Shtabin Kryesor të Gardës Kombëtare të Iowas.



Des Moines/Iowa, 12 janar 2018 - Pritje nga Sekretari i Bujqësisë e Shtetit të Iowas, Bill Northey.



Des Moines/Iowa, 12 janar 2018 - Ligjërata në Universitetin Drake të Iowas. Kam folur për arritjet dhe partneritetet e Republikës së Kosovës gjatë dhjetëvjetorit të parë shtet i pavarur.



Takim me Senatorin e Iowas, Charles Scheinder



TAKIM ME AMBASADORIN, JOACHIM RÜCKER

PRISHTINË, 15 JANAR 2018

Takim me ish-Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Ambasadorin gjerman Joachim Rücker, i cili kishte dhënë kontribut të rëndësishëm para dhe pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.



Prishtinë, 15 janar 2018 - *Takim me ish-Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara*



Prishtinë, 16 janar 2018 - *Takim me Grupin Punues për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës.*



TAKIM ME AMBASADORËT E VENDEVE MIKE TË KOSOVËS NË KËSHILLIN E EVROPËS

STRASBURG, 17 JANAR 2018

Takim i frytshëm në Strasbourg me ambasadorët e shteteve mike të Kosovës në Këshillin e Evropës. Mbështetje e fuqishme në rrugën e faktorizimit ndërkombëtar të vendit tonë. U diskutua për bashkërendimin e aktiviteteve për anëtarësimin e Kosovës në KiE.



Strasbourg, 17 janar 2018 - Takim me ambasadorët e vendeve mike të Kosovës në Këshillin e Evropës.



Strasbourg, 17 janar 2018 - Prezantimi i Kosovës në takimin e katërt të MSA-së në Parlamentin Evropian.



TAKIM ME SEKRETARIN E PËRGJITHSHËM TË KËSHILLIT TË EVROPËS, THORBJØRN JAGLAND

STRASBURG, 17 JANAR 2018

Biseduam për çështje të interesit të përbashkët dhe paralelisht me këtë e njoftova për qëllimin tonë, që të anëtarësohemi në këtë Organizatë të rëndësishme për të Drejtat e Njeriut dhe për hapat, që ne si Kosovë dhe Ministri e Jashtme i kemi ndërmarrë për të arritur këtë qëllim. E kam thënë edhe në deklaratimet e mia të mëhershme se duke marrë parasysh procedurat respektive, ne presim, që të bëhemi anëtar i 48-të i kësaj Organizate deri në vitin 2020.



Strasbourg, 17 janar 2018 - Gjatë qëndrimit tim në Strasbourg zhvillova një takim të veçantë me Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, Thorbjørn Jagland.



TAKIM ME ZËVENDËSSHEFEN E MISIONIT DIPLOMATIK AMERIKAN NË KOSOVË, COLLEN HYLAND

PRISHTINË, 19 JANAR 2018

Nëpërmjet të Ngarkuarës së Përkohshme me Punë, njëherësh Zëvendësshefe e Misionit Diplomatik amerikan në Kosovë, Collen Hyland, kam pranuar letrat e urimit për festat e fundvitit nga Presidenti amerikan Donald J. Trump dhe Sekretarit amerikan i Shtetit, Rex W. Tillerson.



Prishtinë, 19 janar 2018 – Takim me Zëvendësshefe e Misionit Diplomatik amerikan në Kosovë, Collen Hyland



Prishtinë, 19 janar 2018 - Në takim me një grup të studentëve nga Universiteti i Vjenës dhe Universiteti Lido në Venedik të cilëve ua kam prezantuar prioritetet e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës.



KOSOVËS MERR ZYRTARISHT KRYESIMIN E ORGANIZATËS RAJONALE CEFTA

BRUKSEL, 24 JANAR 2018



Bruksel, 24 janar 2018 - Si rezultat i angazhimit dhe përpjekjeve të vazhdueshme, Republika e Kosovës merr zyrtarisht kryesimin e Organizatës Rajonale CEFTA në një ceremoni të organizuar enkas për këtë ngjarje në Bruksel.



VIZITË NË ROMË ME FTESË TË MINISTRIT TË JASHTËM TË ITALISË, ANGELINO ALFANO

ROMË, 25 JANAR 2018

Politika e jashtme e Kosovës ka rënë në duar ekspertit me emërimin Tuaj. Unë e di biografinë tuaj para se të bëheshit Njeri politik. Keni ndërtuar. E keni bërë këtë metaforikisht dhe fizikisht duke lënë gjurmë kudo, dhe kjo kërkohet sot në politikë të jashtme, sepse ju jeni Njeri, dhe Ndërtues.



Romë, 25 janar 2018 - *Gjatë vizitës sime në Romë me ftesë të Ministrit të Jashtëm të Italisë, Angelino Alfano.*



Romë, 25 janar 2018 - Gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes dypalëshe në mes të Kosovës dhe Italisë me ministrin e Jashtëm italian, Angelino Alfano.



NË VATIKAN U TAKOVA ME SEKRETARIN E SELISË SË SHENJTË, PAUL RICHARD GALLAGHER

VATIKAN, 25 JANAR 2018

Takim kisha me Sekretarin e shtetit për marrëdhëniet e jashtme, në Selinë e Shenjtë, Vatikanit ne New Hork, Kryepeshkopin Paul Richard Gallagher. Më konfirmoi dhe e mirëprita lajmin e ngritjes së nivelit të administrimit apostolik të Kosovës, diçka që është vlerësim për vendin tonë dhe klimën e bashkëjetesës fetare. I kërkova ndihmën e Selisë së Shenjtë që Kosova të bëhet pjesë e organizatave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare që na sigurojnë pjesëmarrje aktive dhe dinjitoze tonën në arenën globale. E informova bashkëbiseduesin për zhvillimet në Kosovë. I tregova pse Kosova e meriton të bëhet pjesë e UNESCO-s., si një vend shembullor i bashkëjetesës fetare, ku objektet fetare ruhen prej qindra vjetësh, si trashëgimi e qytetërimit tonë.



Vatikan, 25 janar 2018 - Në Vatikan u takova me Sekretarin e Selisë së Shenjtë, Paul Richard Gallagher.



GJATË PREZANTIMIT TË LIBRIT TIM NË GJUHEN ITALIANE NË ROMË

ROMË, 25 JANAR 2018

Gjatë vizitës së parë zyrtare në Itali kam bërë edhe prezantimin e librit tim në gjuhën italiane, “Nulla è impossibile. Come ho costruito il mio successo” (Asgjë nuk është e pamundur. Si e ndërtova suksesin tim). Prezantimi është bërë në selinë “Dante Alighieri”, organizata më e madhe kulturore italiane dhe para personaliteteve të kulturës, artit, sportit, diplomatëve të akredituar në Romë, gazetarëve dhe ushtarakëve.



Romë, 25 janar 2018 - *Gjatë vizitës së parë zyrtare në Itali kam bërë edhe prezantimin e librit tim në gjuhën italiane, “Nulla è impossibile. Come ho costruito il mio successo”*



Romë, 25 janar 2018 - Takim bilateral në mes të delegacionit nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës italiane.



Romë, 26 janar 2018 - Në takim me ndërmarrësit italianë, duke prezantuar reformat e Qeverisë dhe duke i ftuar për të investuar në Republikën e Kosovës.



Romë, 26 janar 2018 - Në përfundimin e vizitës sime në Itali vendosa një kurorë me lule në Monumentin e Skënderbeut në Sheshin “Nënë Tereza”.



TAKIM ME HOMOLOGEN TIME SUEDEZE, MORGOT WALLSTROM

STOCKHOLM, 29 JANAR 2018

Në kuadër të vizitës së parë në Mbretërinë e Suedisë u prita nga Ministria e Jashtme suedeze, Morgot Wallstrom. Gjithashtu, zhvillova takime të ndara edhe me Sekretarin e shtetit në Ministrinë e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ndërkombëtar, Ulrika Moder, dhe me përfaqësues nga Parlamenti suedez dhe me Grupin e Miqësisë.



Suedi, 29 janar 2018 – Në takim me homologen time suedeze



PRISHTINË, 31 JANAR - 2 SHKURT 2018

TAKIMI I DYTË ME KOMISIONIN PARLAMENTAR PËR PUNË TË JASHTME



Prishtinë, 31 janar 2018 – Takimi i dytë me komisionin parlamentar për Punë të Jashtme.



Prishtinë, 2 shkurt 2018 - Në një takim pune në ambientet e Ministrisë së Jashtme me Kongresmenin amerikan Steven Palazzo ku, pos të tjerash, kërkova vendosjen e kontakteve miqësore mes Kosovës dhe shtetit të Missipit, i njohur për bujqësi.



REPUBLIKA E GUINES BISSAO RIKONFIRMON NJOHJEN E KOSOVËS SHTET I PAVARUR DHE SOVRAN

PRISHTINË, 2 SHKURT 2018



N/Ref72/MNECIC/2018

Bissau, 24 de Janeiro de 2018

O Ministério dos Negócios Estrangeiros, da Cooperação Internacional e das Comunidades apresenta os seus melhores cumprimentos ao Ministério dos Negócios Estrangeiros da República de Kosovo e, em relação a Nota Verbal de Refº332/DGPext/mc/2017, de 21 de Novembro de 2017, informa que dá-se efeito a mesma nota.

Assim, a República da Guiné-Bissau continua a reconhecer o Kosovo como estado independente e soberano, tal como já o tinha feito no passado, através da carta do ex-Presidente da República Sua Excelência Senhor Malam Bacai Sanhá, datada de 10 de Janeiro de 2011.

O Ministério dos Negócios Estrangeiros da Cooperação Internacional e das Comunidades aproveita o ensejo para reiterar ao Ministério dos Negócios Estrangeiros da República de Kosovo os seus melhores cumprimentos.

AO
MINISTÉRIO DOS NEGÓCIOS ESTRANGEIROS
DA REPÚBLICA DE KOSOVO



EMBAIXADA DA REPÚBLICA DE GUINÉ-BISSAU
BENELUX E SUÍÇA
MISSÃO JUNTO DA UNIÃO EUROPEIA

AMBASSADE DE LA RÉPUBLIQUE DE GUINÉE-BISSAU
BENELUX ET SUISSE
MISSION AUPRÈS DE L'UNION EUROPÉENNE

Réf: n°07/EMGBBRU/2018

Sujet: Note de transmission

L'Ambassade de la République de Guinée-Bissau à Bruxelles présente ses compliments à l'Ambassade de la République du Kosovo accrédité à Bruxelles, et a l'honneur de lui transmettre en annexe la note de référence 72/MNECIC/2018, du 25 janvier 2018, du Ministère des Affaires Étrangères, Coopération International et des Communautés.

L'Ambassade de Guinée-Bissau saisit cette occasion pour renouveler à l'Ambassade du Kosovo à Bruxelles les assurances de sa très haute considération.

Bruxelles, le 01 février 2018

Ambassade de la République du Kosovo
Av. Rogier Vandendriessche 38
1150 Bruxelles



BVL BRAND WYTHLOCK 114 - 1000 BRUXELLES - TEL. +32 (0) 2 739 291 229 FAX. +32 (0) 2 749 026 21
E-MAIL: AMBASSADE@GUISAAL.BRUXELLES.GUINEE-BISSAU.GU

Prishtinë, 2 shkurt 2018 - Pas fillimit të një fushate me lajme të rreme nga Republika e Serbisë, Republika e Guines Bisao rikonfirmon njohjen e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran.



DORËZIMI I LETRAVE KREDENCIALE NGA AMBASADORI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË GUINEA BISAO, Z. RAMADAN GASHI



Guinea Bisao, shkurt 2018- Pas fillimit të një fushate me lajme të rreme nga Republika e Serbisë, Republika e Guines Bisao, pasi rikonfirmon njohjen e Kosovës shtet i pavarur dhe soveran, akrediton edhe Ambasadorin jorezident të Republikës së Kosovës në këtë shtet, Ramadan Gashi.



PRISHTINË, 4 SHKURT 2018

Përderisa Republika e Kosovës po shënonte vitin jubilar të dhjetëvjetorit të Pavarësisë së vendit, Ministria e Punëve të Jashtme kishte organizuar një sërë aktivitete dhe mbante një peshë të rëndësishme për organizimin e dhjetëra takimeve dypalëshe për delegacionet e shumta të shteteve që merrnin pjesë në ceremoninë kryesore zyrtare; bashkoi vikipedianët e rinj nga rajoni dhe Evropa për pasurimin e “Wikipedias” me shkrime dhe fotografi për Kosovën; bëri promovimin e dy librave përgatitur nën përkujdesjen time: Deklaratën e Pavarësisë dhe Vendimin e GjND-së mbi Kosovën dhe u angazhua edhe në ceremonitë dhe aktivitetet e tjera përcjellëse të Qeverisë së Kosovës.



Prishtinë, 4 shkurt 2018 - Si mbështetje dhe organizim nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës ishin mbledhur dhjetëra vikipedianë vullnetarë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Evropa për dy fundjava radhazi për ta pasuruar enciklopedinë e lirë “Wikipedia” me artikuj dhe fotografi mbi Kosovën me rastin e shënimit të vitit jubilar të dhjetëvjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Gjatë dy fundjavave ata e kishin pasuruar “Wikipedia” për Kosovën me rreth 600 artikuj, faqe dhe kategori dhe kishin bërë rreth 5 000 redaktime.




DDORËZIMI I KOPJEVE TË DEKLARATËS SË PAVARËSISË SË KOSOVËS NË BIBLIOTEKËN E KONGRESIT AMERIKAN

UASHINGTON D. C., 7 - 8 SHKURT 2018



Uashington D. C., 7 shkurt 2018 - Së bashku me Presidentin Thaçi dhe kongresmenë amerikanë dorëzuar kopjen e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës në Bibliotekën e Kongresit amerikan në ShBA.



Uashington D. C., 8 shkurt 2018 - Gjatë pjesëmarrjes në Lutjet e Mëngjesit. Me këtë rast u takova me Ministrin e Jashtëm të Filipineve, ministrin e Infrastrukturës së Republikës së Kongos dhe udhëheqës e përfaqësues shtetesh që nuk e kanë njohur ende Kosovën.



GJATË VIZITËS SË PUNËTORIVE TË VIKIPEDIANËVE TË RINJ

PRISHTINË, 11 SHKURT 2018

Me Ambasadorin zviceran në Kosovë, Jean Hubert Lebet, gjatë vizitës së punëtorive të vikipedianëve të rinj, në prag të shënimit të vitit jubilar të dhjetëvjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, me iniciativën e Ministrisë së Punëve të Jashtme.



Prishtinë, 11 shkurt 2018 - Me Ambasadorin zviceran në Kosovë, Jean Hubert Lebet



KONFERENCA E SHTETEVE QË PËRBËJNË KOALICIONIN PËR SHKATËRRIMIN E ISIS-IT

KUVAJT, 13 SHKURT 2018

Kam marrë pjesë dhe jam paraqitur me një fjalim në takimin ministerial të Koalicionit Botëror Kundër ISIS-it i cili u zhvillua në Kuvajt. Në margjina të këtij takimi u takova me shumë homologë të mi nga vende të ndryshme të botës, duke përfshirë Sekretarin amerikan Rex Tillerson, Përfaqësuesen e Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherini, si dhe Ministrin e Jashtëm të Jordanisë, të Libanit, të Katarit dhe të tjerë.



Kuvajt City, 13 shkurt 2018 – Bashkëbisedim në takimin ministerial të Koalicionit Botëror Kundër ISIS-it



Kuvajt City, 13 shkurt 2018 - Takim me Ministren e Jashtme të Australisë, J. Bishop.



Kuvajt City, 13 shkurt 2018 - Gjatë Konferencës Ministeriale të Shteteve që përbëjnë Koalicionin për Shkatërrimin e ISIS-it, pas të tjerash, pata rastin t'i takoj disa prej homologëve të mi, si: Sekretarin e Shtetit Tillerson, Cavosoglin, Alfanon, Komisionaren Mogherini, Ministrin polak, Zv/ministrin e Austrisë etj. Kosova këtu është konsideruar shtet me rëndësi të posaçme.



MINISTRI I JASHTËM I REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË DR. SIGMAR GABRIEL, VZITË NË KOSOVË

PRISHTINË , 14 SHKURT 2018



Prishtinë, 14 shkurt 2018 - Bashkë me kryeministrin Haradinaj dhe Zë/kryeministrin Limaj, në takim me Ministrin e Jashtëm të Republikës Federale të Gjermanisë, dr. Sigmar Gabriel.



Prishtinë, 14 shkurt 2018 - Takim miqësor me Ministrin e Jashtëm të Gjermanisë, dr. Sigmar Gabriel, në shtëpinë time.





Prishtinë, 14 shkurt 2018 - Gjatë darkës në shtëpinë time, me Ministrin e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, dr. Sigmar Gabriel. Gjermania është një nga aleatët dhe përkrahësit tanë më të mëdhenj.



VIZITA NË PRISHTINË E KRYEMINISTRIT TË MALIT TË ZI, DUŠKO MARKOVIĆ

PRISHTINË, 14 SHKURT 2018



Prishtinë, 14 shkurt 2018 - Bashkë me Kryeministrin Haradinaj takova Kryeministrin e Malit të Zi, Duško Marković.



NJOHJA E KOSOVËS NGA BARBADOSI

PRISHTINË, 15 SHKURT 2018

Si rezultat i rritjes së dinamikës dhe shtimit të angazhimit në politikën e jashtme, shteti i Barbadosit njih Republikën e Kosovës, duke bërë një dhuratë të mirë në shënimin e vitit jubilar të Pavarësisë së Kosovës dhe duke i dhënë një goditje të fortë propagandës serbe me lajme të reme.



No. IR/2018/21

The Ministry of Foreign Affairs and Foreign Trade of Barbados presents its compliments to the Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Kosovo and has the honour to refer to previous requests by the latter for the Government of Barbados to recognise Kosovo as an independent and sovereign state and for the establishment of relations between Barbados and Kosovo.

The Ministry has the further honour to inform that the Cabinet of Barbados has granted approval for the official recognition of Kosovo as an independent state and for the establishment of relations between the two countries. It is therefore proposed that the respective officials of Barbados and Kosovo in New York, USA, sign a Joint Communiqué on the establishment of relations between Barbados and Kosovo.

The Ministry encloses herewith the draft of the communiqué on the establishment of relations between the two countries and stands ready to consider the proposals of the Government of Kosovo in this regard.

The Ministry of Foreign Affairs and Foreign Trade of Barbados avails itself of this opportunity to renew to the Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Kosovo the assurances of its highest consideration.

Ministry of Foreign Affairs and Foreign Trade
Barbados.

February 15, 2018



Prishtinë, 15 shkurt 2018 – Nota verbale e njohjes së Pavarësisë së Kosovës



Nju Jork, 16 shkurt 2018 - Lidhja e marrëdhënieve diplomatike me Barbadosin.



GJATË PJESËMARRJES NË KONFERENCËN E SIGURISË NË MUNIH

MUNIH, 16 SHKURT 2018

Në ditën e parë të qëndrimit dhe pjesëmarrjes në Konferencën e Sigurisë në Mynih të Gjermanisë, kam zhvilluar takime të shumta me homologë, me presidentë shtetesh dhe zyrtarë tjerë të nivelit të lartë nga shtete të ndryshme të botës. Kam lobuar intensivisht për shtimin e njohjeve të reja dhe sigurimin e mbështetjes për integrimin e mëtejshëm të vendit në Organizatat Ndërkombëtare, në veçanti në INTERPOL.



Munih, 16 shkurt 2018 - Gjatë pjesëmarrjes në Konferencën e Sigurisë në Munih.



GJATË TAKIMIT ME PRESIDENTIN E RUANDAS, PAUL KAGAME

MUNIHI, 16 SHKURT 2018

Më është thënë decidivisht se një njohje është vetëm formalitet për arsye se Ruanda e ka mbështetur dhe do ta mbështesë Kosovën në të gjitha aspektet. Është shumë e vërtetë që Ruanda ndërkombëtarisht na ka mbështetur çdo vend. Nëse do të arrijmë që të kemi njohjen e parë, pas saj do të vijmë edhe shumë njohje të tjera sepse këto shtete koordinohen dhe bashkëpunojnë mes vete.



Munih, 16 shkurt 2018 - Gjatë takimit me Presidentin e Ruandas, Paul Kagame, në margjina të Konferencës së Sigurisë në Munih, Gjermani.



GJATË TAKIMIT ME MINISTRIN E JASHTËM TË SUDANIT, IBRAHIM AHMED ABDELAZIZ GHANDOUR

MUNIHI, 16 SHKURT 2018

Diskutim i shkëlqyeshëm me ministrin e Punëve të Jashtme të Sudanit, Ibrahim Ahmed Abdelaziz Ghandour, mbi marrëdhëniet e Kosovës me shtetin e Sudanit. Ne e përgëzojmë qeverinë e re në Sudan për hapat që ka ndërmarrë drejt reformave. Ne do të angazhohemi së bashku për të rritur bashkëpunimin tonë me autoritetet e reja të Sudanit.



Munih, 16 shkurt 2018 - Gjatë takimit me Ministrin e Jashtëm të Sudanit, Ibrahim Ahmed Abdelaziz Ghandour.



Munih, 16 shkurt 2018 - Takim me Baroneshën Ashton gjatë Konferencës së Sigurisë.



TAKIM ME HOMOLOGUN TIM TURK MEVLUT ÇAVUSOGLU

MUNIHI, 16 SHKURT 2018

Pas takimit me Presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan, kisha rastin që ta takojë në një takim shumë të ngrohtë dhe miqësor homologun tim, Ministrin e Jashtëm të Turqisë, Mevlüt Çavuşoğlu. Me homologun nga Turqia ri-konfirmova mbështetjen e fuqishme nga ky vend. Miku im, Mevlüt shumë shpejt do ta vizitojë Kosovën, ku ndër të tjera do të koordinojmë agjendën mbi vazhdimin e lobimit për vendin tonë në raport me vendet jo-njohëse.



Munih, 16 shkurt 2018 - Takim me homologun tim turk Mevlut Çavusoglu.



Munih, 16 shkurt 2018 - Takim me Ministren e Jashtme të Ruandës.



TAKIM ME ISH SEKRETARIN E SHBA-SË, JOHN KERRY

MUNIH, 17 SHKURT 2018

Ish Sekretari John Kerry gjithmonë i vëmendshëm dhe i interesuar për zhvillimet në Kosovë. Vlerësim i jashtzakonshëm për kontributin e tij dhe të SHBA-së.



Munih, 17 shkurt 2018 - Gjatë Konferencës së Sigurisë në Munih të Gjermanisë kam takuar ish-Sekretarin amerikan të Shtetit, John Kerry.



Munih, 17 shkurt 2018 - Gjatë Konferencës së Sigurisë kam takuar Gjeneralin Erhard Bühler.



GJATË KONFERENCËS SË SIGURISË KAM TAKUAR KOMISIONARIN EVROPIAN, JOHANNES HAHN

MUNIHI, 17 SHKURT 2018

Vendi ynë i gëzohet tregut të lirë, jo vetëm mes Kosovës dhe Serbisë, por në të gjithë Ballkanin Perëndimorë. I gëzohemi kohës kur nuk do të ketë tarifa, por njëkohësisht respekti dhe njohja reciproke, është parakusht për t'u arritur kjo. Po ashtu, theksova edhe njëherë nevojën e liberalizimit të vizave si një e drejtë që u takon qytetarëve tanë. Rikujtova se Kosova tashmë ka përmbushur të gjitha kushtet dhe padrejtësisht mbetet e izoluar.



Munih, 17 shkurt 2018 - *Gjatë Konferencës së Sigurisë kam takuar Komisionarin Evropian Johannes Hahn.*



CEREMONIA E BOTIMIT TË DY LIBRAVE NGA MPJ

PRISHTINË, 18 SHKURT 2018

Ministria e Punëve të Jashtme ishte bërë shtëpi e përbashkët e ish-deputetëve nënshkrues të Deklaratës së Pavarësisë dhe përfaqësuesve të vendit në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë gjatë një pritje të veçantë që ishte organizuar në ambientet e kësaj Ministrie dhe me praninë e mysafirëve të shquar ndërkombëtarë, që nderuan Kosovën me pjesëmarrjen e tyre në shënimin e dhjetëvjetorit të Pavarësisë së vendit. Arsyeja kryesore e kësaj ngjarje ishte botimi i dy librave: I pari mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, respektivisht deputetët nënshkrues të saj, i dyti për Kosovën në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në të njëjtin aktivitet ishte bërë edhe përrurimi i sallës së re të rinovuar.



Prishtinë, 18 shkurt 2018 – Ceremonia e botimit të dy librave



Prishtinë, 18 shkurt 2018 - Ish-Presidenti kroat Stipe Mesiq gjatë pritjes që kishte organizuar Ministria e Punëve të Jashtme për të gjithë mysafirët që kishin marrë pjesë në shënimin e vitit jubilar të dhjetëvjetorit të Pavarësisë.



KOSOVA DHE JAPONIA ME MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PRISHTINË, 18 SHKURT 2018

Japonia në vazhdimësi ka qenë një mbështetëse e madhe e Kosovës, por që nga shpallja e pavarësisë dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike ato kanë thelluar dhe zgjeruar bashkëpunimin dy-palësh dhe shumëpalësh në shumë fusha.



Prishtinë, 18 shkurt 2018 - Gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve me Zëvendësministrin Parlamentar të Punëve të Jashtme të Japonisë, Manabu Horii.



PRITJE DELEGACIONEVE TË SHUMTA SHTETËRORE NË SHËNIMIN E JUBILEUT TË DHJETËVJETORIT TË PAVARËSISË

PRISHTINË, 18 SHKURT 2018

Gjatë pritjes së delegacioneve të shumta shtetërore që përfaqësonin shtetet e tyre në shënimin e jubileut të dhjetëvjetorit të Pavarësisë së Kosovës, duke përfshirë delegacionet shtetërore nga Ishujt Marshall, Emiratet e Bashkuara Arabe, Zvicrës, Bangladeshit, Guinea Bissaut, Omanit, Turqisë, Japonisë dhe shtete të tjera pjesëmarrëse.



Prishtinë, 18 shkurt 2018 - Gjatë pritjes së delegacioneve të shumta shtetërore



Prishtinë, 18 shkurt 2018 - Kam zhvilluar takim me Ministrin e Shtetit për Punë të Jashtme të Bangladeshit, Shahriar Alam.



Prishtinë, 18 shkurt 2018 - Kam zhvilluar një takim miqësor me Kryetarin e Komisionit për Punë të Jashtme të Parlamentit të Ishujve Marshall, Senatorin Maynard Alfred.



Prishtinë, 18 shkurt 2018 - Kam zhvilluar takim me Zëvendëskryeministrin e Turqisë, Taner Yıldız.



NË TAKIM ME ISH-MINISTRIN E PUNËVE TË JASHTME TË TURQISË, AHMET DAVUTOGLU

PRISHTINË, 18 SHKURT 2018

Takim i shkëlqyeshëm sot me mikun Ahmet Davutoglu dhe biseduam për një numër çështjesh politike të rajonit. Mirënjohës për miqësinë dhe përkrahjen ndër vite, pasi kemi punuar ngushtë në ndërtimin e marrëdhënieve më të ngushta Kosovë-Turqi.



Prishtinë, 18 shkurt 2018 - Në takim me ish-Ministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, Ahmet Davutoglu.




DARKË NË SHTËPINË TIME PËR PRESIDENTË, ISH-PRESIDENTË DHE DIPLOMATË NGA SHUMË VENDE TË BOTËS

PRISHTINË, 18 SHKURT 2018

Darkë në shtëpinë time për presidentë, ish-presidentë dhe diplomatë nga shumë vende të botës, që morën pjesë në ceremoninë zyrtare të shënimit të dhjetëvjetorit të Pavarësisë së Kosovës.



Prishtinë, 18 shkurt 2018 - *Darkë në shtëpinë time për presidentë, ish-presidentë dhe diplomatë nga shumë vende të botës, që morën pjesë në ceremoninë zyrtare të shënimit të dhjetëvjetorit të Pavarësisë së Kosovës.*



Prishtinë, 19 shkurt 2018 - Takim me Ambasadorin e Sulltanatit të Omanit në Londër, Sheik Abdulaziz bin Abdullah bin Zahiri Al-Hinai.



Prishtinë, 19 shkurt 2018 - Takim me Ambasadoren e Estonisë në Vjenë, Eve Kulli Kala, e akredituar edhe për Kosovë.



TAKIM ME ISH-PRESIDENTEN E ZVICRËS, MICHELINE CALMY REY

PRISHTINË, 21 SHKURT 2018

Gjatë takimit që kisha me ish-Presidenten e Zvicrës, Micheline Calmy Rey, e cila ka bërë thirrje që herët që Kosova të bëhet e pavarur dhe ajo e ka vendin në historinë moderne të Kosovës.



Prishtinë, 21 shkurt 2018 - *Gjatë takimit që kisha me ish-Presidenten e Zvicrës, Micheline Calmy Rey, e cila ka bërë thirrje që herët që Kosova të bëhet e pavarur dhe ajo e ka vendin në historinë moderne të Kosovës.*



TAKIM ME MIKUN TIM, AMBASADORIN WILLIAM WALKER

PRISHTINË, 21 SHKURT 2018

Takim me mikun tim, Ambasadorin William Walker. Këshillat e tij miqësore duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për të gjithë ne. Si ish-Ambasador i OSBE-së, Walker ndryshoi rrjedhën e historisë dhe zhvillimeve në Kosovë.



Prishtinë, 21 shkurt 2018 - *Takim me mikun tim, Ambasadorin William Walker. Këshillat e tij miqësore duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për të gjithë ne. Si ish-Ambasador i OSBE-së, Walker ndryshoi rrjedhën e historisë dhe zhvillimeve në Kosovë.*



TAKIM ME ISH-KRYEMINISTRIN E SUEDISË, CARL BILDT

PRISHTINË, 22 SHKURT 2018

Takim me ish-Kryeministrin e Suedisë, bashkëkryesues i Këshillit Evropian për Marrëdhënie me Jashtë (ECFR), Carl Bildt dhe ekipin e tij. U pajtuam që viti 2018 është një mundësi për rajonin që të forcojë perspektivën evropiane. Në këto momente të rëndësishme për Kosovën dhe rajonin, BE-ja duhet të tregojë leadership dhe të mos humbasim këtë mundësi për të siguruar një të ardhme evropiane për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor.



Prishtinë, 22 shkurt 2018 - Takim me ish-Kryeministrin e Suedisë, bashkëkryesues i Këshillit Evropian për Marrëdhënie me Jashtë (ECFR), Carl Bildt dhe ekipin e tij.



PRITJA NË PRISHTINË E DELAGACIONIT TË LARTË NGA BASHKIMI EVROPIAN - BE

PRISHTINË, 28 SHKURT 2018



Prishtinë, 28 shkurt 2018 - Duke i shprehur mirëseardhje në aeroportin e Prishtinës, Presidentit të Komisionit Evropian, Jean Claude Junker.



Prishtinë, 28 shkurt 2018 - Duke i shprehur mirëseardhje në aeroportin e Prishtinës, Përfaqësueses së Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Frederica Mogherini.



Prishtinë, 28 shkurt 2018 - Duke i shprehur mirëseardhje në aeroportin e Prishtinës, Komisionarit Johannes Hahn.



SË BASHKU ME DELEGACIONIN SHTETËROR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PRISHTINË, 28 SHKURT 2018

Së bashku me delegacionin shtetëror të Republikës së Kosovës, Presidentin, Thaçi, Kryeparlamentarin Veseli dhe Kryeministrin Haradinaj, në takim e përbashkët me Presidentin e Komisionit Evropian, Jean Claude Juncker, Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherini dhe Komisionarin për Zgjerim, Johanes Hahn.




Prishtinë, 28 shkurt 2018 - Së bashku me delegacionin shtetëror të Republikës së Kosovës,



ME MINISTRIN JAPONEZ TË EKONOMISË, TREGTISË DHE INDUSTRISË, HIROSHIGE SEGO

TOKIO, 1 MARS 2018

Kosova e do praninë e ndërmarrësve japonezë në shumë fusha si energjia, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, bujqësia, sepse nga eksperiencia ime mund të them se tek ata gjen sinqeritet, ndershmëri, korrektësi. Kosova ofron zonë të lirë ekonomike dhe se bashkë me Shqipërinë përfaqësojnë qendër tërheqëse për investimet dhe teknologjinë japoneze.



Tokio, 1 mars 2018 - Me ministrin japonez të Ekonomisë, Tregtisë dhe Industrisë, Hiroshige Segō, gjatë një takimi në selinë e këtij institucioni në Tokio, ku kam ofruar Zonë të Lirë Ekonomike për Japoninë.



NË TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË JAPONISË, TARŌ KŌNO

TOKIO, 1 MARS 2018

Në takim me Ministrin e Jashtëm të Japonisë, Tarō Kōno, gjatë vizitës sime të parë në Japoni. Si hap të parë pas këtij takimi, Japonia kishte pranuar menjëherë kërkesën time që vizat për kosovarët, që duan të udhëtojnë në Japoni, të jepen pranë ambasadës së këtij vendi në Tiranë.



Tokio, 1 mars 2018 - Në takim me Ministrin e Jashtëm të Japonisë, Tarō Kōno, gjatë vizitës sime të parë në Japoni.



TAKIM ME KËSHILLTARIN PËR POLITIKË TË JASHTME TË KANCELARES MERKEL, DR. JAN HECKER

PRISHTINË, 6 MARS 2018

Takim i rëndësishëm me këshilltarin për politikë të jashtme të Kancelares Merkel, Dr. Jan Hecker. Diskutim i rëndësishëm për reformat, rrugën e Kosovës drejt integrimit në BE dhe kordinimin e implementimit të agjendës tonë si shtet. Bashkëpunimi ekonomik me Gjermaninë mbetet prioritet i yni si shtet.



Prishtinë, 6 mars 2018 - Gjatë pritjes së Këshilltarit për Politikë të Jashtme të Kancelares Merkel, dr. Jan Hecker.



SË BASHKU ME KRYEMINISTRIN HARADINAJ NË TAKIM ME WES MITCHEL

PRISHTINË, 12 MARS 2018

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë qenë gjithherë pranë nesh në ditët më të vështira për popullin dhe në proceset më të rëndësishme për vendin. Sot ishte ditë me fat për Kosovën sepse Demarkacioni pothuajse është çështje e mbyllur. Ishte ditë me fat sepse kishim mysafirë edhe Ndihmës-Sekretarin e Shtetit amerikan për Evropë dhe Euro-Azi, Wes Mitchel. Thellësisht mirënjohës për mbështetjen gjithëpërfshirëse dhe të palëkundur amerikane. Krenar, që populli i Kosovës në veçanti dhe shqiptarët në përgjithësi janë populli më pro-amerikan në botë. Aleat dhe partner të përhershëm strategjik.



Prishtinë, 12 mars 2018 - Së bashku me Kryeministrin Haradinaj në takim me Ndihmëssekretarin e Shtetit amerikan për Evropë dhe Euro-Azi, Wes Mitchel.



NIKOQIR I HOMOLOGUT TIM NGA SLOVENIA

PRISHTINË, 13 MARS 2018

Nikoqir i pritjes në Kosovë për homologun slloven Erjavec. Pas takimit dypalësh kemi nënshkruar edhe protokollin e Sesionit të Parë të Komisionit të Përbashkët për Bashkëpunim Ekonomik Kosovë - Slloveni, i cili tuboi dhjetëra biznese nga të dyja anët.



Prishtinë, 13 mars 2018 - Nikoqir i pritjes në Kosovë për homologun slloven Erjavec.



Prishtinë, 13 mars 2018 - Takimi ku ishte nënshkruar protokollin e sesionit të parë në kuadër të Forumit Ekonomik Kosovë - Slloveni.



NIKOQIR I HOMOLOGES SIME NGA KROACIA

PRISHTINË, 14 MARS 2018

Takim shumë miqësor me ministren e jashtme kroate Marija Pejcinović Buriq. Raportet e shkëlqyeshme ndërmjet dy vendeve tona do t'i avancojmë ekonomikisht duke organizuar forumin ekonomik për të fuqizuar edhe më tej lidhjen ndërmjet Kroacisë dhe Kosovës.




Prishtinë, 14 mars 2018 - Në takim dhe në konferencë për media me homologen time nga Kroacia, Zëvendëskryeminstren dhe Ministren e Punëve të Jashtme, Marija Pejcinović-Buriq.



ARRITJA PËR KONFERENCËN E WB-6

SARAJEVË, 15 MARS 2018



Sarajevë, 15 mars 2018 - Arritja në Sarajevë, ku kam marrë pjesë në takim të Ministrave të Punëve të Jashtme të Ballkanit Perëndimor.



Sarajevë, 16 mars 2018 - Në takim të përbashkët të ministrave të jashtëm të Ballkanit Perëndimor me drejtues të lartë të Komisionit Evropian dhe Britanisë së Madhe.



NË TAKIM ME MINISTRIN E SHETIT BRITANIK PËR EVROPË DHE AMERIKË, ALAN DUNCAN

SARAJEVË, 16 MARS 2018

Kam njoftuar ministrin Duncan për të arriturat e Qeverisë së Kosovës, për zhvillimet aktuale në vend, dinamikën qeverisëse dhe për përkushtimin e institucioneve në fuqizimin e zhvillimit ekonomik, hapjen e vendeve të reja të punës dhe për rëndësinë e anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare. Prezenca dhe kontributi i Mbretërisë së Bashkuar është i nevojshëm në Stabilitetin e Ballkanit dhe Kosova është e përkushtuar që të fuqizojë partneritetin mes dyja vendeve.



Sarajevë, 16 mars 2018 - Në takim me Ministrin e shtetit britanik për Evropë dhe Amerikë, Alan Duncan.



PACOLLI-DAÇIQIT: SHTETËSIA E KOSOVËS ËSHTË DIÇKA E KRYER

SARAJEVË, 16 MARS 2018

Në Sarajevë ka nisur takimi i përbashkët i ministrave të jashtëm të Ballkanit Perëndimor me drejtues të lartë të Komisionit Evropian dhe Britanisë së madhe në kuadër të Procesit të Berlinit dhe Iniciativës së Triestes. Në fillim të fjalës pata disa fjalë keqardhjeje për përpjekjet e Bosnjës për të përjashtuar Kosovën nga ky aktivitet. Duke ju përgjigjur ministrit të jashtëm të Serbisë, Ivica Daçiq, i cili vuri në diskutim pjesëmarrjen e Kosovës në Sofie, në takimin e ardhshëm organizuar nga Bulgaria, Pacolli thash: “shtetësia e Kosovës është diçka e kryer. Ne do të jemi bashkë në Sofie, si gjithë shtetet e tjerë të Ballkanit dhe të Bashkimit Evropian”. Më pas, fola edhe për implikimet e Strategjisë së Zgjerimit të Bashkimit Evropian në veprimtarinë e qeverisë së Kosovës, brenda vendit dhe në marrëdhëniet me rajonin dhe BE-në.



Sarajevë, 16 mars 2018 - Në takimin e përbashkët të ministrave të jashtëm të Ballkanit Perëndimor me drejtues të lartë të Komisionit Evropian dhe Britanisë së Madhe në kuadër të Procesit të Berlinit dhe Iniciativës së Triestes.



GJATË VIZITËS SIME NË MBRETËRINË E BELGJIKËS

BRUKSEL, 20 MARS 2018



Bruksel, 20 mars 2018 - Gjatë vizitës sime në Mbretërinë e Belgjikës.



GJATË ADRESIMIT TIM ME NJË FJALIM PARA 75 EUROPARLAMENTARËVE TË KOMITETIT PËR POLITIKË TË JASHTME

BRUKSEL, 20 MARS 2018

Në takim me Komisionin për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian, Ministri informoi për zhvillimet brendshme dhe politikën e jashtme. Me Komisionerin për Drejtësi dhe Punë të Brendshme u bisedua për liberalizimin e vizave. Në kuadër të vizitës takoi edhe homologun belg, Didier Reynders.



Bruksel, 20 mars 2018 - Gjatë adresimit tim me një fjalim para 75 europarlamentarëve të Komitetit për Politikë të Jashtme, AFET, të udhëhequr nga David McAllister.



Bruksel, 20 mars 2018 - Takim me eurodeputeten, gjithashtu raportuese për Kosovën, Tanja Fajon.



Bruksel, 20 mars 2018 - Në takim me liberalët në Parlamentin Evropian, Hans Van Baalen, Kryetar i Grupit Parlamentar i ALDE dhe Ilhan Kyuchyuk, Zv/kryetar i këtij grupi.



Bruksel, 20 mars 2018 - Në takim me Zëvendëskryetarin e Grupit të Popullorëve në Parlamentin Evropian, Andrej Kovacev.



Bruksel, 20 mars 2018 - Takim me Kryetarin e Delegacionit të Parlamentit Evropian, Tonino Picula.




Bruksel, 20 mars 2018 - Takim me drejtuesit e një kompanie globale gjermane, që ka dhe shqiptarë në role të rëndësishme manaxheriale. Krahas diplomacisë institucionale, diplomacia ekonomike prodhon fryte të prekshme, ndaj gjatë qëndrimit në Bruksel iu përkushtova edhe asaj.



MIRËPRITJE NË PALLATIN EGMONT NGA HOMOLOGU IM BELG, DIDIER REYNDERS

BRUKSEL, 21 MARS 2018

Mbështetja e Belgjikës ka qenë shumë e rëndësishme për anëtarësimin në Organizatën Botërore të Doganave, për çka edhe shfrytëzova rastin ta falënderoj ministrin e Jashtëm belg personalisht. Dikutuam për koordinimin e bashkëpunimit në proceset e tjera të anëtarësimit të Kosovës në organizata. Po ashtu, biseduam për një numër marrëveshesh të cilat do t'i nënshkruajmë në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit ekonomik me Belgjikën.



Bruksel, 21 mars 2018 - Mirëpritje në Pallatin Egmont nga homologu im belg, Didier Reynders.



GJATË TAKIMIT ME KOMISIONARIN PËR PUNËT E BRENDSHME TË BE-SË, DIMITRIS AVRAMOPOULOS, NË BRUKSEL

BRUKSEL, 21 MARS 2018

Pas 3 vjetësh bllokimi, Kosova pritet ta votojë demarkacionin me Malin e Zi. Do të doja t'ju ftoja ta festonim lajmin së bashku me të rinjtë e vendit tim. Kushtet e BE-së për Kosovën nuk janë për interesin tuaj, por për të mirën tonë dhe unë jam mbështetës i madh i integritetit evropian. Si vende të vogla ne nuk mund të mbijetojmë në botën e sotme.



Bruksel, 21 mars 2018 - *Gjatë takimit me Komisionarin për Punët e Brendshme të BE-së, Dimitris Avramopoulos, në Bruksel.*



TAKIM ME LIBERALËT EVROPIAN

PRISHTINË, 22 MARS 2018

Takim me Zëvendëspresidentin e Aleancës së Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën në Parlamentin Evropian, Ilhan Kyuchyuk dhe shoqëruesit e tij.



Prishtinë 22 Mars 2018 - Takim me Zëvendëspresidentin e Aleancës së Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën në Parlamentin Evropian, Ilhan Kyuchyuk dhe shoqëruesit e tij.



Prishtinë, 23 mars 2018 - Takim me Andrew Page, Ambasador britanik i ngarkuar për organizimin e Samitit të Londrës.



NIKOQIR I HOMOLOGES SIME NGA AUSTRIA

PRISHTINË, 26 MARS 2018

E informova që Qeveria e Kosovës, është e përkushtuar të përmbushë dhe kushtin e mbetur për liberalizimin e vizave. Siç e dini, edhe ju demarkacioni ka kaluar e informova homologen time për këtë dhe kushti tjetër, i cili pothuajse është i përmbushur. Unë kërkova nga homologia që të ndihmojë Kosovën në procesin e mëtutjeshëm të jetësimit të së drejtës universale të kosovarëve, që të udhëtojnë edhe ata sikur të tjerët pa viza drejt vendeve të Evropës. Austria merr Presidencën e BE-së që nga qershori i këtij viti dhe deri në fund të vitit, dhe për këtë unë e luta ministren, që gjithmonë të ketë kujdes dhe t'i ndihmojë Kosovës në të gjitha kërkesat, që sigurisht do të jenë të shumta. Ku është e mundur Kosova do të gjejë mbështetjen te miku ynë Austria, kështu më tha homologia ime.



Prishtinë, 26 mars 2018 - Gjatë konferencës për media me homologen time nga Austria, Karin Kneissl.



Prishtinë, 26 mars 2018 - Në takim me homologen time nga Austria, Karin Kneissl, para se shteti i saj të merrte kryesimin e radhës të Presidencës së BE-së.



GJATË NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË MIRËKUPTIMIT NË MES TË MPJ-SË, MAP-IT DHE AMBASADËS FRANCEZE

PRISHTINË, 29 MARS 2018

Gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit në mes të MPJ-së, MAP-it dhe Ambasadës Franceze për bashkëpunim në “Avancimin e mësimit të gjuhës frënge për zyrtarët e lartë të Qeverisë dhe bashkëpunimit në fushën e aktiviteteve për promovimin e frankofonisë në Kosovë”.



Prishtinë, 29 mars 2018 - Gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit në mes të MPJ-së, MAP-it dhe Ambasadës Franceze.



NIKOQIR I HOMOLOGUT TIM NGA GREQIA

PRISHTINË, 12 PRILL 2018

Jemi mirënjohës për përkrahjen e Greqisë për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe kërkojmë që kjo përkrahje të vazhdojë edhe për anëtarësimin tonë në INTERPOL, UNESCO, NATO, Bashkim Evropian dhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.



Prishtinë, 12 prill 2018 - Në pritje të Ministrit të Jashtëm grek Nikos Kotzias. U pajtuam për hapjen e Zyrës së Kosovës në Athinë dhe për organizimin e forumeve të përbashkëta.



Prishtinë, 12 prill 2018 – Bashkëbisedim me homologun grek



Prishtinë, 12 prill 2018 - Takim me homologun tim Nikos Kotzias.



AKTIVITETE DHE TAKIME NË PRISHTINË DHE KUKËS

PRISHTINË, 13 PRILL 2018

Gjatë pritjes në takim me Grupin Parlamentar të Miqësisë nga Kuvajti, i kryesuar nga Waleed Al-Tabtabae, Kryetar i Grupit të Miqësisë, bashkë me Sh. T. Fayez Mishari Al-Jassim, Ambasador jorezident i Kuvajtit në Kosovë me seli në Tiranë.



Prishtinë, 13 prill 2018 - Gjatë pritjes në takim me Grupin Parlamentar të Miqësisë nga Kuvajti, i kryesuar nga Waleed Al-Tabtabae



Kukës, 16 prill 2018 - Me rastin e shënimit të 19-vjetorit të eksodit kosovar, në Kukës më jepen dy tituj: “Qytetar Nderi i Kukësit” dhe “Nderi i Qarkut Kukës”.



VIZITA E KRYEMINISTRIT TË BULLGARISË, BOYKO BORISOV

PRISHTINË, 16 PRILL 2018

Sot pritëm në një takim të përbashkët, Kryeministrin bullgar, Boyko Borisov. Mbështetja e Bullgarisë si Kryesuese e Presidencës së Këshillit Evropian do të jetë jashtëzakonisht e rëndësishme për Kosovën dhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor në rrugën drejt integritimit në BE. Kryeministri Bullgari e ri-konfirmoi atë që kam thënë edhe më herët në lidhje me pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të Republikës së Kosovës në Samitin në mes BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, që do të mbahet në Sofje me 17 Maj, 2018.



Prishtinë, 16 prill 2018 - *Bashkë me kryeministrin Haradinaj pritëm në një takim të përbashkët Kryeministrin bullgar Boyko Borisov.*



VIZITA ZYRTARE NË SOFJE GJATË FORUMIT TË PËRBASHKËT EKONOMIK NË MES TË KOSOVËS DHE BULLGARISË

SOFJE, 20 PRILL 2018

Bullgaria është partner strategjik i Kosovës. Bullgaria në vazhdimësi ka qenë një mbështetëse e Kosovës rrugën e saj euroatlantike. Kemi ndërtuar marrëdhënie të mira bilaterale. Tani kemi nevojë për një bashkëpunim më të madh ekonomik ndërmjet të dyja vendeve.



Sofje, 20 prill 2018 - Takim me homologen time të Bullgarisë, Zaharieva.



Sofje, 20 prill 2018 - Me Ministren e Jashtme bullgare, Zaharieva, gjatë Forumit Ekonomik në mes të Kosovës dhe Bullgarisë.



Sofje, 20 prill 2018 - Gjatë vizitës sime zyrtare në Bullgari, takim me të ngarkuarin për Sigurinë dhe Rendin Publik, njëherësh Ministër i Mbrojtjes, Krasimir Karakachanov.



Sofje, 20 prill 2018 - Takim me partnerët tanë partiakë të Aleancës Kosova e Re, drejtuesit e Lëvizjes së të Drejtave dhe Lirive (DPS), parti liberale bullgare e kryesuar nga Mustafa Karadaia.



TAKIME NË PRISHTINË DHE BËRDO

PRISHTINË, 23 PRILL 2018

Isha pjesëmarrës në panelin kryesor në tryezën e diskutimit të organizuar nga Instituti i Prishtinës për Studime Politike, PIPS të titulluar: “Politika e jashtme kosovare: prioritetet dhe sfidat”. Referova mbi rolin dhe rëndësinë e përfshirjes së shoqërisë civile përkitazi me këtë çështje; kapitalizimin e procesit të njohjeve të Republikës së Kosovës; reformat që po ndodhin në Ministrinë Punëve të Jashtme, diplomacinë ekonomike si dhe mbi fazën përfundimtare të dialogut me Serbinë.



Prishtinë, 23 prill 2018 - Isha pjesëmarrës në panelin kryesor në tryezën, “Politika e jashtme kosovare: prioritetet dhe sfidat”.



KAM ZHVILLUAR TAKIM ME MINISTREN E MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË ITALISË, ROBERTA PINOTTI

PRISHTINË, 23 PRILL 2018

Marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Italisë, janë dhe do të mbeten në nivel të shkëlqyer. Italia është afër Kosovës edhe si ndjenjë edhe si gjeografi. I gëzohemi investitorëve italian dhe duhet thelluar bashkëpunimi ekonomik, krahas miqësisë dhe bashkëpunimit politik me këtë vend. Italia e ka një aleat, Kosovën. Italia ka qenë një nga vendet e para që e ka njohur pavarësinë e Kosovës dhe një nga misionet më të rëndësishme. Ky partneritet do të vazhdojë.



Prishtinë, 23 prill 2018 - Së bashku me kryeministrin Ramush Haradinaj kam zhvilluar takim me Ministren e Mbrojtjes së Republikës së Italisë, Roberta Pinotti.



SAMITI I VENDEVE TË PROCESIT TË BASHKËPUNIMIT TË EUROPËS JUGLINDORE

BËRDO, 23 PRILL 2018

Vlerësova zhvillimet pozitive në rajon, në periudhën e fundit, duke veçuar ftesën e Komisionit për hapjen e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë dhe Strategjinë e Zgjerimit, që parashihet anëtarësim të sigurt të Kosovës si shtet metribute të plota. Falënderova vendet e Procesit, që u morën vesh për t'i kaluar stafetën e kryesimit Kosovës dhe Bosnjë-Hercegovinës, duke u zotuar se Kosova do ta kryejë presidencën e vet njëjtë si paraardhësit, madje dhe më mirë se ato. Po ashtu grantova homologët se Kosova mbetet e përkushtuar ndaj bashkëpunimit rajonal, normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë sipas përkufizimeve të njohura.



Bërdo, 23 prill 2018 - Konfirmohet suksesi i Kosovës në kryesimin e radhës së procesit të bashkëpunimit të Evropës Juglindore pa cilësimet e imponuara nga vende mosnjohëse.



PJESËMARRËS NË PANELIN KUSHTUAR LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

PARIS, 26 PRILL 2018

Pjesëmarrës në panelin kushtuar luftës kundër krimit të organizuar si rrugë për t'i tharë burimet e financimit të terrorizmit, drejtuar nga Ministri i Jashtëm francez, së bashku me shumë homologë, Presidentin e Bankës Botërore etj.



Paris, 26 prill 2018 - Pjesëmarrës në panelin kushtuar luftës kundër krimit të organizuar.



GJATË TAKIMIT ME PRESIDENTIN E FRANCËS, EMMANUEL MACRON

PARIS, 26 PRILL 2018

Gjatë takimit me Presidentin e Francës, Emmanuel Macron, në margjina të konferencës ndërkombëtare të nivelit të lartë “Jo para për terrorin”, sipas një nisme të Presidentit francez.



Paris, 26 prill 2018 – Shtrëngim duarsh me Presidentin e Francës, Emmanuel Macron



NË PARIS KAM TAKUAR EDHE HOMOLOGUN TIM FRANCEZ JEAN-YVES LE DRIAN

PARIS, 26 PRILL 2018

Bëra një bisedë të mirë me homologun tim nga Franca, Jean-Yves Le Drian për bashkëpunimin dypalësh dhe mbështetjen që Franca po i jep integritit të Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare dhe Euro-Atlantike. Mirënjohës për mbështetjen e gjatë dhe ne do të punojmë së bashku për të përmirësuar bashkëpunimin bilateral.



Paris, 26 prill 2018 - Në Paris kam takuar edhe homologun tim francez Jean-Yves Le Drian.



Paris, 26 prill 2018 - Takim me homologun tim nga Jemeni, Abdulmalik Al-Mekhlafi.



TAKIM ME MINISTRIN E PUNËVE TË BRENDSHME TË SINGAPORIT, K. SHANMUGAM

PARIS, 26 PRILL 2018

Kënaqësi për të parë mikun tim të vjetër nga Singapori, Ministrin e Punëve të Brendshme Shanmugam të cilin e falënderova për mbështetjen e Singaporit për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL. Ne kemi një partneritet të shkëlqyeshëm dhe do të punojmë së bashku për të forcuar bashkëpunimin dypalësh.



Paris, 26 prill 2018 - Takim me Ministrin e Punëve të Brendshme të Singaporit, K. Shanmugam.



PJESËMARRËS NË PUNIMET E PROCESIT BËRDO - BRIONE

SHKUP, 27 PRILL 2018

Gjatë diskutimeve me homologet e rajonit theksova përkushtimin e Institucioneve të Republikës së Kosovës për të vazhduar në rrugën e integritimeve evropiane, sidomos tani, pas qartësimit të procesit të integritimeve, që nga publikimi i Strategjisë së re të zgjerimit nga Komisioni Evropian. Gjithashtu kam ritheksuar angazhimin e institucioneve të Kosovës për të kontribuar në zhvillimin e fqinjësisë së mirë.



Shkup, 27 prill 2018 - Me ftesë të Presidentit maqedonas, Gjorgje Ivanov, mora pjesë në punimet e procesit Bërdo - Brione.



GJATË TAKIMIT ME KRYEMINISTRIN BULLGAR BOYKO BORISOV

SHKUP, 27 PRILL 2018

Kryeministri bullgar e rikonfirmoi atë që kam thënë edhe më herët në lidhje me pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të Republikës së Kosovës në Samitin në mes BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, që do të mbahet në Sofje më 17 maj, 2018



Shkup, 27 prill 2018 - Gjatë takimit me Kryeministrin bullgar Boyko Borisov.



Shkup, 27 prill 2018 - Takim me homologun tim maqedonas, Nikolla Dimitrov.



TAKIM BILATERAL GJATË VIZITËS SIME ZYRTARE NË ITALI

ROMË, 2 MAJ 2018

Bashkëbiseduesim me zhvillimet e fundit në Kosovë në planin rajonal, për bisedimet me Serbinë dhe disa prej prioriteteve në të cilat Kosova ka nevojë për mbështetjen italiane. E informova nikoqirin me angazhimin e Kosovës për jetësimin e marrëveshjeve të nënshkruara në bisedimet e Brukselit me Serbinë, bisedime të cilat duhet të përfundojnë vitin tjetër, me një marrëveshje detyruese mes palëve. Ne kemi interes për të ecur së bashku me Italinë, duam të jemi nxënës të mirë për këshillat e një vendi si juaji, prej nga vijnë rrënjët e Evropës së bashkuar.



Romë, 2 maj 2018 - Takim bilateral gjatë vizitës sime zyrtare në Itali.




Romë, 2 maj 2018 - Gjatë vizitës sime të dytë zyrtare në Itali, me ftesë të homologut tim italian Alfano.



TAKIM ME GUVERNATOREN E HONG KONGUT

HONG KONG, 3 MAJ 2018

Sapo mbërrita në Hong Kong, zhvillova disa takime të rëndësishme me qëllim të afrimit politik, diplomatik, etj të Kosovës me vendet e rajonit e mbi të gjitha me Kinën, njeri nga partnerët kryesorë tregtar të Kosovës. Zhvillova edhe një takim miqësor me Guvernatoren e Hong Kongut (Shefen ekzekutive të Administratës së Hong Kongut, Zonjën Carrie Lam.



Hong Kong, 3 maj 2018 - Takim me Guvernatoren e Hong Kongut (Shefen Ekzekutive të Administratës), Carrie Lam.



MINISTERIALI I KONFERENCËS SË 45-TË TË VENDEVE ISLAMIKE

BANGLADESH, 5 DHE 6 MAJ 2018

Kam marrë pjesë në Ministerialin e 45-të të Konferencës së Vendeve Islamike. Në këtë Konferencë ishin të pranishëm mbi 80 delegacione, duke përfshirë shumë ministra të punëve të jashtme të shteteve anëtare, me të cilët kam zhvilluar takime bilaterale.



Daka/Bangladesh 5 maj, 2018 – Pjesmarrës në Ministerialin e 45-të të Konferencës së Vendeve Islamike.



Daka/Bangladesh, 5 maj 2018 - Në margjina të konferencës me Kryeministren e Bangladeshit, Sheikh Hasina.



Daka/Bangladesh, 5 maj 2018 - Takim me Zëvendëskryeministrin e Parë të Turqisë.



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË ARABISË, ADELAL ALJUBEIR

DAKA - BANGLADESH, 5 MAJ 2018

Shtrengova duart me homologun tim të Arabisë Sauditë, Adel Al Jubeir dhe u dakorduam për një takim tjetër bilateral.



Daka/Bangladesh, 5 maj 2018 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Arabisë, Adelal Aljubeir.



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË NIGERISË, KALLA ANKOURAO

DAKA - BANGLADESH, 5 MAJ 2018

Pata nderin dhe kënaqësinë të takoj Ministrin e Punëve të Jashtme të Nigerit Kalla Ankourao me të cilin diskutuam vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, si dhe diskutuam mbi mundësitë e bashkëpunimit në fusha të ndryshme të jetës shoqërore . Po ashtu vlerësuam se do të ishte me rëndësi të propozohen konsuj nderi me qëllim intensifikimin e shkëmbimeve mes dy vendeve. Gjatë takimit diskutuam edhe për sfidat dhe arritjet e vendeve tona, ku theksova rëndësinë e përkrahjes së Republikës së Kosovës në synimin e saj për afirmim ndërkombëtar, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare dhe posaçërisht përkrahjen e Nigerit në lidhje me anëtarësimin në INTERPOL. Po ashtu diskutuam edhe për sfidat ekonomike dhe zhvillimore.



Daka/Bangladesh, 5 maj 2018 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Nigerisë, Kalla Ankourao.



TAKIM ME HOMOLOGËT NGA KAZAKISTANI DHE AZERBEJXHANI

DAKA - BANGLADESH, 5 MAJ 2018

Diskutim i mirë me Ministrin e Jashtëm të Kazakistanit, Kairat Abdrakhmanov dhe Ministrin e Jashtëm të Azerbajxhanit, Elmar Mammadyarov për zhvillimet aktuale dhe marrëdhëniet e Kosovës me këto dy vende. Ka mundësi që ne duhet të përdorim për të forcuar lidhjet tona në ekonomi, tregti dhe nivel politik.



Daka/Bangladesh, 5 maj 2018 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Kazakistanit, Kairat Abdrakhmanov dhe Ministrin e Jashtëm të Azerbajxhanit, Elmar Mammadyarov.



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË PALESTINËS, RIYADAL MALIKI

DAKA - BANGLADESH, 5 MAJ 2018

Kam pasur një diskutim të mirë me me Ministrin e Jashtëm të Palestinës, Riyadal Maliki për nevojën për të thelluar marrëdhëniet midis Kosovës dhe Palestinës.



Daka/Bangladesh, 5 maj 2018 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Palestinës, Riyadal Maliki.



Daka/Bangladesh, 5 maj 2018 - Takim me Presidentin e Bangladeshit, Mohammad Abdul Hamid.



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË AFGANISTANIT, SALAHUDDIN RABBANI

DAKA - BANGLADESH, 5 MAJ 2018

Gjithmonë kënaqësi të bisedosh me mikun e mirë Ministrin e Jashtëm të Afganistanit, Salahuddin Rabbani, dhe të diskutosh për marrëdhëniet e mira Kosovë Afghanistan. Së shpejti duhet ndërmarrë hapa konkretë për të forcuar lidhjet tona.



Daka/Bangladesh, 5 maj 2018 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Afganistanit, Salahuddin Rabbani.



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË LIBISË, MOHAMED TAHA SIALA

DAKA - BANGLADESH, 5 MAJ 2018

Pata një bisedë të shkëlqyeshme me Ministrin e Jashtëm të Libisë, Mohamed Taha Siala, për gatishmërinë tonë për të forcuar bashkëpunimin dypalësh. Kosova mbështet stabilizimin e Libisë dhe ne jemi të përkushtuar të forcojmë lidhjet tona. Ekziston një potencial i madh për t'u përdorur për lidhjet ekonomike dhe tregtare.



Daka/Bangladesh, 5 maj 2018 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Libisë, Mohamed Taha Siala.



Daka/Bangladesh, 6 maj 2018 - Gjatë takimit me Ministren e Punëve të Jashtme të Kanadasë, Chrystia Freeland.




GJATË TAKIMIT ME SEKRETARIN E PËRGJITHSHËM TË OBI-IT, YOUSEF BIN AHMAD AL-OTHAIMEEN

DAKA - BANGLADESH, 6 MAJ 2018

Organizata për Bashkëpunim Islamik gjithmonë ka mbështetur fuqishëm konsolidimin dhe integrimin e shtetit të Kosovës. Rezolutat e miratuara në të kaluarën nga Këshilli i Ministrave të Jashtëm të kësaj organizate, ku bëjnë thirrje për njohje të shtetit të Kosovës janë dëshmia më e mirë e kësaj mbështetje. Kënaqësi, që ta ritakojë Sekretarin e Përgjithshëm të OBI-it, z. Yusuf al Othaimen, pas takimit që e kishim më herët gjatë këtij viti në kryeqytetin e Bangladeshit, Dhaka. E falënderuam për mbështetjen e deritanishme dhe kërkuam që kjo mbështetje të reflektohet edhe në procesin e anëtarësimit të vendit tonë në INTERPOL



Daka/Bangladesh, 6 maj 2018 - Gjatë takimit me Sekretarin e Përgjithshëm të OBI-it, Yusef bin Ahmad Al-Othaimen.



Daka/Bangladesh, 6 maj 2018 - Gjatë takimit me Ministrin e Shtetit të Kamerunit, Adoum Gargoum.



Daka/Bangladesh, 6 maj 2018 - Takim me Felix Gonzales nga Venezuela.



HAPJA E AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË ABU DHABI

ABU DHABI, 10 MAJ 2018

Me ceremoni zyrtare dhe me praninë edhe të përfaqësuesve nga shteti pritës, bashkë me Presidentin Thaçi bëmë hapjen zyrtare të Ambasadës së Republikës së Kosovës në kryeqytetin e Emirateve të Bashkuara Arabe, Abu Dhabi.



Abu Dhabi, 10 maj 2018 - Me ceremoni zyrtare të hapjes së Ambasadës në Abu Dhabi.



MINISTERIALI I DISA VENDEVE TË EVROPËS QENDRORE DHE BALLKANIT PERËNDIMOR

GREQI - SUNION, 11 DHE 12 MAJ 2018



Sunion, 11 maj 2018 - Në takim me Zëvendëskryeministrin dhe Ministrin e Jashtëm çek, Martin Stropincky, në margjina të Ministerialit në Sunion të Greqisë.



Sunion, 11 maj 2018 - Takim me Sekretarin sllovak të shtetit, Ivan Korçok. Sllovakia do t'i përmbahet linjës së Bashkimit Evropian me Kosovën dhe është gati ta mirëpresë hapjen e zyrës së Kosovës në Bratislavë.



NË TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM POLAK, JACEK KAPUTOVIÇ

SUNION, 11 MAJ 2018

Shumë i lumtur që e hapa serinë e takimeve të mia në Greqi, me ministrin e jashtëm polak Jacek Kaputoviç. Ai do vizitojë shumë shpejt Prishtinën dhe unë Varshavën që me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike të zhvillojmë akoma dhe më shumë marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve. Polonia është një nga shtetet më të fuqishme të Bashkimit European i cili ka interes të veçantë për Ballkanin dhe posaçërisht Kosovën, ndaj kolegu im polak gjendet në Greqi. Kosova po e zgjeron praninë e saj ndërkombëtare dhe po flet me zërin e saj si e barabartë në familjen e shteteve.



Sunion, 11 maj 2018 - Në takim me Ministrin e Jashtëm polak, Jacek Kaputoviç.





Sunion, 12 maj 2018 - Gjatë adresimit tim në Ministerialin e Vendeve të Procesit të Vishegradit, plus katër vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku isha i ftuar nga homologu im grek Nikos Kotzias.



ME HOMOLOGUN GREK NIKO KOTZIAS

SUNION, 12 MAJ 2018

Gjatë qëndrimit tim në Sunion të Greqisë për ministerialin e disa vendeve të Europës qendrore dhe Ballkanit Perëndimor, kalova shumë kohë me nikoqirin tim, Niko Kotzias. U dakorduam që shumë shpejt Zyra e Kosovës të çelet në Athinë. Shpreha keqardhjen që në një aktivitet kaq të rëndësishëm ku kishte disa zëvendëskryeministra dhe ministra të jashtëm si ai i Çekisë, Polonisë, Kroacisë, Greqisë, Hungarisë, Bosnjës, Maqedonisë, etj, Serbia nuk ishte e pranishme, me gjasë shkaku i pranisë sime dhe Kosovës si e barabartë. Ministri Kotzias na bëri mua dhe kolegëve për një pjesë të kohës ciceronin në një vizitë që bëmë në Tempullin e Poseidonit, një dëshmi imponante e qytetërimit të Greqisë së Lashtë.



Sunion, 12 maj 2018 - Me homologun grek Niko Kotzias në margjina të Ministerialit të disa vendeve të Evropës Qendrore dhe Ballkanit Perëndimor.



PRISHTINË, 13 - 15 MAJ 2018



Prishtinë, 13 maj 2018 - Së bashku me Kryeministrin Haradinaj, Ambasadorin amerikan në Kosovë, Delawie, Gjeneralin amerikan Orr, pjesëtarë të FSK-së dhe delegacionin e bizneseve nga Iowa që e vizituan Kosovën.



Prishtinë, 15 maj 2018 - Gjatë një takimi që kam zhvilluar me delegacionin e lartë shtetëror Baden-Württemberg të Republikës Federale të Gjermanisë.



NË KUADËR TË FORUMIT EKONOMIK BOTËROR

SOFJE, 17 MAJ 2018

Bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor është çelës për shfrytëzimin e potencialit ekonomik të rajonit tonë. Pasi po shohim një revitalizim të marrëdhënieve në mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, duhet të shfrytëzojmë sa më mirë këtë moment. Ballkani Perëndimor përsëri është lart në agjendën e BE-së. Procesi i Berlinit ishte fokusuar veçanërisht në konektivitet. Jam i kënaqur që koncepti i konektivitetit është zgjeruar edhe në infrastrukturat tjera si ajo digjitale. Rajoni ynë ka potencial për më shumë bashkëpunim dhe shkëmbim tregtar, si dhe për mobilitet të njerëzve. Ndër të arriturat e fundit të vendeve të Ballkanit Perëndimor është miratimi i Agjendës për Reformën e Investimeve Rajonale.



Sofje, 17 maj 2018 - Në Forumin Ekonomik Botëror, i cili ishte mbajtur në kuadër të Samitit të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në Sofje të Bullgarisë.



GJATË NJË TAKIMI ME KRYEMINISTRIN E BELGJIKËS CHARLES MICHEL

SOFJE, 17 MAJ 2018

Së bashku me Presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaci, patëm një takim të shkëlqyeshëm me Kryeministrin e Belgjikës, Charles Michel. Kosova ka përfituar mbështetjen e fortë të Bashkimit Evropian dhe po i jep perspektivës Evropiane dhe integritimit në bashkësinë më të gjerë.



Sofje, 17 maj 2018 - Gjatë një takimi me kryeministrin e Belgjikës Charles Michel.




Sofje, 17 maj 2018 - Gjatë një prononcimi për medie.



TAKIM ME NJË DELEGACION NGA REPUBLIKA E ÇEKISË PRISHTINË, 22 MAJ 2018

Në takim me një delegacion nga Republika e Çekisë, i kryesuar nga Zëvendësministri dhe Drejtori i Departamentit të Evropës Jugore dhe Juglindore të MPJ-së çeke, Ambasadori Martin Kosatka.



Prishtinë, 22 maj 2018 - Në takim me një delegacion nga Republika e Çekisë, i kryesuar nga Martin Kosatka.



TAKIME NË BUDVË, NË KUADËR TË FORUMIT TË SIGURISË, “TO BE SECURE”

BUDVËA, 22 MAJ 2018

Kënaqësi e madhe për të takuar gjithmonë me delegacionin amerikan, i kryesuar nga Matthew Palmer për të diskutuar mbi marrëdhëniet e shkëlqyera midis Kosovës dhe SHBA dhe të riafirmojmë angazhimin tonë për t'u angazhuar në çështje strategjike përfshirë normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë si 2 shtete të pavarura dhe sovrane. Unë jam i përkushtuar për këtë qëllim.



Budvë, 22 maj 2018 - Takim me delegacionin amerikan, i kryesuar nga Matthew Palmer.



ME PRESIDENTIN THAÇI NË TAKIM ME PRESIDENTIN E MALIT TË ZI, MILO GJUKANOVIQ

BUDVË, 22 MAJ 2018

Në kuadër të Forumit të Sigurisë „To be Secure“, zhvillova një takim me Presidentin e Malit të Zi, Milo Gjukanoviç, të cilin e urova për rizgjedhjen e tij president dhe për përvjetorin e pavarësisë së Malit të Zi. Me presidentin Gjukanoviç biseduam për krijimin e një agjende të përbashkët të bashkëpunimit bilateral, duke nxitur një shkëmbim më të madh tregtar dhe bashkëpunim në fushën e integritimeve evropiane. Anëtarësimi i Malit të Zi në NATO ka krijuar një mundësi unike për Kosovën, që të lëvizim më shpejt drejt të ardhmes së përbashkët euroatlantike. Pas Samitit të Sofjes, Ballkani Perëndimor asnjëherë nuk ka qenë më afër jetësimit të aspiratave për anëtarësim në BE.



Budvë, 22 maj 2018 - Së bashku me Presidentin Thaçi në takim me Presidentin e Malit të Zi, Milo Gjukanoviç, gjatë Forumit të Sigurisë “To be Secure” (2BS).



Budvë, 22 maj 2018 - Së bashku me Presidentin Thaçi në Forumin e Sigurisë “To be Secure” (2BS) në Budvë të Malit të Zi.



BASHKË ME PRESIDENTIN THAÇI TAKIM ME KANCELARIN AUSTRIAK SEBASTIAN KURZ

VJENË, 29 MAJ 2018

Bashkë me Presidentin Thaçi patëm një takim shumë përmbajtjesor me kancelarin austriak Sebastian Kurz. Ai është mik i madh i Kosovës në rrugën tonë të sigurt drejt anëtarësimit në BE dhe NATO.



Vjenë, 29 maj 2018 - *Bashkë me Presidentin Thaçi patëm një takim me kancelarin austriak Sebastian Kurz.*



Vjenë, 29 maj 2018 - Së bashku me Presidentin e Republikës, Hashim Thaçi, në takim me Presidentin e Austrisë, Alexander Van der Bellen.



Vjenë, 29 maj 2018 - Së bashku me Presidentin Thaçi në takim me ish-Presidentin austriak Heinz Fischer, i cili njihet si mbështetës i madh i shtetit të Kosovës.



VIZITA E ISH-KRYEMINISTRIT ITALIAN MASSIMO D'ALEMA NË PRISHTINË

PRISHTINË, 5 QERSHOR 2018

Takim i shkëlqyeshëm me ish-kryeministrin italian Massimo D'Alema i cili ka dhënë një kontribut historik për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ne patëm një bisedë të shkëlqyeshme për çështjet aktuale në rajon dhe potencialin për të zgjeruar mardhëniet tona.



Prishtinë, 5 qershor 2018 - Takim në zyrën time me ish-Kryeministrin italian Massimo D'Alema.



Prishtinë, 5 qershor 2018 - Gjatë vizitës të ish-Kryeministrin italian Massimo D'Alema.



Prishtinë, 5 qershor 2018 - Në një takim pune në ambientet e Ministrisë së Punëve të Jashtme me raportuesin për Kosovën në Parlamentin Evropian, Igor Soltes, i cili ishte i shoqëruar edhe nga stafi tjetër përcjellës nga Parlamenti Evropian.



Prishtinë, 6 qershor 2018 - Në takim me Ambasadoren e Ganës, znj. Salma Frances Mancell-Egalla, e cila kishte ardhur t'i dorëzojë letrat kredenciale si Ambasadore jorezidente e Ganës në Republikën e Kosovës. Kjo kishte ndodhur në kohën kur Serbia vazhdonte propagandën e lajmeve të rreme për ndryshim qëndrimi të Ganës karshi Kosovës.




TAKIM ME HOMOLOGUN TIM, JEAN ASSELBORN

LUKSEMBURG, 8 QERSHOR 2018

Kosova ofron një klimë të favorshme me shumë lehtësira për investitorët e huaj. Ftoj investitorët luksemburgas që të investojnë në Kosovë në të gjithë sektorët ekonomikë. Dy vendet gëzojnë marrëdhënie politike dhe ekonomike të shkëlqyera. Falenderova Ministrin Asselborn për mbështetjen politike të Kosovës nga viti 1999 si dhe mbështetjen ekonomike me më shumë se 80 milion Euro.



Luksemburg, 8 qershor 2018 - Me homologun tim, Ministrin e Jashtëm Jean Asselborn, gjatë vizitës zyrtare që kisha në Luksemburg.



Lukseburg, 8 qershor 2018 - Në kuadër të vizitës në Lukseburg kam takuar Thomas Hansmann, Drejtor i Teknologjisë dhe anëtar i Bordit Menaxhues i kompanisë Paul wurth S. A., duke i ftuar të investojnë në vendin tonë.



Lukseburg, 8 qershor 2018 - Takim me Ministrin për Bashkepunim të Lukseburgut, Romain Schneider.



PRISHTINË, 11 - 14 QERSHOR 2018



Prishtinë, 11 qershor 2018 - Kam zhvilluar një takim me Sekretarin e Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë, Jacques Krabal.



KAM PRITUR NË TAKIM BINTOU KEITA

PRISHTINË, 12 QERSHOR 2018

Kam pasur një takim të shkëlqyeshëm me *Bintou Keita*, *Ndihmëssekretare e Përgjithshme për Operacionet Paqeruajtëse në Kombet e Bashkuara* me të cilin diskutuam zhvillimet në Kosovë dhe rolin e UNMIK-ut. Pozicioni ynë është i vendosur se UNMIK-u duhet të transformohet, seancat e UNSC-së të zvogëlohen.



Prishtinë, 12 qershor 2018 - Kam pritur në takim *Bintou Keita*, *Ndihmëssekretare e Përgjithshme për Operacionet Paqeruajtëse në Kombet e Bashkuara*.




GJATË RAPORTIMIT NË KOMISIONIN PARLAMENTAR PËR PUNË TË JASHTME

PRISHTINË, 12 QERSHOR 2018

Raportimi 5 orësh para antarëve të Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, ka qenë i mjaftueshëm për deputetet që të marrin të gjitha informatat për punën intensive që po bëjmë në MPJ. Debati më i madh u bë për antarësimin në INTERPOL të Kosovës. Deputetet i njoftova në detaje se ne jemi shtet i vogël i porsalindur dhe të pretendosh se 2/3 votave t'i kesh në tavolinë është pak e papritur. Ne kemi diskutuar për votën e secilit shtet. Në moment të fundit na kanë çaluar disa shtete të vogla, fare të vogla.



Prishtinë, 12 qershor 2018 - Gjatë raportimit tim në Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike.



Prishtinë, 14 qershor 2018 - Gjatë takimit me delegacionin e Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar - JICA, i kryesuar nga Drejtori për Evropë, Miyazaki Kiyotaka.



Prishtinë, 14 qershor 2018 - Gjatë pranimit të kredencialeve nga Konsullja e Përgjithshme e Republikës së Turqisë në Prizren, Eylem Altunya.



FONDACIONI “BEHGJET PACOLLI” ORGANIZON MBRËMJE PËR NATËN E BAJRAMIT

NAIROBI, KENIA, 15 QERSHOR 2018

Fondacioni “Behgjet Pacolli” ka organizuar një mbrëmje për një numër të madh të popullatës për natën e Bajramit. Aty kishin marrë pjesë shumë njerëz nga të gjitha nivelet e shoqërisë dhe institucioneve. Fondacioni “Behgjet Pacolli” në vazhdimësi ka mbështetur aktivitete të cilat promovojnë shtetin e Kosovës.



Nairobi, Kenia, 15 qershor 2018 - Fondacioni “Behgjet Pacolli” ishte organizuar një mbrëmje për një numër të madh të popullatës për natën e Bajramit.



Prishtinë, 18 qershor 2018 - Gjatë një takimi pune që kisha në ambientet e Ministrisë së Punëve të Jashtme me Ambasadorin e Izraelit, Alona Fisher Kamm.



TAKIM ME HOMOLOGEN TIME NGA AUSTRIA

VJENË, 19 QERSHOR 2018

Ne, shikojmë përpara tek Presidenca austriake e Këshillit Evropian dhe rolin e saj, që të sillni Ballkanin Perëndimor brenda agjendës së BE-së; në veçanti në lidhje me liberalizimin e vizave dhe shpresojmë që BE-ja do të merr një vendim gjatë Presidencës Tuaj. Shteti austriak është partner kryesor dhe njëri nga investitorët më të mëdhenj në vendin tonë, përderisa shpreha zotimin se prezenca ekonomike austriake në Kosovë është shumë e mirëpritur.



Vjenë, 19 qershor 2018 - Në takim me Ministren e Austrisë për Çështje Evropiane dhe Punë të Jashtme, Karin Kneissel.



GJATË VIZITËS NË HOLANDË KAM TAKUAR HOMOLOGUN TIM HOLANDEZ

HAGË, 20 QERSHOR 2018

Takim mjaft konstruktiv me homologun tim, Ministrin e Punëve të Jashtme të Holandës, Z. Stef Blok. Diskutuam gjerë e gjatë mbi liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, temë kjo e një rëndësie të veçantë për ne. Mbështetja holandeze dhe parlamentit të tyre, në këtë çështje luan një rol kyç. Ministri Blok premtoi mbështetje në çështjen e vizave, në anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare si dhe bashkëpunim të ngushtë në të gjitha sferat tjera më rëndësi të veçantë për të dyja palët e për Kosovën në veçanti”



Hagë, 20 qershor 2018 - Gjatë vizitës në Holandë kam takuar homologun tim holandez, Ministrin e Jashtëm Stef Blok dhe Komisionin mbi Zgjerimin e BE-së në Parlamentin holandez.



Hagë, 20 qershor 2018 - Në Hagë jam takuar edhe me Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme dhe Zgjerim, ku ishin të pranishëm deputetët e Parlamentit holandez nga të gjitha partitë politike parlamentare.



LETËR FALËNDERIMI NGA HOMOLOGU IM AMERIKAN, SEKRETARI I SHTETIT MIKE POMPEO

PRISHTINË, 20 QERSHOR 2018

Në letrën e falënderimit, Sekretari i Shtetit, Pompeo, më ka përcjellë falënderimet për urimet që unë i kisha dërguar me rastin e betimit të tij Sekretar i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke shprehur përkushtimin për Kosovën dhe duke ritheksuar vazhdimin e bashkëpunimit të palodhur me partnerët ndërkombëtarë për të krijuar një botë më të sigurt dhe me të ardhme më të mirë për gjeneratat që vijnë.



Prishtinë, 20 qershor 2018 – Foto e përbashkët me sekretarin e shtetit Amerikan, Mike Pompeo



VIZITA NË LIHTENSHTAJN

VADUZ, 21 QERSHOR 2018

Thellimi i marrëdhënieve bilaterale, liberalizimi i vizave, anëtarësimi i vendit tonë në Organizata Ndërkombëtare, avancimi i Agjendës Evropiane dhe dialogu me Serbinë kanë qenë disa nga temat kryesore të këtij takimi me shefen e diplomacisë nga Lihtenshtajni. Falënderova Principatën e Lihtenshtajnit për mbështetjen e vazhdueshme dhe të palëkundur ndaj shtetit të Kosovës; duke shprehur vullnetin dhe gatishmërinë e Institucioneve të vendit për të thelluar dhe zgjeruar edhe më shumë bashkëpunimin dhe partneritetin institucional në mes dy vendeve nëpërmjet inicimit dhe nënshkrimit të Marrëveshjeve të reja që do të hapnin mundësi të reja.




Vaduz, 21 qershor 2018 - Gjatë pritjes nga Ministria për Punë të Jashtme, Drejtësi dhe Kulturë e Principatës së Lihtenshtajnit, Aurelia Frick.



VIZITA NË KONFEDERATËN E ZVICRËS

BERNË, 22 QERSHOR 2018

Sot, në kuadër të turneut tim, për të fuqizuar politikën e jashtme të Kosovës, kisha nderin të takohem me Ministrin e Punëve të Jashtme të Confederatës Zvicrane, Dr. Ignazio Cassis. Me Ministrin z. Cassis zhvilluam një bisedë të gjatë ku trajtuam tema aktuale që lidhen me marrëdhëniet tona bilaterale, në interes të vendeve tona dhe në funksion të kultivimit të mëtejshëm të bashkëpunimit me shtetin zviceran. Zvicra, si gjithmonë do të vazhdojë të mbështetë Kosovën në të gjitha drejtimet, çofshin ato të katakterit ekonomik apo politik.



Bernë, 22 qershor 2018 - Me homologun tim zviceran dhe Shef i Departamentit për Punë të Jashtme, Ignazio Cassis.



TAKIME NË BRUKSEL NË KUADËR TË PROCESIT TË DIALOGUT

BRUKSEL, 24 QERSHOR 2018

Së bashku me Presidentin Thaçi, gjatë takimit me *Përfaqësuesen e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri të Bashkimit Evropian*, Federica Mogherini, në kuadër të procesit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.



24 qershor 2018 - Së bashku me Presidentin Thaçi, takim me *Përfaqësuesen e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri të Bashkimit Evropian*, Federica Mogherini.



VIZITA NË AFRIKË

25 - 27 QERSHOR 2018



Prishtinë, 25 qershor 2018 - Gjatë një turneu të ri diplomatik në kontinentin afrikan jam takuar me presidentë, ministra të jashtëm dhe përfaqësues të tjerë të shteteve të ndryshme nga ky kontinent.




Monrovia, 27 qershor 2018 - Në Monrovia të Liberisë ka bërë jehonë lajmi për forcimin e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Kosovës dhe Liberisë.



NË TAKIM ME PRESIDENTIN E LIBERISË, GEORGE WEAH

MONROVIA - LIBERI, 27 QERSHOR 2018

Në këtë takim kemi rënë dakord për hapjen e Ambasadës së Liberisë në Prishtinë dhe për rritjen e bashkëpunimit ndërshtetëror. Presidenti Weah theksoi qartë se Liberia si njëri ndër shtetet e para që e ka njohur Kosovën do të jetë fuqishëm në mbështetje të anëtarësimit të vendit tonë në organizata të rëndësishme botërore. Weah, i cili ka qenë dikur edhe fitues i Topit të artë të Evropës sa ka qenë lojtar i Milanit, u shpreh i gatshëm që bashkë me ekipin kombëtar të Liberisë të zhvillojë një ndeshje miqësore me përfaqësuesen e Kosovës në futboll. Presidenti Weah i cili është edhe mik i vjetër i imi, pranoi me kënaqësi ftesën për të vizituar Republikën e Kosovës.



Monrovia/Liberi, 27 qershor 2018 - Në takim me Presidentin e Liberisë, George Weah.



Monrovia - Liberi, 27 qershor 2018 - Kam zhvilluar takim me Zëvendësministrin e Punëve të Jashtme të këtij shteti, Eliaia Shoniyin.

 **Government of the Republic of Liberia**
MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS

[ABOUT MOFA](#) [THE MINISTER](#) [FOREIGN POLICY](#) [MISSIONS](#) [MULTILATERAL RELATIONS](#) [SERVICES](#)

[FSI Freshman Protocol Schedule](#) [Bid Procurement Advertisement](#) [Liberia Reaffirms Bilateral](#)

Liberia Reaffirms Bilateral Ties with Kosovo

[ShareThis](#) [Facebook](#) [Tweet](#) [LinkedIn](#) [Email](#)

The Government of the Republic of Liberia wishes to refute reports in some international and social media of its revocation of diplomatic relations with the Republic of Kosovo.



Flag of Both Countries
Photo Credit: Public Affairs

According to a Foreign Ministry release, Liberia was one of the first countries to recognize Kosovo's sovereignty on May 30, 2008 following its declaration of independence, and remains committed to the Joint Communiqué on the Establishment of Diplomatic Relations. The two countries continue to enjoy mutual confidence and friendship.

Monrovia - Liberi, 27 qershor 2018 - Rikonfirmim i njohjes së Republikës së Kosovës nga Liberia, pas spekulimeve nga ana e Serbisë.



AKTIVITETE DHE TAKIME TË TJERA, PRISHTINË - BRUKSEL

PRISHTINË, 29 QERSHOR 2018



Prishtinë, 29 qershor 2018 - Në takim me Ambasadorin jorezident të Kanadasë në Republikën e Kosovës, Daniel Maksymiuk.




Bruksel, 30 qershor 2018 - Përkundër përpjekjeve të ashpra të Serbisë dhe Rusisë për ta penguar pjesëmarrjen, Republika e Kosovës ka marrë pjesë në sesionin e 132-të të Këshillit të Organizatës Botërore të Doganave - OBD-së, e cila mbahet në Bruksel dhe bëhet anëtare me të drejta të plota dhe të barabarta.



NË TAKIM ME AMBASADORIN E RI JOREZIDENT TË PAKISTANIT NË KOSOVË, MUHAMMAD SYRUS SAJJAD QAZI PRISHTINË, 2 KORRIK 2018



Prishtinë, 2 korrik 2018 - Në takim me Ambasadorin e ri jorezident të Pakistanit në Kosovë, Muhammad Syrus Sajjad Qazi, ku diskutohet për shkëmbimet tregtare dhe për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit tregtar në mes të dy vendeve.



Prishtinë, 3 korrik 2018 - Në takim me Ulirka Richardsonin, Koordinatore e UNDP-së në Republikën e Kosovës.



VIZITA NË ITALI

ROMË, 6 KORRIK 2018

Në vazhden e vizitave nëpër kryeqytetet evropiane dhe me qëllim të faktorizimit ndërkombëtar të Kosovës, për herë të tretë kam vizituar Republikën e Italisë. Me këtë rast, jam pritur edhe nga Presidenti i këtij shteti, Sergio Mattarella. Gjatë vizitës në Itali, jam takuar edhe me Presidentin e Konfederatës së Përgjithshme të Industrisë italiane, Vincenzo Boccia, si dhe personalitete të tjera.



Romë, 6 korrik 2018 - Në takim me Presidentin Italina, Sergio Mattarella.



Romë, 7 korrik 2018 - Takim me ish-Ministrin e Jashtëm të Italisë, Masimo D'Alema.



Romë, 7 korrik 2018 - Takim me ish-Ministrin e Jashtëm të Italisë, Angelino Alfano.



Romë, 7 korrik 2018 - Takim me ish-Ministrin e Jashtëm të Italisë, Giulio Terzi.



PREZANTIMI I LIBRIT TIM PARA NJË MASE PREJ 1000 VETA

POLIGNANO AL MARE, 8 KORRIK 2018

Duke folur para 1 000 vetave në një shesh italian për librin tim autobiografik, botuar në italisht, në qytetin Polignano al Mare. Historia ime njerëzore, me dhimbjet dhe sukseset, nuk njih kufi, ndaj dhe u prit ngrohtësisht dhe me duartrokitje, udhëhequr nga një gazetar i shquar i televizionit kombëtar italian.



Polignano al Mare, 8 korrik 2018 - Duke folur para 1 000 vetave në një shesh italian për librin tim autobiografik, botuar në italisht.



PROCESI I BERLINIT

LONDËR, 9 - 10 KORRIK 2018

Kam marrë pjesë në Samitin e radhës të “Procesit të Berlinit”, i cili ishte mbajtur në Londër. Gjatë këtij Samiti kam folur për rëndësinë e bashkëpunimit të rinisë dhe përmirësimin e perspektivës së saj.



Londër, 9 korrik 2018 – Gjatë fjalës sime në Samitin e “Procesit të Berlinit”





"The Government of Kosovo has made accession to the EU a strategic objective; and the EU has reiterated a clear European perspective for Kosovo. This is a necessity for both sides."

Behgjet Pacolli, Foreign Minister



Londër, 9 korrik 2018 - Gjatë Samitit të Londrës kam takuar Alan Duncan, Ministër i shtetit për Evropë dhe Amerikë si dhe anëtar i Parlamentit në Mbretërinë e Bashkuar.



TAKIM NË LONDËR ME LORDIN AHMAD

LONDËR, 9 KORRIK 2018

Në margjina të Samitit të radhës të "Procesit të Berlinit", i cili ishte mbajtur në Londër, kam takuar edhe Përfaqësuesin Special të Kryeministres britanike për parandalimin e dhunës seksuale në konflikte, njëherësh Ministër i Shtetit për Komonuelth dhe Kombe të Bashkuara, Lordin Ahmad, të cilin e kam njoftuar në lidhje me adresimin e çështjes së trajtimit të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.



Londër, 9 korrik 2018 – Shtrengim duarsh me Lordin Ahmad



BASHKË ME KRYEMINISTRIN HARADINAJ NË TAKIM ME KANCELAREN GJERMANE, ANGELA MERKEL

LONDËR, 10 KORRIK 2018

Bashkëpunimi i bazuar në besim është i domosdoshëm në rrugëtimin e Kosovës për zhvillim ekonomik, integritet evropian dhe në fushën e sigurisë. Gjermania vazhdon të jetë një ndër partnerët kryesorë të Kosovës dhe përkrahja e tyre është jetike në arritjen e objektivave tona të përbashkëta.



Londër, 10 korrik 2018 - Bashkë me kryeministrin Haradinaj kam zhvilluar takim tepër të rëndësishëm me Kancelaren gjermane Angela Merkel



Londër, 10 korrik 2018 - Gjatë Samitit të Londrës kam zhvilluar takim miqësor me baroneshën Chatherine Ashton.

TAKIME NË PRISHTINË **13 - 17 KORRIK 2018**



Prishtinë, 13 korrik 2018 - Kam zhvilluar takim me Shefen e Zyrës së BE-së në Republikën e Kosovës, Nataliya Apostolova.



Prishtinë, 14 korrik 2018 - Kam zhvilluar takim me Ambasadoren e Greqisë në Republikën e Kosovës, *Chryssoula Aliferi*.



Prishtinë, 16 korrik 2018 - Me Zëvendësresidentin e Fondacionit Heritage me seli në Uashington D. C., *James Carafano*.



MIRËNJOHJE PËR HUMANISTIT HALIL KASTRATI

PRISHTINË, 17 KORRIK 2018

Humanizmi është virtyt i shqiptarëve. Sot i ndava mirënjohje humanistit, mikut dhe vëllaut tim, Halil Kastratit. Jo vetëm për shumën që ka ndarë, por edhe për çdo lot gëzimi që ka ndarë.



Prishtinë, 17 korrik 2018 - Duke i dhënë mirënjohje humanistit Halil Kastrati.



Prishtinë, 17 korrik 2018 - Zhvillova një takim pune me Lordin Tariq Ahmad, Ministër i shtetit për Commonwealth dhe Kombe të Bashkuara i Mbretërisë së Bashkuar.



TAKIME ME MOGHERININ

BRUKSEL, 18 KORRIK 2018

Së bashku me delegacionin shtetëror të Republikës së Kosovës, Presidentin, Thaçi, Kryeparlamentarin Veseli, Kryeministrin Haradinaj dhe Zëvendëskryeministrin Limaj në takim me Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherini.



Bruksel, 18 korrik 2018 - Së bashku me delegacionin shtetëror të Republikës së Kosovës.



Bruksel, 18 korrik 2018 - Së bashku me delegacionin shtetëror të Republikës së Kosovës, Presidentin Thaçi, Kryeparlamentarin Veseli, Kryeministrin Haradinaj dhe Zëvendëskryeministrin Limaj në takim me Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherini.



"Kosovars should be able to travel without visas to the EU, like their neighbors. This step towards visa liberalization is a test for the EU's leadership in the region and commitment to Kosovo's European future."

Behgjet Pacolli,
Foreign Minister



Bruksel, 18 korrik 2018 - Takim me Komisionarin e BE-së, Dimitris Avramopoulos. *"Do të isha i lumtur nëse do ta vendosja firmën për vendimin për liberalizimin e vizave për Kosovën", më tha Dimitri Avramopoulos.*



NIKOQIR I HOMOLOGUT TIM MAQEDONAS

PRISHTINË, 20 KORRIK 2018

Në takim me homologun tim nga Republika e Maqedonisë, Ministrin e Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, në vizitën e tij të parë zyrtare në Kosovë si Ministër i Jashtëm.



Prishtinë, 20 korrik 2018 - Në takim me homologun tim nga Republika e Maqedonisë, Ministrin e Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, në vizitën e tij të parë zyrtare në Kosovë si Ministër i Jashtëm.



VIZITA E KRYEMINISTRIT RAMUSH HARADINAJ NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME

PRISHTINË, 23 KORRIK 2018



Prishtinë, 23 korrik 2018 - Në takim me Kryeministrin Ramush Haradinaj, me të cilin diskutojnë për aktivitetet dhe sfidat e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës.



MINISTERIALI I PARË PËR AVANCIMIN E LIRIVE FETARE NË BOTË

UASHINGTON D. C., 26 - 27 KORRIK 2018

Me ftesë të Sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, kam marrë pjesë dhe jam paraqitur me fjalim në takimin e Ministerialit të parë për avancimin e lirive fetare në botë që i zhvilloi punimet në Uashington D. C. Në margjina të këtij Ministeriali kam takuar edhe Sekretarin amerikan të Shtetit, Mike Pompeo dhe homologë nga vende të ndryshme pjesëmarrëse.




Uashington D. C., 26 korrik 2018 - Pjesmarrës në Ministerialin për liritë fetare



Uashington D. C., 26 korrik 2018 - Një takim me Ministrin e Punëve të Jashtme të Omanit, Yusuf Bin Alawi.



Uashington, 26 korrik 2018 - Takim me Kongresmenin amerikan Eliot Engel.



Uashington D. C., 27 korrik 2018 - Së bashku me homologun tim nga Shqipëria, Ditmir Bushati, në konferencën ministeriale për liritë fetare në Uashington D. C., ku morën pjesë mbi 84 vende të botës.



TAKIM ME SEKRETARIN E SHTETIT AMERIKAN, MIKE POMPEO

UASHINGTON D. C., 27 KORRIK 2018

Gjatë qëndrimit në Washington, kënaqësi ta takoj Sekretarin e Shtetit Mike Pompeo. Kosova është me fat që në rrugëtimin e saj nuk është vetëm.



Uashington D. C., 27 korrik 2018 - Gjatë vizitës në ShBA jam takuar me Sekretarin e Shtetit amerikan, Mike Pompeo.



GJATË TAKIMIT ME AMBASADOREN E SHBA-SË NË OKB, NIKKI HALEY

UASHINGTON D. C., 27 KORRIK

Nikki Haley, ambasadorja e SHBA në OKB është mbështetësja e madhe e Kosovës, e cila përballet me të gjithë ata që sulmojnë të ardhmen e shtetit tonë. Diskutimet e saj për Kosovën në Këshillin e Sigurimit na bëjnë krenar për miqësinë dhe lidhjet historike me SHBA-në.



Uashington D. C., 27 korrik - Gjatë takimit me Ambasadoren e ShBA-së në OKB, Nikki Haley.



GJATË VIZITËS SIME NË SHBA KAM TAKUAR EDHE WESS MITCHELL

UASHINGTON D. C., 27 KORRIK

Gjatë vizitës sime në ShBA jam pritur në takim nga Ndihmësekretari amerikan i Shtetit për Evropë dhe Euro-Azi, Wess Mitchell, në Departamentin Amerikan të Shtetit.



Uashington D. C., 27 korrik 2018 - Gjatë vizitës sime në ShBA jam pritur në takim nga Ndihmësekretari amerikan i Shtetit për Evropë dhe Euro-Azi, Wess Mitchell, në Departamentin Amerikan të Shtetit.



TAKIM ME PRESIDENTIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË BOSHNJAKËVE TË SANXHAKUT, SULEJMAN UGLIANIN

PRISHTINË, 31 KORRIK 2018

Në Ministrinë e Punëve të Jashtme e kam pritur Presidentin e Këshillit Kombëtar të Boshnjakëve të Sanxhakut, Sulejman Ugljanin.



Prishtinë, 31 korrik 2018 – Foto e përbashkët me Sulejman Ugljanin.



Prishtinë, 8 gusht 2018 - Në takim me Ambasadorin e Çekisë në Kosovë, Ivo Šilhavý.



JAM NDERUAR NGA UNIVERSITETI “BODHI SASTRA” NË BANGKOK TË TAJLANDËS

BANGKOK, 28 GUSHT 2018

Jam nderuar nga Universiteti “Bodhi Sastra” në Bangkok të Tajlandës. U ndjeva krenar dhe i emocionuar me ekspozenë 45 minutëshe të rektorit të Universitetit, i cili me fjalët më të zgjedhura përshkruante Kosovën dhe përpjekjet e popullit tonë për të jetuar i lirë dhe i barabartë. Unë, dhe njerëzit e mirë të Kosovës, jemi mirënjohës për miqtë dhe mbështetësit e vendit tonë.



Bangkok, 28 gusht 2018 - Jam nderuar nga Universiteti “Bodhi Sastra” në Bangkok të Tajlandës.



TAKIMI I MINISTRAVE TË JASHTËM TË BE-SË DHE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

VJENË, 31 GUSHT 2018

Kam marrë pjesë në takim in joformal të ministrave të jashtëm të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, me temën “Infrastruktura kritike dhe digjitalizimi”, të organizuar nga Austria, kryesuese e radhës e Presidencës së BE-së.



Vjenë, 31 gusht 2018 - Pjesmarrës në takimin joformal të ministrave të jashtëm të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor



Vjenë, 31 gusht 2018 - Me ftesë të eurodeputetit Lukas Mandl kam mbajtur ligjëratë mbi zhvillimet aktuale në Kosovë në “Shtëpinë e Unionit Evropian në Vjenë”, ku kam paraqitur një bilanc dhjetëvjeçar të zhvillimeve të përgjithshme në vend.



Vjenë, 31 gusht 2018 - Gjatë adresimit para ministrave të jashtëm të BE-së dhe Ballkanit
Perëndimor në Vjenë kam theksuar se zbatimi i plotë i Marrëveshjes së Energjisë midis Kosovës dhe Serbisë është me rëndësi vitale.



PJESMARRËS NË FORUMIN E DUBROVNIKUT

DUBROVNIK, 1 SHTATOR 2018

Gjatë paraqitjes sime në Forumin e Dubrovnikut, ku kam folur për vendosmërinë e Kosovës për dialogun mbi normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.



Dubrovnik, 1 shtator 2018 - Gjatë paraqitjes sime në Forumin e Dubrovnikut, ku kam folur për vendosmërinë e Kosovës për dialogun mbi normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.



Dubrovnik, 1 shtator 2018 - Në kuadër të pjesëmarrjes në Forumin e Dubrovnikut kam takuar Ministrin e Jashtëm të Maltës, Varmelo Abela, me të cilin kam diskutuar mbi çështje të interesit të përbashkët në mes dy vendeve.



TAKIM ME HOMOLOGUN HUNGAREZ, PETER SZIJARTO

DUBROVNIK, 1 SHTATOR 2018

Kam falenderuar për përkrahjen e deritanishme për Kosovën dhe kam kërkuar vazhdimin e përkrahjes për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL, procesin e liberalizimit të vizave si dhe në rrugën e mëtutjeshme të Kosovës drejt integritimeve evropiane. Ministri hungarez më ka siguruar se Kosova do të vazhdojë ta ketë përkrahjen e Hungarisë aty ku kemi nevojë. Gjatë këtij takimi, Ministri hungarez u interesua edhe për rrjedhën e dialogut në mes Kosovës dhe Serbisë dhe kërkoi që zgjidhja që do të arrihet të jetë stabilizuese për rajonin dhe se Hungaria do të përkrahë zgjidhjen që arrihet në mes të dy palëve negociuese.



Dubrovnik, 1 shtator 2018 - Në takimet bilaterale, gjatë punimeve të Forumit të Dubrovnikut, kam takuar homologun hungarez, Peter Szijarto.



NË TAKIM ME ZËVENDËSNDIHMËSEKRETARIN E SHTETIT, MATTHEW PALMER

DUBROVNIK, 1 SHTATOR 2018

Kosova është me fat që në etapat më të rëndësishme të saj ishte ndihmuar dhe mbështetur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përkrahje kjo e cila po vazhdon edhe në ditët e sotme në të gjitha fushat. Si institucione të Kosovës jemi të përkushtuara të thellojmë bashkëpunimin me SHBA-të.



Dubrovnik, 1 shtator 2018 - Së bashku me Kryeministrin Haradinaj, në takim me Zëvendësndihmësekretarin e shtetit, Matthew Palmer.



Dubrovnik, 1 shtator 2018 - Gjatë takimit bilateral me Ministren e Jashtme kroate, Marija Pejčinović-Buriç.



Dubrovnik, 1 shtator 2018 - Në takim me homologun tim polak, Jacek Kaputoviç.



Dubrovnik, 1 shtator 2018 - "Fotografi familjare" nga pjesëmarrësit e Forunit të Dubrovnikut.



KONFERENCA E 5-TË E AMBASADORËVE

PRISHTINË, 6 SHTATOR 2018



Prishtinë, 6 shtator 2018 – “Fotografi familjare” nga Konferenca e Pestë e Ambasadorëve.



Prishtinë, 6 shtator, 2018 - Si nikoqir kam hapur zyrtarisht Konferencën e Pestë të Ambasadorëve, që vlerësohet ndër ngjarjet më të rëndësishme në Kosovë mbi politikën e jashtme.



GJATË TAKIMIT ME PËRFAQËSUESEN E LARTË TË BASHKIMIT EVROPIAN, FEDERICA MOGHERINI

BRUKSEL, 7 SHTATOR 2018

Gjërat po bëhen edhe më të vështira, sepse mospajtimet po thellohen, kurse dallimet po shfaqen, edhe pse sot kemi diskutuar vetëm përmes zonjës Mogherini. Por, këto dallime të mëdha kanë ndikuar që sot dialogu të zhvillohet vetëm përmes Përfaqësueses së Lartë të BE-së. Vështirësitë janë të mëdha, pengesat janë të mëdha dhe dallimet janë shumë të thella, por rrugëtimi dhe dialogu për paqe, stabilitet dhe fqinjësi të mirë nuk ka alternativë.



Bruksel, 7 shtator 2018 - Së bashku me Presidentin Thaçi gjatë takimit me përfaqësuesen e lartë të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, për procesin e dialogut me Serbinë.



NIKOQIR I HOMOLOGUT TIM NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PRISHTINË, 11 - 14 SHTATOR 2018

Gjatë pritjes së homologut tim nga Republika e Shqipërisë, Ditmir Bushati. Agjendë jona e përbashkët kishte për fokus identifikimin e çështjeve në të cilat mund të thellohet bashkëpunimi dhe propozimi i hapave për adresimin e sfidave të përbashkëta në fushën e politikës së jashtme dhe diplomacisë.



Prishtinë, 14 shtator 2018 – Shtrëngim duarsh me homologun shqiptar




Prishtinë, 11 shtator 2018 - Kam pritur në takim njohës Ambasadoren e re të Mbretërisë së Suedisë në Kosovë, Karin Hernmarck Ahliny, e cila ka dorëzuar kopjet e letrave kredenciale në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës.

SESIONI I 73-TË I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË OKB-SË (UNGA) NJU JORK

24 - 29 SHTATOR 2018

Gjatë aktivitetit diplomatik në kuadër të Punimeve të Sesionit të 73-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ku kam zhvilluar dhjetëra takime me homologë nga të katër anët e globit, me objektivat kryesore, si: afirmimin e shtetësisë së Kosovës, anëtarësimin në organizata të ndryshme ndërkombëtare, forcimin e marrëdhënieve dypalëshe politike dhe ekonomike, vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me vende të caktuara dhe njohje të reja.



Nju Jork, 24 shtator 2018 - Gjatë aktivitetit diplomatik në kuadër të Punimeve të Sesionit të 73-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.



Nju Jork, 24 shtator 2018 - Gjatë takimit me Kryeministrin e Samoas me qëllim të thellimit të marrëdhënieve të Kosovës me shtetet e Paqësorit.



Nju Jork, 24 shtator, 2018 - Gjatë takimit me Presidentin e Kiribatit, Taneti Mamau, që e ka njohur herët Republikën e Kosovës dhe shumë shpejt do të lidhen marrëdhënie diplomatike.



Nju Jork, 25 shtator - Gjatë takimit me Sekretarin e Përgjithshëm të OBI-it, Yusuf al Othaimen.



Nju Jork, 25 shtator 2018 - Në selinë e OKB-së, në takim me homologun tim finlandez, Timo Soini, nga i cili kam kërkuar mbështetje për liberalizimin e vizave dhe bashkëpunim në organizatat shumëpalëshe me Finlandën.



ME HOMOLOGUN NGA BAHAMAS, DARREN ALLAN HENFIELD

NJU JORK, 25 SHTATOR 2018

Në margjina të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së kam zhvilluar takime me homologët e mi nga Bahamas dhe Ruanda. Me ta është diskutuar që këto dy shtete ta rishqyrtojnë njohjen e Kosovës.



Nju Jork, 25 shtator 2018 - Me homologun tim nga Bahamas, Darren Allan Henfield.



Nju Jork, 25 shtator 2018 - *Takim në margjina të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së me homologen nga Ruanda, Louise Mushikiwabo.*



Nju Jork, 25 shtator 2018 - *Gjatë takimit me ministrin e Jashtëm të Beninit, Aurélien Agbénonci.*



GJATË TAKIMIT ME MINISTRIN E JASHTËM TË SOMALISË, AMBASADORIN AHMED ISSE AWAD

NJU JORK, 25 SHTATOR 2018

Pata një takim të shkëlqyeshëm me ministrin e Jashtëm të Somalisë, Ambasadorin Ahmed Isse Awad, për marrëdhëniet e mira të Kosovës dhe Somalisë. Ne folëm për interesat e përbashkëta që vendet tona kanë për të punuar së bashku. Kosova është mirënjohëse ndaj Somalisë për mbështetjen e saj ndërkombëtare.



Nju Jork, 25 shtator 2018 - Gjatë takimit me ministrin e Jashtëm të Somalisë, Ambasadorin Ahmed Isse Awad.



Nju Jork, 25 shtator 2018 - Takim me Presidentin e Palaut, Thomas Remengesau Jr.



Nju Jork, 25 shtator 2018 - Në takimin e ministrave të jashtëm të rajonit së bashku me Komisionarin Hahn të zhvilluar në margjinat e UNGA-s.



Nju Jork, 25 shtator 2018 - *Takim me Ministrin e Jashtëm të Mbretërisë së Belgjikës, Didier Reynders.*



Nju Jork, 25 shtator 2018 - *Takim me Ministren e Jashtme të Norvegjisë, Ine Marie Eriksen Søreide.*



Nju Jork, 25 shtator 2018 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Saint Vincent & Grenadine, Sir Louis H. Straker.



TAKIM ME KANCELARIN AUSTRIAK SEBASTIAN KURZ

NJU JORK, 25 SHTATOR 2018

Një takim shumë përmbajtësor me kancelarin austriak, Sebastian Kurz. Ai është një mik i madh i Kosovës, në rrugën tonë të sigurt drejt anëtarësimit në BE dhe NATO. Austria është një investitor serioz në fushën e ekonomisë dhe na ka mbështetur në fushën e demokratizimit, arsimit dhe kulturës.



Nju Jork, 25 shtator 2018 - Takim me Kancelarin austriak Sebastian Kurz.



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM GJERMAN HEIKO MASS

NJU JORK, 25 SHTATOR 2018

Me homologun tim gjerman, Heiko Maas, u dakorduam për një vizitë timen në Berlin në ditët e ardhshme. Gjermania duhet të tregojë leadershipin e vet dhe të shtyjë përpara procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën, pas përmbushjes së secilit kriter të vendosur. Kjo ishte edhe tema me të cilën biseduam.



Nju Jork, 25 shtator 2018 - Takim me Ministrin e Jashtëm gjerman Heiko Mass.



Nju Jork, 25 shtator 2018 - Takim me Kryeministrin e Marokut, Saadedine Othmani.



Nju Jork, 25 shtator 2018 - Takim me homologun tim nga Malajzia, Rasmi Dato.



TAKIM ME HOMOLOGEN TIME TË KORESË SË JUGUT, KANG KYUNG-WHA

NJU JORK, 26 SHTATOR 2018

Bisedë e frytshme me me homologen time të Koresë së Jugut, Kang Kyung-wha, për shkëmbimin dypalësh midis Kosovës dhe Koresë së Jugut, shprehu dëshirën e fortë të Kosovës për një partneritet të zgjeruar me Korenë e Jugut. Ekonomia dhe tregtia janë fushat kryesore të bashkëpunimit midis 2 vendeve.




Nju Jork, 26 shtator 2018 - Takim me homologen time të Koresë së Jugut, Kang Kyung-wha.



Nju Jork, 26 shtator 2018 - Takim me Ministrin e Jashtëm të Arabisë, Adelal Aljubeir.



Nju Jork, 26 shtator 2018 - Takim me presidentin e Beninit, Patrice Talon.



Nju Jork, 26 shtator 2018 - Gjatë takimit me Zëvendësministrin e Jashtëm të Mbretërisë së Tajlandës, Virasakdi Futrakul, me të cilin nënshkruam marrëveshje për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.



Nju Jork, 26 shtator 2018 - Së bashku me Presidentin Thaçi në takim me Presidentin e Konfederatës Helvetike, Alain Berset. I shprehëm mirënjohjen për mbështetjen e Zvicrës për diasporën tonë dhe shtetin tonë që nga themelimi i tij.



Nju Jork, 26 shtator 2018 - Takim me homologun tim nga Vanuatu, Ralph Regenvanu.



Nju Jork, 26 shtator 2018 - Gjatë takimit me homologun tim nga Tanzania, Waziriwa Mamboya Nje.



NË OKB LOBUAM INTENSIVISHT PËR RRRITJEN E NUMRIT TË NJOHJEVE

NJU JORK, 27 SHTATOR 2018

Në margjina të punimeve të rregullta të OKB-së në Nju Jork kam takuar Ministrin e Punëve të Jashtme të Emirateve Arabe, Abdullah bin Zayed Al Nahyan; Ministrin e Jashtëm të Libisë Mohamed T. H. Siala; Princin e Kurorës së Norvegjisë, Hakkon Magnus; Ndihmëssekretarin e Shtetit për Çështje Ekonomike të EBA-së, Mohamed Sharaf; si dhe Ministrin e Jashtëm të Bahrejnit, Shaikh Khaled bin Ahmed bin Mohammed Al Khalifah.



Nju Jork, 27 shtator 2018 - Së bashku me Presidentin Thaçi takuam Presidentin e Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, në margjina të UNGA-s.



Nju Jork, 27 shtator 2018 - Takim me Ministren e Punëve të Jashtme të Australisë, Marise Payne.



Nju Jork, 27 shtator 2018 - Takim me Ministren e Punëve të Jashtme të Ruandës, Louise Mushikiwabo.



Nju Jork, 27 shtator 2018 - *Takim me Jean Baptiste Le Moine, Ministër Shteti për Evropën dhe Punët e Jashtme të Francës.*



Nju Jork, 27 shtator 2018 - *Takim me shumë ambasadorë, drejtues institucionesh të grumbulluar në pritjen zyrtare të Ruandës.*



Nju Jork, 27 shtator 2018 - *Takim me Ministrin e Jashtëm të Bahrejnit, Shaikh Khaled bin Ahmed bin Mohammed Al Khalifah.*



Nju Jork, 27 shtator 2018 - *Takim me Ndihmëssekretarin e Shtetit për Çështje Ekonomike të EBA-së, Mohamed Sharaf.*



Nju Jork, 27 shtator 2018 - Takim me Princin e Kurorës së Norvegjisë, Hakkon Magnus.



Nju Jork, 27 shtator 2018 - Me homologun tim nga Libia, Mohamed T. H. Siala.



Nju Jork, 27 shtator 2018 - Në Forumin Ministror A5, të vendeve anëtare të NATO-s dhe atyre aspirante në rajon, që u zhvillua në margjina të OKB-së, me praninë e Ndihmëssekretarit amerikan të Shtetit, Wesi Mitchell, u konfirmua mbështetja për Kosovën nga thuajse të gjitha vendet, me përjashtim të Serbisë dhe Bosnjës.



Nju Jork, 27 shtator 2018 - Takim me homologun tim nga Letonia, Edgars Rinkēvičs, në margjinat e UNGA-s.



Nju Jork, 27 shtator 2018 - Në kuadër të dhjetëra takimeve që kam zhvilluar me homologët e mi nga shtete të ndryshme, kam zhvilluar takime bilaterale në selinë e misionit gjerman në OKB edhe me Ministrin e Jashtëm Heiko Mass, të cilin e kam falënderuar për rolin e shtetit të tij në të gjitha proceset nëpër të cilat ka kaluar Kosova.



Nju Jork, 27 shtator 2018 - Me homologun nga Madagaskari, Dovo Eloi Maxime jemi dakorduar për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, avancim ky më i lartë i përfaqësimit diplomatik, si dhe të organizojmë një forum ekonomik.



Nju Jork, 27 shtator 2018 - Pas një takimi pune me Nënësekretaren e Përgjithshme të OKB-së për Çështje Politike, Ambasadoren Rosemary Di Carlo, kam thënë se Rezoluta 1244 nuk ka më asnjë vlerë dhe se Kosova është një vend me klimë ndëretnike shumë të qetë.



Nju Jork, 27 shtator 2018 - Takim me homologun tim slloven Mario Cerar.



Nju Jork, 27 shtator 2018 - Takim me homologun tim nga Djibouti, Mahamoud Ali Youssouf.



Nju Jork, 27 shtator 2018 - Kryediplomati i shtetit të Burkina Fasos, Alpha Barry, më ka siguruar për mbështetjen e plotë dhe të pazezervë të këtij shteti për anëtarësimin e vendit tonë në organizata ndërkombëtare, gjatë një takimi zyrtar që kam zhvilluar në margjina të punimeve vjetore të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.



Nju Jork, 28 shtator 2018 - Gjatë takimit me Sekretarin e Shtetit për Marrëdhëniet me Jashtë, në Selinë e Shenjtë, Vatikan, Kryepeshkopin Paul Richard Gallagher. Në kuadër të këtij takimi jam informuar për ngritjen e nivelit të administrimit apostolik të Kosovës, që është konsideruar vlerësim për vendin dhe klimën e bashkëjetesës fetare.



Nju Jork, 28 shtator 2018 - Takim me Këshilltarin e Shtetit dhe Ministrin e Marrëdhënieve me Jashtë të Principatës së Monacos, Gille Tonelli.



Nju Jork, 28 shtator 2018 - Takim me Michaelle Jean, Sekretare e Përgjithshme e Frankofonisë.



Nju Jork, 28 shtator 2018 - Takim me homologun tim armen, Zohrab Mnatsakanyan.



Nju Jork, 29 shtator 2018 - Gjatë takimit me Presidentin nigerian Muhamadu Buhari, në rezidencën e tij. Mikun tim, Presidentin e Nigerisë, Buhari, e falënderova për pritjen dhe i kërkova që Nigeria, si shtet i rëndësishëm afrikan, ta vlerësojë hapjen e Ambasadës në Prishtinë dhe në të ardhmen ta mbështesë Kosovën në rrugën e integritimeve.




Nju Jork, 29 shtator 2018 - Gjatë takimit bilateral me Ministrin e Punëve të Jashtme të Egjiptit, Sameh Hassan Shokry Salim.





VIZITA NË PORTUGALI 2 TETOR 2018



Lisbonë, 2 tetor 2018 - *Zhvillova vizitën time të parë zyrtare në nivel të një Ministri të Jashtëm të Republikës së Kosovës në Republikën portugeze, ku jam pritur nga Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës Portugeze, Augusto Santos Silva.*



Lisbonë, 2 tetor 2018 - Gjatë takimit në Portugali kam zhvilluar takim me Zëvendëskryetarin e parlamentit, Joze Manuel Pureza.



TAKIME DISA HOMOLOGË NË SAMITIN E FRANKOFONISË, MBËSHTETJE E FUQISHME PËR KOSOVËN JEREVAN 9 - 12 TETOR 2018



Kosovës i pranohet kërkesa për ngritje të statusit të vendit të asocuar në Frankofoni

Jerevan, 9 tetor 2018 - Në kuadër të punimeve të Konferencës së Frankofonisë në Jerevan të Armenisë kam takuar Kryetarin e Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë, Jacques Chagnon dhe Sekretarin e Përgjithshëm e Asamblesë Parlamentare, Jaques Krabal. Gjatë këtij takimi kemi diskutuar për shtimin e bashkëpunimit me vendet frankofone.



Jerevan, 9 tetor 2018 - Gjatë takimit me Ministrin e Jashtëm të Republikës së Guineas, Mamady Toure.



Jerevan, 9 tetor 2018 - Me Ministrin e deleguar për Frankofoni, nga Republika e Afrikës Qendrore, Chancel Sekode.



Yerevan, 9 tetor 2018 - Takim me Ministrin e Punëve të Jashtme të Nigerit, Kalla Ankourao, me të cilin diskutuam për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike.




Jerevan, 9 tetor 2018 - Në takim me përfaqësuesin e Republikës Seychelles në Organizatën e Frankofonisë i shtrova kërkesën për njohje.



Jerevan, 9 tetor 2018 - Në kuadër të pjesëmarrjes sime në Konferencën e Frankofonisë në Armeni kam takuar Ministrin e Jashtëm të Armenisë, Zohrab Mnatsakanyan, shteti i të cilit ishte nikoqir i kësaj konference.



Jerevan, 10 tetor 2018 - Gjatë lobimit të homologët e mi në kuadër të Samitit të Frankofonisë, kam takuar Ministrin e Shtetit të Emirateve të Bashkuara Arabe, Zaki Anawar Nusseibeh, me të cilin kam diskutuar në lidhje me avancimin e bashkëpunimit bilateral.



Jerevan, 10 tetor 2018 - Ngritja e statusit të Republikës së Kosovës nga ai i tanishëm si vëzhgues në atë të asocuar është lajm i mirë për vendin, institucionet dhe qytetarët e Republikës së Kosovës.



Jerevan, 10 tetor 2018 - Takim i rëndësishëm me Jacques Chagnon, Kryetar i Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë dhe Jacques Krabal, Sekretar i Përgjithshëm i APF në margjina të Samitit të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë.



U jam drejtuar me fjalim ministrave të jashtëm të vendeve anëtare të Frankofonisë, duke u kërkuar mbështetje për anëtarësim në INTERPOL

Jerevan, 10 tetor 2018 - Në adresimin para ministrave të jashtëm të vendeve anëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë u kam kërkuar homologëve të mi mbështetjen e kandidaturës së Republikës së Kosovës për t'u bërë anëtare e plotë dhe e barabartë e INTERPOL-it, në Asambleenë e Përgjithshme të kësaj organizate.



Jerevan, 10 tetor 2018 - Gjatë takimit me Ministrin e Jashtëm të Beninit, Aurelien Agbenonci, në margjina të Konferencës së Frankofonisë.



Jerevan, 11 tetor 2018 - Me homologun maltez, mikun tim Carmelo Abela, në Samitin e Frankofonisë që po mbahet në Jerevan.



Jerevan, 11 tetor 2018 - Bashkë me Presidentin Thaçi takuam Presidentin e Congo Brazzaville, Denis Ssasou.



Jerevan, 11 tetor 2018 - Bashkë me Presidentin Thaçi takuam Presidentin e Çadit, Idriss Deby.



Jerevan, 12 Tetor 2018 - Ditën e fundit të Samitit të Frankofonisë, në të cilin Kosova u ngrë në status si vend anëtar i asociuar, bashkë me presidentin Thaçi takuam Presidentin e Armenisë, Armen Sarkissian, të cilin e falënderuam për mikpritjen dhe kujdesin ndaj delegacionit të Republikës së Kosovës.



**NIKOQIR I HOMOLOGUT TIM NGA TURQIA
19 TETOR 2018**



Prishtinë, 19 tetor 2018 - Në takim me homologun tim nga Turqia, Mevlut Çavuşoğlu.





TAKIME NË PRISHTINË DHE GJENEVË 22 - 24 TETOR 2018



Prishtinë, 22 tetor 2018 - Në takim me deputetin e Parlamentit të Gjermanisë nga radhët e CDU-së, Peter Beyer.



Gjenevë, 24 tetor 2018 - Gjatë takimit me Presidentin e Samitit të Krans Montanës në Zvicër, për të lobuar tek udhëheqësit e shteteve të ndryshme, që po merrnin pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme. Po ashtu, kam diskutuar për mundësinë që gjatë vitit 2019 ky forum të organizohet në Kosovë.





VIZITA NË STAMBOLL 29 TETOR 2018



Stamboll, 29 tetor 2018 - Udhëtimi me aeroplanin privat, i cili ka qenë dhe mbetet në shërbim të institucioneve të Republikës së Kosovës.



Stamboll, 29 tetor 2018 - Gjatë takimit me Presidentin e Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, në inaugurimin e aeroportit më të madh në Evropë, në Stamboll, ku isha i ftuar si mysafir i tij.



AKTIVITETE DHE TAKIME NË PRISHTINË 6 - 7 NËNTOR 2018



Prishtinë, 6 nëntor 2018 - Në takim me drejtoreshën e Departamentit për Evropën Kontinentale të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës, Florence Mangin.



Prishtinë 7 nëntor 2017 - Urimet më të mira për zgjedhjen e Kongresmenit të ShBA-së, mikut të madh të vendit tonë, Eliot Engel.



VIZITA NË PARIS 11 - 12 NËNTOR 2018



Paris, 12 nëntor 2018 - Gjatë qëndrimit dyditor në Republikën franceze, me rastin e shënimit të 100-vjetorit të përfundimit të Luftës së Parë Botërore, kam zhvilluar disa takime, duke përfshirë atë me Sekretarin Amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, Këshilltarin për Siguri Kombëtare të Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, John Bolton, Ndihmësekretarin amerikan të Shtetit për Evropë dhe Euro-Azi, Wess Mitchell, Ministrin e Jashtëm të Francës, Jean-Yves Le Drian, Ministrin e Jashtëm të Turqisë, Mevlüt Çavuşoğlu, si dhe homologë dhe përfaqësues të tjerë të lartë nga më shumë se 50 shtete të botës.



Paris, 12 nëntor 2018 - Takim në Paris me homologun tim nga Turqia, Mevlud Cavusoglu.





NIKOQIR I HOMOLOGUT TIM NGA HUNGARIA 15 NËNTOR 2018



Prishtinë, 15 nëntor 2018 - Gjatë pritjes së homologut tim, Ministrit të Jashtëm hungarez Péter Szijjártó.



MBLEDHJA E PËRBASHËKT E QEVERISË SË KOSOVËS DHE SHQIPËRISË PEJË, 26 - 27 NËNTOR 2018



Pejë, 26 nëntor 2018 - Në kuadër të mbledhjes së pestë të përbashkët në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë kam propozuar iniciimin e studimit të përbashkët ndërkombëtar: “Kombi shqiptar në 50 vjetët e ardhshëm”, dokument ky që do duhej të shërbente si një platformë zhvillimore fuqizuese e kombit shqiptar në Ballkan.



TAKIME DHE AKTIVITETE TË TJERA NË PRISHTINË DHE VLORË 27 - 28 NËNTOR 2018



Prishtinë, 27 nëntor 2018 - Gjatë një takimi me Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit për Çështje Evropiane të Parlamentit të Kroacisë, me ç'rast i kam informuar për mbarëvajtjen e zhvillimeve të përgjithshme në vend.



Vlorë, 28 nëntor 2018 - Me rastin e pranimit të titullit akademik "Doctor Honoris Causa" nga Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali".





MINISTERIALI I VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR BUDVË 30 NËNTOR 2018



Budvë, 30 nëntor 2018 - Gjatë punimeve të Ministrealit të Vendeve të Ballkanit Perëndimor në Mal të Zi, i jam përgjigjur homologut tim boshnjak lidhur me taksën 100 % për produktet serbe dhe boshnjake në Kosovë, duke kritikuar pozicionin e tij si dhe duke e akuzuar Bosnje dhe Hercegovinën se po shërben si marionetë e Beogradit.



AKTIVITET NË BERLIN 3 DHJETOR 2018



Berlin, 3 dhjetor 2018 - Gjatë fjalimit tim në ceremoninë e organizuar nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Gjermani me rastin e shënimit të dhjetëvjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike në mes të Kosovës dhe Gjermanisë.



TAKIM ME AMBASADORIN E RI AMERIKAN NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, PHILIP KOSNETT 4 DHJETOR 2018



Prishtinë, 4 dhjetor 2018 - Me rastin e pranimit të kopjeve të letrave kredenciale nga Ambasadori i ri amerikan, Philip Kosnett, nëpërmjet të cilave ai u akreditua Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë i ShBA-së në vendin tonë.



Prishtinë, 4 dhjetor 2018 - Me Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Philip Kosnett.





**MË DATË 5 DHE 6 DHJETOR 2018 KAM UDHËTUAR NË GAMBI,
KU KAM ZHVILLUAR NJË TAKIM ME PRESIDENTIN E KËTIJ
SHTETI, Z. ADAMA BARROW
GJITHASHTU, GJATË KËSAJ VIZITE KAM TAKUAR EDHE
HOMOLOGUN TIM NË GAMBIA, Z. MAMADU TANGARA**



Banjul/Gambi, 5 dhjetor 2018 - Në takim me Presidentin e Gambisë, Adama Barrow.



Banjul/Gambi, 5 dhjetor 2018 - Me homologun tim, Ministrin e Punëve të Jashtme të Gambisë, Mamadou Tangara, pas nënshkrimit të marrëveshjes për thellimin e marrëdhënieve politike dhe diplomatike në mes të Republikës së Kosovës dhe Gambisë.



**PAS VIZITËS NË GAMBIA KAM VAZHDUAR VIZITËN NË
KONGO BRAZZAVILLE, KU KAM TAKUAR PRESIDENTIN E
KËTIJ SHTETI, Z. DENIS SASSOU NGUESSO
5 DHJETOR 2018**



Kongo Brazzeville, 5 dhjetor 2018 - Takim me presidentin Denis Sassou Nguesso.





KONFERENCA FRANKO-GJERMANE E LUFTËS KUNDËR TRAFIKUT TË ARMËVE TE ZJARRIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR PARIS, 11 - 12 DHJETOR 2018



Paris, 11 dhjetor 2018 - Në konferencën franko-gjermane të luftës kundër trafikut të armëve të zjarrit në Ballkanin Perëndimor, rikonfirmova angazhimin e Republikës së Kosovës për të qenë pjesë shumë aktive e kësaj përpjekjeje.




Paris, 11 dhjetor 2018 - Në takim me Ministrin e Jashtëm të Francës, Jean-Yves Le Drian, gjatë punimeve të konferencës franko-gjermane të luftës kundër trafikut të armëve të zjarrit në Ballkanin Perëndimor.



Paris, 12 dhjetor 2018 - Nga takimi me homologun tim gjerman Heiko Maas.



VIZITA NË KENIA
12 DHJETOR 2018



Nairobi/Kenia, 12 dhjetor 2018 - Gjatë takimit me presidentin e Kenias, Uhuru Kenyatta.





**MË 14 DHJETOR 2018, PAS TAKIMIT NË KENIA, KAM
VAZHDUAR TAKIMET NË SHETIN E MOZAMBIKUT**

**MË 15 DHJETOR 2018, PAS PËRFUNDIMIT TË TAKIMEVE NË
MOZAMBIK, KAM VAZHDUAR VIZITAT DHE TAKIMET NË
SHETIN E LESOTOS DHE SWAZILANDIT (ESWUATINI)**





15 dhjetor 2018 - Takim me Ministren e Jashtme të Swazilandes (Eswuatini), Amina Mohamed



TAKIM NË BRUKSEL 16 DHJETOR 2018



Bruksel, 16 dhjetor 2018 - Në fjalimin tim në takimin e MSA në Bruksel, sikurse në shumë sqarime që i kam bërë BE-së në të kaluarën, theksova se askush nuk reagonte kur Serbia e BeH shkelnin CEFTA-n, se Serbia duhet të ndalohet nga BE-ja për keqpërdorimin e dialogut dhe obstrukcionet kundër Republikës së Kosovës. Ka mbaruar koha për qasje asimetrike dhe standarde të dyfishta ndaj Republikës së Kosovës. Është koha për korrektësi dhe penalizim të Serbisë nga ana e BE-së. Këtë e kërkoja me ngulm.





TAKIME NË PRISHTINË 18 – 19 DHJETOR 2018



Prishtinë, 18 dhjetor 2018 - Takim pune me Ambasadorin jorezident të Japonisë në Republikën e Kosovës, Kiyoshi Koinuma.



Prishtinë, 19 dhjetor 2018 – Raportimi i katërt në komisionin parlamentar për Punë të Jashtme.



Prishtinë, 19 dhjetor 2018 - Me rastin e pritjes së gazetarëve për festat e fundvitit si shenjë respekti për punën dhe angazhimin e tyre.



Prishtinë, 19 dhjetor 2018 - Me rastin e darkës që shtrova për korin diplomatik të akredituar në Republikën e Kosovës dhe për krerët e institucioneve të Republikës së Kosovës.



**RINOVIMET DHE RREGULLIMET E HAPËSIRAVE TË PUNËS,
NË OBJEKTIN E MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
ME MJETE VETANAKE**



Prishtinë, tetor 2017 - Rinovimi i Kabinetit të Ministrit në objektin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.



Prishtinë, tetor 2017 - Salla e takimeve e rinovuar dhe mobiluar në Kabinetin e Ministrit.



Prishtinë, 17 shkurt 2018 - Salla e Konferencave për Media në Ministrinë e Punëve të Jashtme, e rinovuar nga donacioni i Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, z. Pacolli. Në të njëjtën sallë ishte organizuar pritje për shënimin e vitit jubilar të dhjetëvjetorit të Pavarësisë së Kosovës me të gjitha delegacionet e huaja që ishin ftuar të merrnin pjesë.



Prishtinë, 17 shkurt 2018 - Rinovimi i hyrjes kryesore në godinën e Ministrisë së Punëve të Jashtme.





Prishtinë, 17 shkurt 2018 - Rinovimi dhe rregullimi i sallës së pritjes për delegacione shtetërore në objektin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.



Prishtinë, 17 shkurt 2018 - Rregullimi i një salle tjetër në objektin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për nivele të takimeve tête-à-tête.



Prishtinë, gusht 2018 - Rregullimi (asfaltimi) i parkingut para objektit të Ministrisë së Punëve të Jashtme nga MAP.